

ALPHA BANK ALBANIA SHA

**Raporti i Audituesit të Pavarur
dhe Pasqyrat Financiare
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

PËRMBAJTJA

Faqja

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRAT E FITIMIT OSE HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE	4
SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	5-79

**RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR****Aksionarëve dhe Drejtimit të Alpha Bank Sh.a.,****Opinionit**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Alpha Bank Albania sh.a (“Banka”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më datë 31 dhjetor 2017 si edhe të performances së saj financiare dhe të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”).

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA”-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar “Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare” të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës (“BKSNE”) dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Bankës më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016, janë audituar nga një tjetër audites ligjor, i cili ka shprehur një opinion të pamodifikuar për pasqyrat financiare më 31 mars 2017.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që jepen në raportin vjetor, i përgatitur nga drejtimi në përputhje me Nenin 53 të Ligjit Nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006 “Mbi bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit mbi këto pasqyra.

Opinionit ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim konkluzione që jep siguri lidhur me këto informacione.

Informacione të tjera (vazhdim)

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjesinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që kemi marrë gjatë auditimit ose në rast se përmbajnë gabime materiale. Nëse, bazuar në punën e kryer, ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne na kërkohet të raportojmë mbi këtë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në këtë drejtim.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Bankës për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqes në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Bankës, dhe të përdor parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lartë. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si dhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Bankës për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Bankës, ku përveç çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania sh.p.k.

Deloitte Audit Albania sh.p.k

Rr. Elbasanit, Pallati poshtë Fakultetit Gjeologji - Miniera,

Tiranë, Shqipëri

Numër unik identifikimi subjekti (NUIS): L41709002H

Enida Cara
Partner Angazhimi
Auditues ligjor



Tiranë, Shqipëri
30 mars 2018



ALPHA BANK ALBANIA SHA

Pasqyrat e Fitimit Ose Humbjes Dhe e Të Ardhurave Të Tjera Gjithëpërfshirëse
(shumat në LEK'000)

	Shënime	Per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga interesat	6	2,422,090	2,798,610
Shpenzime për interes	6	(378,809)	(496,911)
Të ardhura neto nga interes		2,043,281	2,301,699
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	7	354,505	298,502
Shpenzime për tarifat dhe komisionet	7	(58,534)	(54,267)
Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet		295,971	244,235
Humbje minus fitim nga transaksionet financiare	8	(325,710)	(75,742)
Të ardhura të tjera operative		43,476	78,191
Të ardhurat totale		2,057,018	2,548,383
Shpenzime personeli	9	(772,627)	(725,577)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	17, 18	(100,489)	(105,532)
Shpenzime operative	10	(1,327,250)	(1,224,633)
Totali i shpenzimeve		(2,200,366)	(2,055,742)
Humbja neto nga zhvlerësimi për huatë	16	(741,611)	(1,876,187)
Humbja para tatimit		(884,959)	(1,383,546)
Tatimi mbi fitimin	11	62,125	(13,536)
Humbja e vitit		(822,834)	(1,397,082)
Të ardhura/ (humbje) të tjera gjithëpërfshirëse:			
Zëra që mund të klasifikohen në fitim ose humbje			
Rivlerësimi i aktiveve financiare të vlefshme për shitje	15	109,678	231,703
Tatimi	11	(16,452)	(34,755)
Rivlerësimi i aktiveve financiare të vlefshme për shitje neto, pas tatimit		93,226	196,948
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		93,226	196,948
Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin		(729,608)	(1,200,134)

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 79, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ALPHA BANK ALBANIA SHA


Pasqyra e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017


(shumat në LEK'000)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Aktivët			
Mjetet monetare dhe tepricat me Bankën Qëndrore	12	17,265,466	12,144,384
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	13	10,741,771	8,802,474
Aktive financiare të vlefshme për shitje	15	15,175,768	17,322,957
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	14	204,764	863,340
Kredi dhe paradhënie klientëve	16	31,902,943	32,563,711
Aktive afatgjata materiale	17	595,823	637,013
Aktive afatgjata jomateriale	18	52,210	22,506
Tatim fitim i parapaguar		123,508	236,124
Aktiv tatimor i shtyrë	11	4,568	-
Aktive të tjera	19	251,114	806,351
Aktive të riposeduara	19	417,959	405,059
Totali i Aktiveve		76,735,894	73,803,919
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave	20	2,361,741	1,984,101
Detyrime ndaj klientëve	21	62,078,425	58,837,612
Borxh i varur	22	2,130,360	2,166,923
Detyrime tatimore të shtyra	11	-	46,052
Detyrime të tjera	23	588,373	462,628
Totali i detyrimeve		67,158,899	63,497,316
Kapitali			
Kapitali aksionar	24	10,960,120	10,960,120
Rezerva ligjore	25	817,483	817,483
Rezerva të tjera	24	110,996	17,770
Humbja e akumuluar		(2,311,604)	(1,488,770)
Totali i Kapitalit		9,576,995	10,306,603
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit		76,735,894	73,803,919

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 79, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Këshilli Drejtues i Alpha Bank Albania SHA më 30 mars 2018 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:


Georgios Papanastasiou
Drejtore i Përgjithshëm


Enita Shallo
Drejtore e Divizionit të Financës dhe
Kontabilitetit

ALPHA BANK ALBANIA SHA

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Pasqyra e ndyshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Humbje të mbartura	Totali
Teprica më 1 Janar 2016	10,960,120	817,483	(179,178)	(91,688)	11,506,737
Humbja e vitit	-	-	-	(1,397,082)	(1,397,082)
Rivlerësimi i aktiveve financiare VPS, neto (shënimi 24)	-	-	196,948	-	196,948
Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	196,948	(1,397,082)	(1,200,134)
Teprica më 31 dhjetor 2016	10,960,120	817,483	17,770	(1,488,770)	10,306,603
Humbja e vitit	-	-	-	(822,834)	(822,834)
Rivlerësimi i aktiveve financiare VPS, neto (shënimi 24)	-	-	93,226	-	93,226
Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	93,226	(822,834)	(729,608)
Teprica më 31 dhjetor 2017	10,960,120	817,483	110,996	(2,311,604)	9,576,995

Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit duhet lexuar së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 79, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ALPHA BANK ALBANIA SH.A.

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet operacionale			
Humbja para tatimit		(884,959)	(1,383,546)
Rregullime për:			
Zhvlerësim dhe amortizim	17,18	100,489	105,532
Fitimi nga shitja e aktiveve të qëndrueshme		(1,593)	(2,036)
Aktive të qëndrueshme të çrregjistruara	17	21,881	67,001
Humbje nga zhvlerësimi	16	777,371	1,891,780
Të ardhura nga interesat	6	(2,422,090)	(2,798,610)
Shpenzime interesi	6	378,809	496,911
		(2,030,092)	(1,622,968)
Rritje e rezervës së detyrueshme	12	(370,515)	(410,244)
Rritje e kredive dhe paradhënieve për klientët		(587,635)	(2,356,924)
Rënie/Rritje në aktivet të tjera	19	650,006	(713,742)
Rritje në detyrimet ndaj bankave	20	377,640	1,978,085
Rritje në detyrimet ndaj klientëve	21	3,300,077	3,788,255
Rritje në detyrimet e tjera	23	89,211	48,931
Interesi i paguar		(389,053)	(531,398)
Interesi arkëtuar		2,893,122	3,548,965
Flukset neto të mjeteve monetare gjeneruar nga aktivitetet operacionale para tatimit		3,932,761	3,728,960
Tatim fitimi i paguar		-	-
Flukset neto të gjeneruar nga aktivitetet operacionale		3,932,761	3,728,960
Flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet investuese:			
Blerje e aktiveve afatgjata të qëndrueshme	17,18	(111,421)	(64,271)
Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme		2,130	2,400
Të ardhura nga shitja e letrave me vlerë		14,453,931	3,065,949
Blerje e instrumenteve financiare		(11,538,488)	(4,297,098)
Flukset neto të mjeteve monetare gjeneruara nga aktivitetet investuese		2,806,152	(1,293,020)
Flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet financuese:			
Ripagim i borxh të varur		(36,405)	(39,847)
Ripagim i qirasë financiare		(12,644)	(3,416)
Flukset neto nga aktivitetet financuese		(49,049)	(43,263)
Rritja neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e tyre		6,689,864	2,392,677
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të vitit		15,455,424	13,062,747
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të vitit	26	22,145,288	15,455,424

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet lexuar së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 79, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

1. Të përgjithshme

Alpha Bank A.E – Dega Tiranë u themeluar më 1998 si Alpha Bank A.E, Athinë (“Zyra Qëndrore”), e cila është kompania mëmë e shoqërive të Grupit Alpha Bank. Në 19 Dhjetor 2006, Bordi Drejtues i Zyrës Qëndrore aprovoi ndryshimin e emrit të Bankës në Alpha Bank – Albania (“Banka”). Zyrat qendrore të Bankës gjenden në Rugën e Kavajës, G – Kam Business Center, kati i 2-të, Tiranë, Shqipëri.

Në 29 Shkurt 2012, Banka u transformua në një filial, bazuar në vendimin nr.14 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe u liçensua për të kryer transferta pagesash, aktivitete kreditimi dhe mbajtje depozitash, si edhe aktivitete të tjera sipas ligjit Nr.8365, datë 2 Korrik 1998 “Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë”, i amenduar në 18 Dhjetor 2006 dhe ligjit Nr.8269, datë 23 Dhjetor 1997 “Mbi Bankën e Shqipërisë”, dhe ndryshoi emrin në Alpha Bank Albania SHA.

Banka ka 34 degë në të gjithë vendin (2016: 35 degë), nga të cilat 11 ndodhen në Tiranë (2016:11 degë)

2. Bazat e përgatitjes

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”), të publikuara nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (“BSNK”).

(b) Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të kostos historike, përveç aktiveve të mëposhtme të cilat janë matur me vlerën e drejtë.

- Aktiveve financiare të vlefshme për shitje

(c) Monedha raportuese

Këto pasqyra janë të paraqitura në Lek, e cila është monedha funksionale dhe raportuese e Bankës dhe të gjitha vlerat janë të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt (Lek'000), përveç rasteve kur cilësohet ndryshe.

(d) Gjykime të rëndësishme të kontabilitetit, vlerësime dhe supozime

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të ushtrojë gjykim dhe të bëjë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në shumat e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të jetë i ndryshëm nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve kontabël njihet në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në çdo periudhë tjetër të ardhshme të ndikuar nga ky rishikim.

Gjate aplikimit të politikave kontabël të Bankës, drejtimi ka ushtruar gjykim dhe vlerësim në përcaktimin e shumave të rregjistruara në pasqyrat financiare. Përdorimet më të rëndësishme të gjykimit dhe vlerësimit janë si më poshtë:

i. Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare të Bankës janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, e cila supozon se Banka do të vazhdojë aktivitetin e saj operacional në të ardhmen e parashikueshme. Për të bërë këtë gjykim, drejtimi ka marrë në konsideratë pozicionin financiar të Bankës, qellimet aktuale, përfitueshmerinë nga operacionet dhe burimet financiare dhe analizoi ndikimin e krizave financiare më të fundit në funksionimin e mëtejshëm të Bankës. Gjithashtu, Drejtimi nuk është në dijeni të pasigurive të mundshme që mund të shkaktojnë dyshime në aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi. Për këtë arsye, pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

(d) Gjykime të rëndësishme të kontabilitetit, vlerësime dhe supozime (vazhdim)

ii. *Vlera e drejtë e instrumenteve financiare*

Kur vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare të regjistruara në pasqyrën e pozicionit financiar nuk mund të përftohet nga tregje aktive, ajo përcaktohet duke përdorur një sërë metodash vlerësimi që konsistojnë në aplikimin e modeleve matematikore. Kur është e mundur, inputet për këto modele përftohen nga të dhënat e tregut. Në të kundërt, ushtrimi i gjykimit është i nevojshëm për përcaktimin e vlerës së drejtë. Gjykimi përfshin konsiderimin e likuiditetit dhe inputeve të modelit, si luhatjet për derivativët afatgjatë dhe normat skontuese, normat e parapagimit dhe supozime për normat e mosshlyerjes për letrat me vlerë të siguruara nga aktivet.

Politika kontabël e bankës për matjen e vlerës së drejtë përshkruhet në politikat e rëndësishme kontabël 3.(d).

Banka mat vlerën e drejtë duke përdorur një hierarki që reflekton rëndësinë e inputeve të përdorur në matje:

- Niveli 1: Çmimi i tregut (i pandryshuar) për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknika vlerësimi të bazuar në inpute të vëzhgueshëm, qoftë në mënyrë direkte (çmime) ose në mënyrë indirekte (të përfuar nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumenta që vlerësohen duke përdorur: çmimet e tregut në tregje aktive për instrumenta të ngjashëm; çmimet e tregut për instrumenta identikë ose të ngjashëm, në tregje të cilët konsiderohen më pak aktivë; ose metoda të tjera vlerësimi kur të gjithë inputet e rëndësishëm mund të vëzhgohen direkt ose indirekt nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Teknika vlerësimi që përdorin inpute të cilët nuk mund të vëzhgohen. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentet, teknika e vlerësimit të të cilëve konsiston në përdorimin e inputeve që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme, dhe ku inputet të cilët nuk mund të vëzhgohen kanë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumenta që vlerësohen bazuar në çmimet e tregut për instrumenta të ngjashëm, por të cilët kërkojnë ndryshime ose supozime të rëndësishëm për të reflektuar diferencat ndërmjet instrumenteve.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modelet e skontimit të flukseve monetare, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmime të vëzhgueshme në treg dhe të bazuar në një kurbë të kthimit aktual, të përshtatshme për afatin e mbetur deri në maturim. Supozimet dhe të dhënat e përdorura në teknikat e vlerësimit përfshijnë normat pa risk të interesit dhe normat e referencës të interesit, marzhin e kreditit dhe primeve të tjera të përdorura në vlerësimin e normave të skontimit, çmimet e kapitalit dhe obligacioneve, kurset e këmbimit valutor të monedhës, çmimet e kapitalit dhe indeksin e kapitalit të vet dhe luhatjet e pritshme të çmimeve dhe korrelacionet. Objektivi i teknikave të vlerësimit është të arrijë në përcaktimin e vlerës së drejtë që reflekton çmimin e instrumentit financiar në datën e raportimit, vlerë e cila do të ishte përcaktuar nga pjesëmarrësit e tregut që veprojnë në mënyrë të vullnetshme dhe janë të palidhur me njëri-tjetrin.

Çmimet e vëzhgueshme dhe inputet e modelit janë zakonisht të disponueshme në treg për obligacionet e listuara dhe letrat me vlerë të kapitalit, për derivativet e këmbyeshme në treg dhe derivativet e thjeshta “mbi banak”, si për shembull kontratat “swap” të normave të interesit. Disponueshmëria e çmimeve të vëzhgueshme të tregut dhe të dhënave të modelit zvogëlon nevojën për gjykim dhe vlerësim të drejtimit si dhe zvogëlon pasigurinë në lidhje me përcaktimin e vlerës së drejtë. Disponueshmëria e çmimeve të tregut të vëzhgueshme dhe të dhënave ndryshon në varësi të produkteve dhe tregjeve dhe është e prirur të ndryshojë në bazë të ngjarjeve të veçanta dhe kushteve të përgjithshme në tregjet financiare.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare jepet e detajuar në shënimin 5.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

(d) Gjykime të rëndësishme të kontabilitetit, vlerësime dhe supozime (vazhdim)

iii. Humbjet nga zhvlerësimi i kredive dhe paradhënieve

Në çdo datë raportimi, banka rishikon kreditë dhe parapagimet e rëndësishme për të vlerësuar nëse duhet të rregjistrojë një humbje nga zhvlerësimi në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Gjatë përcaktimit të humbjes nga zhvlerësimi, kërkohet në veçanti gjykim nga ana e drejtimit për vlerësimin e shumës dhe kohës së flukseve të ardhshme të parasë. Këto vlerësime bazohen në supozime dhe për pasojë, rezultat aktual mund të jenë të ndryshme nga vlerësimet, e cila mund të sjellë ndryshime të tjera në llogarinë e zbritjes.

Vlerësimi kolektiv merr parasysh të dhëna nga portofoli i kredisë (si niveli i pagesave të prapambetura, përdorimi i kredisë, raporti i kredisë me kolateralin etj) dhe konsiderime për efektin e rrezikut nga përqëndrimi dhe të dhëna ekonomike (niveli i papunësisë, indeksat e çmimeve të pasurive të paluajtshme, rrezikun e vendit dhe performancën e grupeve të ndryshme individuale)

Në qoftë se pas rregjistrimit të humbjes nga zhvlerësimi, ndodhin ngjarje të cilat çojnë në një reduktim të humbjes nga zhvlerësimi, ose arrijnë të mblidhen shumat e kredive ose parapagimeve të fshira më parë, rikuperimet rregjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes, në llogarinë e humbjeve nga zhvlerësimi dhe provigjioneve për të mbulur rrezikun e kredisë. Humbja nga zhvlerësimi i kredive dhe parapagimeve është detajuar në shënimin shpjegues 16.

iv. Zhvlerësimi i investimeve në aktive financiare të vlefshme për shitje

Në çdo datë raportimi, banka rishikon instrumentat e borxhit të klasifikuar si të vlefshëm për shitje për të përcaktuar nëse ato janë zhvlerësuar. Kjo kërkon gjykim të njëjtë me atë të përdorur për vlerësimin individual të kredive dhe paradhënieve.

Banka përcakton se letrat me vlerë të vlefshme për shitje zhvlerësohen kur ka patur një rënie të rëndësishme ose të zgjatur në vlerën e drejtë nën koston e tyre.

Përcaktimi se çfarë përbën një rënie të ndjeshme ose të zgjatur në kohë kërkon gjykim. Në këtë rast, mes faktorëve të tjerë, Banka vlerëson kohëzgjatjen dhe nivelin në të cilin vlera e drejtë e një aktivi është më e ulët se kostoja e tij. Përveç kësaj, zhvlerësimi mund të jetë i përshtatshëm në rastet kur evidentohet një përkeqësim i gjëndjes financiare të emetuesit të instrumentit, industrisë dhe performancës së sektorit, ndryshimet në teknologji dhe flukseve të parasë nga aktiviteti operacional dhe financues.

v. Aktivitetat më të shtyra

Aktivitetat më të shtyra rregjistrohen në lidhje me humbjet më të mëdha deri në masën që është e mundur që fitimi i tatueshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit humbjet mund të përdoren ose diferencat e përkohshme mund të anulohen.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

3. Përmbledhje e politikave kontabël

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Gjatë hartimit të pasqyrave financiare, transaksionet në monedha të ndryshme nga monedha funksionale e Bankës, janë njohur duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale të veprimtarisë me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Në çdo datë raportimi, aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj rivlerësohen në Lek me kursin në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundit të vitit. Aktivet dhe detyrimet jo monetare maten me kosto historike të monedhave të huaja dhe këmben me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

(b) Instrumentat financiarë – rregjistrimi fillestar dhe matja e mëvonshme

(i) Data e rregjistrimit

Të gjithë aktivet dhe detyrimet financiare rregjistrohen në datën kur Banka bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit

(ii) Matja fillestare e instrumenteve financiare

Banka rregjistron kreditë dhe parapagimet, depozitat, instrumentatat e borxhit të emetuara dhe detyrimet e varura në datën në të cilën ato krijohen. Blerjet dhe shitjet e rregullta të aktiveve financiare rregjistrohen në datën në të cilën banka angazhohet që të blejë ose të shesë aktivin. Të gjithë aktivet dhe pasivet e tjera financiare(duke përfshirë aktivet dhe pasivet e caktuara me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes) rregjistrohen në datën në të cilën Banka bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

Aktivt dhe detyrimet financiare maten fillimisht me vlerën e drejtë. Kostot e transaksionit që lidhen direkt me blerjen ose emetimin e aktiveve dhe detyrimeve financiare (përveç aktiveve dhe detyrimeve financiare që maten me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes) i shtohen ose zbriten vlerës së drejtë të aktiveve ose detyrimeve financiare në datën e rregjistrimit. Kostot e transaksionit që mund t'i atribuohen direkt blerjes së aktivit ose detyrimit financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes rregjistrohen menjëherë në pasqyrën e fitim humbjes.

(iii) Klasifikimi i aktiveve financiare

Aktivt financiare klasifikohen në kategoritë e specifikuar më poshtë:

- Hua dhe llogari të arkëtueshme
- Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim
- Aktive financiare të vlefshme për shitje
- Aktive financiare të njohura me vlerën e drejtë në pasqyrën e fitimit ose humbjes

Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i aktiveve financiare dhe përcaktohet gjatë njohjes fillestare. Të gjitha blerjet në mënyrë të rregullt ose shitjet e aktiveve financiare njihen dhe çregjistrohen mbi bazën e datës së tregtimit. Blerjet ose shitjet e rregullta janë blerjet ose shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarjen e aktiveve brenda afateve kohore të përcaktuara në rregulloret ose konventat në treg.

(iv) Klasifikimi i detyrimeve financiare dhe kapitalit

Klasifikimi si borxh ose kapital

Instrumentat e borxhit dhe kapitalit të emetuar nga Banka janë klasifikuar si detyrime financiare ose si kapital i vet në përputhje me thelbin e marrëveshjeve kontraktuale dhe përkufizimeve të detyrimit financiar dhe instrumenteve të kapitalit.

Instrumentat e kapitalit

Një instrument kapitali është çdo kontratë që evidenton një të drejtë të mbetur mbi aktivet e Bankës pas zbritjes së të gjitha detyrimeve të saj. Instrumentat e kapitalit neto të emetuara nga Banka janë të njohura për shumën e arkëtuar, neto nga kostot direkte të emetimit.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(b) Instrumentat financiarë – rregjistrimi fillestar dhe matja e mëvonshme (vazhdim)

(v) *Hua dhe paradhënie klientëve dhe bankave*

Hua dhe paradhënie për klientët dhe për bankat përfshijnë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv, dhe që Banka nuk ka ndërmend t'i shesë menjëherë ose në të ardhmen e afërt, përveç:

- Atyre që Banka ka për qëllim t'i shesë menjëherë ose në të ardhmen e afërt dhe atyre që Banka gjatë njohjes fillestare i përcakton si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes;
- Atyre që Banka, gjatë njohjes fillestare, i përcakton si të vlefshme për shitje.

Kur Banka është qiradhënëse në një marrëveshje qiraje që transferon te qiramarrësit të gjitha rreziqet dhe shpërblimet që lidhen me pronësinë e një aktivi, marrëveshja paraqitet brenda huave dhe paradhënieve.

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njëkohësisht hyn në një marrëveshje për të rishitur aktivin (ose një pasuri tërësisht e ngjashme) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme ("repo e anasjelltë ose huamarrje letrash me vlerë"), marrëveshja është kontabilizuar si marrëveshje e anasjelltë riblerjeje (letra me vlerë të kolateralizuara) dhe aktivet e lidhura me to nuk njihen në pasqyrat financiare të Bankës.

(vi) *Letrat me vlerë të investimit*

Letrat me vlerë të investimit kontabilizohen në varësi të klasifikimit të tyre, ose si të mbajtura deri në maturim, me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, ose të vlefshme për shitje.

(1) *Aktive financiare të mbajtura deri në maturim*

Investimet e mbajtura deri në maturim janë aktive jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet fiks të cilat Banka ka qëllimin dhe mundësinë t'i mbajë deri në maturim dhe të cilat nuk janë caktuar si me vlerë të drejtë në fitim ose humbje, ose si të vlefshme për shitje.

Investimet e mbajtura deri në maturim mbarten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shitja ose riklasifikimi i një shume të konsiderueshme të instrumentave financiare të mbajtura deri në maturim do të sillte tërësisht riklasifikimin e tyre në të vlefshme për shitje dhe do të ndalonte Bankën që të klasifikonte instrumentat financiarë në të mbajtura deri në maturim për periudhën korrente dhe për dy vitet e ardhshme financiare.

Megjithatë, shitja dhe riklasifikimi në një nga situatat e mëposhtme nuk do të ndikonte riklasifikimin:

- shitja dhe riklasifikimi që janë aq pranë maturimit sa që normat e interesit të tregut nuk do të kenë një ndikim të rëndësishëm në vlerën e drejtë të aktivitet financiar;
- shitja ose riklasifikimi pasi Banka ka mbledhur pjesën më të madhe të principalit të aktivitet, ose
- shitja ose riklasifikimi që vjen si pasojë e ngjarjeve jo të përsëritshme dhe të izoluara përtej kontrollit të bankës, të cilat nuk do të kishte qenë e mundur të parapriheshin.

(2) *Aktive financiare të vlefshme për shitje*

Investimet e vlefshme për shitje janë investime jo-derivative që nuk caktohen në një kategori tjetër të aktiveve financiare. Investimet e kapitalit të pakuotuar, vlera e drejtë e të cilave nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, mbarten me kosto. Të gjitha investimet e tjera të vlefshme për shitje mbarten me vlerë të drejtë.

Të ardhurat nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet ose humbjet nga kursi i këmbimit në investimet e borxhit të vlefshme për shitje, njihen direkt në humbje ose fitim. Ndryshime të tjera të vlerës së drejtë njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse deri kur investimi të jetë shitur ose zhvlerësuar dhe fitimi ose humbja e akumuluar të njihet në fitim ose humbje.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(b) Instrumentat financiarë – regjistrimi fillestar dhe matja e mëvonshme (vazhdim)

(vi) Letrat me vlerë të investimit (vazhdim)

(3) Instrumentat financiare me vlerën e drejtë përmes fitim-humbjes

Instrumentet financiare me vlerën e drejtë përmes fitim-humbjes janë ato instrumente që Banka gjatë njohjes fillestare vendos t'i masë me vlerën e drejtë përmes fitim-humbjes. Instrumentat financiare të tregtueshme janë ato instrumenta që Banka i blen me qëllim që t'i shesë për një afat të shkurtër kohe. Instrumentat financiare të tregtueshme njihen fillimisht dhe në vazhdimësi me vlerën e tyre të drejtë, ndërsa kostot e lidhura me këto transaksione shkojnë direkt në pasqyrën e të ardhurave. Të gjitha ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve aktive njihen si pjesë e të ardhurave prej interesave në pasqyrën e të ardhurave. Aktivitetet dhe detyrimet financiare të tregtueshme nuk riklasifikohen në vijim të regjistrimit fillestar, në dallim të aktiveve jo-derivative të tregtueshme, përveç atyre që maten fillimisht me vlerë të drejtë nëpërmjet humbjeve dhe fitimit të periudhës, që mund të riklasifikohen prej kësaj kategorie vetëm në rast se ato nuk mbahen më për t'u shitur apo për t'u riblerë në një periudhë afat-shkurtër dhe nëse përmbushen kriteret e mëposhtme:

- Nëse aktivi financiar do përmbushte përkufizimin e kredive dhe të arkëtueshmeve, atëherë mund të riklasifikohet nëse Banka ka qëllimin dhe mundësinë për të mbajtur aktivet financiare në të ardhmen e afërt ose deri në maturim.
- Nëse aktivi financiar nuk do të përmbushte përkufizimin e kredive dhe të arkëtueshmeve, atëherë mund të riklasifikohet prej kategorisë së të tregtueshmeve vetëm në “raste të jashtëzakonshme”.

(vii) Detyrime të tjera financiare

Borxhi i varur

Instrumentat financiarë të emetuara nga Banka, që nuk janë përcaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, janë klasifikuar si 'Borxhi i varur', ku thelbi i marrëveshjes kontraktuale rezulton në atë që Banka ka një detyrim për t'i shlyer mbajtësit, nëpërmjet mjeteve monetare ose aktiveve të tjera financiare, ose të përmbushë detyrimin nëpërmjet një mënyre tjetër përveçse duke këmbyer një shumë të caktuar parash ose aktive të tjera financiare për një numër fiks aksionesh në kapitalin e vet.

Pas matjes fillestare, borxhi i emtuar dhe huamarrjet e tjera maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit (NEI). Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje apo prim gjatë emetimit dhe kosto që janë pjesë përbërëse e Normës Efektive të Interesit (NEI).

Një analizë e borxhit të Bankës është paraqitur në shënimin 22.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(b) Instrumentat financiarë – rregjistrimi fillestar dhe matja e mëvonshme (vazhdim)

(vii) Detyrime të tjera financiare (vazhdim)

Depozita dhe detyrime të tjera financiare

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare janë pjesë e burimeve financuese të Bankës.

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe në të njëjtën kohë hyn në një marrëveshje për të riblerë aktivin (ose një aktiv të njëjtë) me një çmim të pandryshuar për një datë të mëvonshme (marrëveshje repo), marrëveshja do të njihet si depozitë, dhe aktivi në fjalë do vazhdojë të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Banka klasifikon instrumentat e kapitalit si detyrime financiare ose instrumente kapitali në përputhje me substancën e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht sipas vlerës së tyre të drejtë duke shtuar dhe kostot e drejtpërdrejta të lidhura me transaksionin, dhe njihet në vazhdimësi me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(c) Mosnjohja e aktiveve dhe detyrimeve financiare

(i) *Aktivet financiare*

Banka nuk e njeh më një aktiv financiar (e çregjistro) nëse të drejtat kontraktuale për përfitimin e parave nga aktivi janë shuar, ose nëse transferohen të drejtat për të marrë përfitimin kontraktual nga aktivi financiar dhe të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar të një njësie tjetër. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që krijohet ose mbahet nga Banka njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Banka kryen transaksione nëpërmjet të cilëve transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban të gjitha ose një pjesë të rreziqeve ose shpërblimeve të aktiveve të transferuara. Në rast se Banka mban të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet aktuale ose të mëvonshme, atëherë aktivet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve, ndërkohë që mbahen të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet aktuale ose të mëvonshme, përfshijnë për shembull huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionet e marrëveshjeve të riblerjes.

Kur aktivet i shiten një pale të tretë me një normë totale kthimi 'swap' për aktivet e transferuara, transaksioni kontabilizohet si një transaksion financues i sigurt, i njëjtë me riblerjen e transaksionit. Për transaksionet ku Banka as nuk mban dhe as nuk transferon në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe shpërblimet aktuale ose të mëvonshme që rrjedhin nga pronësia mbi aktivin financiar, ajo nuk e njeh (çregjistro) aktivin në rast se nuk ka kontroll mbi të. Të drejtat dhe detyrimet që mbahen gjatë transferimit njihen më vete si aktive dhe detyrime, sipas rastit. Në ato transferime ku ruhet kontrolli mbi aktivin, Banka vazhdon të njohë aktivin për aq kohë sa ky aktiv rezulton i përfshirë, gjë e cila përcaktohet nga niveli i ekspozimit ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivit të transferuar.

Në transaksione të caktuara Banka mban të drejtat e shërbimit ndaj një aktivi financiar të transferuar kundrejt një tarife. Aktivi i transferuar çregjistrohet tërësisht nëse plotëson kriteret e mosnjohjes.

(ii) *Detyrimet financiare*

Banka çregjistro detyrimet financiare atëherë, dhe vetëm atëherë kur, detyrimet e Bankës janë shkarkuar, anuluar ose kanë skaduar. Diferenca midis vlerës kontabël neto të detyrimit financiar të çregjistruar dhe shumës së paguar dhe të pagueshme njihet në fitim ose humbje.

Një aktiv ose detyrim njihet për të drejtat e shërbimit, në qoftë se tarifa e shërbimit është më e lartë se shpenzimet e shërbimit (aktiv) ose është më pak se e përshtatshme për të kryer shërbimin (detyrim).

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(d) Përcaktimi i vlerës së drejtë

'Vlera e drejtë' është çmimi me të cilin aktivi mund të shitet, ose një pasiv të transferohet, në një transaksion të zakonshëm mes pjesëmarrësve në treg në datën e matjes, në një treg primar ose në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm në të cilin Banka ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron rrezikun e mosekzekutimit të tij. Kur është e mundur, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmim të kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet aktiv në qoftë se transaksionet në lidhje me aktivin apo detyrimin zhvillohen me frekuencë dhe volum të mjaftueshëm për të siguruar informacion të çmimeve në baza të vazhdueshme. Nëse nuk ekziston një çmim i kuotuar në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknika vlerësimi të cilat maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve jo të vëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të kishin parasysh në vendosjen e çmimit të një transaksioni.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare të tij është zakonisht çmimi i transaksionit - dmth vlera e drejtë e konsideratës së dhënë ose të marrë. Nëse Banka përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe se vlera e drejtë nuk është evidentuar as me një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose detyrim identik e as nuk është e bazuar në një teknike vlerësimi e cila përdor vetëm të dhëna nga tregjet e vrojtueshme, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, rregulluar për të shtyrë në kohë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, kjo diferencë njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme mbi jetën e instrumentit, por jo më vonë se vlerësimi që mbështetet plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose kur transaksioni mbyllet.

Në qoftë se një aktiv ose pasiv i matur me vlerën e drejtë ka një çmim të ofruar dhe një çmim të kërkuar, atëherë Banka mat aktivet dhe pozicionet e gjata në çmimin e ofruar dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra në çmimin e kërkuar.

Vlera e drejtë e një llogarie kursimi nuk është më pak se shuma e pagueshme sipas kërkesës, skontuar nga data e parë kur mund të kërkohej pagimi i shumës.

Banka njih transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës raportuese gjatë së cilës ky ndryshim ka ndodhur.

(e) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Në fund të periudhës së raportimit financiar, Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të ndryshme nga mjetet monetare dhe ekuivalentët me to, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare konsiderohen të zhvlerësuar kur ka evidence që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit, dhe kjo ka një ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Banka konsideron mundësinë e zhvlerësimit në nivel individual dhe kolektiv. Të gjithë aktivet financiare individualisht të rëndësishme vlerësohen për zhvlerësim specifik. Aktivet të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme vlerësohen duke grupuar bashkë aktivet financiare (të mbajtura me kosto të amortizuar) me karakteristika të njëjta rreziku. Evidencë objektive që aktivet financiare janë zhvlerësuar mund të përfshijnë mospagimin ose shkeljet nga huamarrësi, ristrukturimin e kredisë ose paradhëniet nga Banka me kusht që Banka nuk do të konsiderojë të dhënat që një huamarrës ose emetues do të falimentojnë, zhdukjen e një tregu aktiv për instrumentat financiarë, ose të dhëna të tjera të vëzhgueshme që lidhen me një grup aktivesh të tilla si ndryshimet negative në statusin e pagesave të huamarrësit ose emetuesve në grup, ose kushte ekonomike që lidhen me dështimin në grup.

Për trajtimin e zhvlerësimit në grup Banka përdor modelimin statistikor të tredeve historike të probabilitetit të mospagimit, kohës së rikuperimit dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin e drejtimit nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike. Probabiliteti i mospagimit, normat e humbjes dhe përcaktimi i kohës së rikuperimit krahasohen me rezultatet aktuale për të siguruar që ato të mbeten të duhurat.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(e) Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

(i) Aktivitetet financiare me kosto të amortizuar

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të mbajtura me koston e amortizuar maten si diferencë midis vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve të pritshme skontuar me normën fillestare efektive të interesit të aktiveve. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari provizioni kundrejt huave dhe paradhënieve. Interesi mbi aktivet e zhvlerësuara vazhdon të njihet përmes rikthimit të zbritjes. Kur një ngjarje e mëvonshme bën që shuma e humbjes nga zhvlerësimi të ulet, humbja nga zhvlerësimi kthehet nëpërmjet fitimit ose humbjes.

(ii) Instrumentet financiarë të vlefshëm për shitje

Për instrumentat financiarë të vlefshëm për shitje, Banka vlerëson në çdo datë të pasqyrave financiare nëse ka evidencë objektive që një investim është zhvlerësuar.

Humbjet nga zhvlerësimi i letrave me vlerë të vlefshme për shitje njihen duke transferuar përmes një riklasifikimi, humbjen kumulative që është njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, në fitim ose humbje. Humbja kumulative që është riklasifikuar nga të ardhura të tjera, në fitim ose humbje, është diferenca midis koston së blerjes, neto nga çdo shlyerje principali dhe amortizimi, dhe vlerës së drejtë aktuale, minus ndonjë humbje nga zhvlerësimi e njohur më parë në fitim ose humbje. Ndryshimet në provizionet për zhvlerësim që i atribuohen vlerës në kohë janë pasqyruar si një komponent i të ardhurave nga interesi.

Nëse në një periudhë të mëvonshme vlera e drejtë e një letre me vlerë të vlefshme për shitje që është zhvlerësuar rritet, dhe rritja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi humbja nga zhvlerësimi është njohur në fitim ose humbje, humbja nga zhvlerësimi kthehet (rimerrret), dhe shuma e kthimit njihet në fitim ose humbje. Megjithatë, çdo rritje e mëvonshme në vlerën e drejtë të një letre me vlerë të zhvlerësuar të kapitalit njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

(iii) Kreditë e rinegociuara

Kur është e mundur, Banka kërkon të ristrukturojë kreditë në vend që të marrë në zotërim kolaterale. Kjo mund të përfshijë shtrirjen e afatit të pagesave dhe rënien dakord për kushte të reja të kredisë. Drejtimi vazhdimisht rishikon kreditë e rinegociuara për t'u siguruar që të gjitha kriteret janë përmbushur dhe se pagesat e ardhshme ka të ngjarë të ndodhin. Kur kreditë janë subjekt i një vlerësimi individual nga zhvlerësimi, llogariten duke përdorur normën fillestare efektive të interesit të kredisë, ndërsa kur janë subjekt i një vlerësimi kolektiv llogaritja bëhet përmes procedurës së përbashkët të vlerësimit.

(f) Kompensimi i instrumenteve financiarë

Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompensohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë, dhe vetëm atëherë, kur Banka ka të drejtën ligjore për të kompensuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregtar të Bankës.

(g) Matja me kosto të amortizuar e instrumenteve financiarë

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(h) Qiratë

Banka është qiramarrëse si në qiratë operative dhe ato financiare.

i. Qiratë operative

Qiratë që nuk transferojnë te Banka në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e lidhura me pronësinë e sendeve me qira janë qira operacionale.

Pagesat e qirasë operacionale njihen si shpenzime në pasqyrën e të ardhurave mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Qiratë e pagueshme njihen si një shpenzim në periudhën në të cilën ato ndodhin. Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në pasqyrën e të ardhurave bazuar në metodën lineare përgjatë kohëzgjatjes së qirasë.

ii. Qiratë financiare

Për qiratë financiare, aktivi i marrë me qira njihet si aktiv afatgjatë material dhe detyrimi përkatës njihet në detyrime të tjera. Pagesat minimale të kryera për qiranë financiare ndahen mes shpenzimeve financiare dhe zvogëlimit të detyrimit të mbetur.

Shpenzimet financiare shpërndahen në çdo periudhe gjatë kohëzgjatjes së qirasë, duke nxjerrë një normë konstante interesi mbi gjendjen e mbetur të detyrimit. Pagesat e kushtëzuara të qirave njihen duke rishikuar pagesat minimale të qirasë për kohën e mbetur të qirasë në momentin kur sistemimet për qiranë janë konfirmuar.

(i) Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat njihen në atë masë që është e mundur që përfitimet ekonomike do të rrjedhin në Bankë dhe të ardhurat mund të maten me besueshmëri. Kriteret e mëposhtme specifike të njohjes gjithashtu duhet të plotësohen para se të ardhurat njihen.

(i) Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së mjetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme për një periudhë më të shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të mjetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset duke marrë parasysh njohjen fillestare të aktiveve ose detyrimeve financiare.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha shumat e paguara ose të marra në avancë, kostot e transaksionit, zbritjet dhe primet të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ose emetimin apo nxjerrjen jashtë përdorimit të një mjeti apo detyrimi financiar. Të ardhurat dhe shpenzimet për interesat të paraqitura si fitim ose humbje përfshin interesin e aktiveve dhe detyrimeve financiare me kosto të amortizuar me normë interesi efektive.

Vlera kontabël e aktiveve apo detyrimeve financiare rregullohet nëse Banka rishikon vlerësimet e pagesave apo arkëtimeve. Vlera kontabël e rregulluar llogaritet bazuar në vlerën fillestare të Normës Efektive të Interesit (NEI) dhe ndryshimi në vlerën kontabël regjistrohet si "Të ardhura të tjera operative".

Në momentin që vlera e regjistruar e aktivitetit financiar ose e një grupi të ngjashëm aktiveve financiare zvogëlohet si pasojë e humbjes nga zhvlerësimi, të ardhurat nga interesi vazhdojnë të njihen duke përdorur normën e interesit të përdorur për të skontuar të hyrat e ardhshme për qëllimet e matjes së humbjes nga zhvlerësimi.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(i) Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve (vazhdim)

(i) Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit (vazhdim)

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përfshijnë:

- Interesin mbi aktivet dhe detyrimet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar, të llogaritura mbi bazën e normës efektive të interesit
- Interesin mbi të gjitha aktivet dhe detyrimet e tregtueshme
- të ardhura nga interesi mbi të gjitha letrat me vlerë të vlefshme për shitje

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të të gjitha aktiveve dhe detyrimeve të tregtueshme vijnë si rrjedhojë e aktivitetit tregtar të Bankës dhe prezantohen si të ardhura ose shpenzime neto nga interesi.

(ii) Të ardhura dhe shpenzime për komisione dhe tarifa

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifavat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit në një mjet ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Banka fiton të ardhura prej komisioneve dhe tarifave nga një shumëllojshmëri e gjerë shërbimesh që i ofron klientëve të saj.

Të ardhurat prej tarifave mund të ndahen në dy kategoritë e mëposhtme:

Të ardhura nga tarifavat e shërbimeve që ofrohen për një periudhë të caktuar

Tarifavat e fituara për ofrimin e një shërbimi gjatë një periudhe të caktuar kohore akumulohen gjatë kësaj periudhe. Këto tarifa përfshijnë të ardhura prej komisioneve dhe menaxhimit të aktiveve, tarifë për kujdestarinë, menaxhimin dhe këshillimin.

Tarifa e angazhimit për kreditë që ka të ngjarë të disbursohen dhe tarifa të tjera të lidhura me to shtyhen (bashkë me kosto të tjera të lidhura) dhe njihen si sistemime të normës efektive të interesit të këtyre kredive. Kur nuk ka të ngjarë që kredia të disbursohet, tarifa e angazhimit për kredinë njihet përgjatë kohës së angazhimit sipas metodës lineare.

Të ardhura nga tarifavat e shërbimeve të transaksioneve

Tarifavat që rrjedhin nga negociimi ose pjesëmarrja në negociatat me palët e treta për një transaksion, si për shembull tarifa shërbimi, komisione mbi shitjet, tarifavat e vendosjes, përgatitjen e blerjes së letrave të investimit, njihen në përfundim të transaksionit me të cilin lidhen. Tarifavat ose komponentët e tarifave që lidhen me një rezultat të caktuar njihen pas përmbushjes së kriterëve përkatëse. Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve të tjera lidhen kryesisht me tarifavat e shërbimeve dhe transaksioneve, të cilat shpenzohen gjatë kohës që ofrohet shërbimi.

(j) Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha, shuma të pakushtëzuara me Bankën Qendrore dhe investimet me likuiditet të lartë të cilat kanë maturim tre mujor ose më të vogël, të cilat janë subjekt i rreziqeve të parëndësishme të ndryshimit të vlerës së drejtë dhe përdoren nga Banka në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

Aktivitet monetare dhe ekuivalentet me to mbarten me koston e amortizimit në pasqyrën e pozicionit financiar.

(k) Letra me vlerë të investimit

Letrat me vlerë të investimeve fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kosto direkte transaksioni dhe më pas mbarten në varësi të klasifikimit të tyre, si të mbajtura deri në maturim, me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, ose të vlefshme për shitje.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(l) Aktivet afatgjata jo materiale

Programet kompjuterike të blera nga Banka njihen me kosto fillestare duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij mjeti. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimit njihet në fitim ose humbje sipas bazës lineare mbi jetën e dobishme të programeve, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme e çmuar për programin është katër vjet. Metodatat e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlerat e mbetura rivlerësohen në datën e raportimit, dhe sistemohen nëse është e nevojshme.

(m) Aktivet afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale maten me koston e blerjes minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi.

Kostot përfshijnë shpenzime të cilat i atribuohen direkt blerjes së aktivitet. Kostot e aktiveve të ndërtuara vetë përfshijnë kostot e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivitet në punë për qëllimin e përcaktuar dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes dhe ristrukturimit në vendin në të cilin ato ndodhen. Kur pjesët e një zëri të ndërtesës dhe pajisjeve kanë jetë përdorimi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndarë (komponentët kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimi ose humbja prej shitjes së një zëri të aktiveve afatgjata materiale përcaktohet duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën e mbartur të atij aktivitet, dhe njihet në vlerë neto si të ardhura të tjera në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e pjesëve të zëvendësuara të pronës dhe pajisjeve njihet me vlerën e mbartur nëse është e mundur që në të ardhmen Banka do të këtë përfitime ekonomike nga këto pjesë dhe kostot e tyre mund të njihen në mënyrë të besueshme. Vlera e mbartur e pjesëve të zëvendësuara më pas çregjistrohet. Kostot e mirëmbajtjes së përditshme njihen në fitim ose humbje në momentin kur lindin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në të ardhura dhe shpenzime me anën e metodës lineare mbi jetën e dobishme të vlerësuar të çdo zëri të aktivitet.

Jeta e dobishme e vlerësuar për periudhën korrente dhe ato krahasuese është si më poshtë.

- | | |
|-------------------------------------|--|
| • Mobilje dhe pajisje zyre | 5 vjet |
| • Automjete | 5 vjet |
| • Pajisje elektronike | 4 vjet |
| • Përmirësimet e ambienteve me qira | më e shkurtra mes jetës së dobishme dhe afatit të qirasë |

Metodat e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlerat e mbetura rivlerësohen në datën e raportimit, dhe sistemohen nëse është e nevojshme.

(n) Aktivitet e riposeduara

Aktivitet e riposeduara përfshijnë aktive jo-financiare të marra me forcë për huatë dhe paradhëniet jo-performuese ndaj klientëve, të cilat Banka nuk i përdor apo nuk përfiton qira dhe i mban me qëllim për t'i shitur në një periudhë të arsyeshme afatshkurtër, pa bërë ristrukturime të rëndësishme.

Aktivitet e riposeduara njihen fillimisht dhe rivlerësohen me vlerën më të vogël mes asaj kontabël neto dhe vlerës neto të realizueshme. Çdo humbje që vjen si pasojë e këtij vlerësimi njihet në fitim ose humbje dhe mund të kthehet (rimarret) në të ardhmen. Aktivitet në këtë kategori nuk amortizohen. Fitimi ose humbja nga shitja e këtyre aktiveve njihet në fitim ose humbje.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(o) Zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare

Vlera kontabël e aktiveve jofinanciare të Bankës, përveç aktiveve për tatime të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e aktivitetit tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e aktiveve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivitetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet çmimit neto të shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të aktiveve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivitetin. Humbjet e mëparshme rishikohen për të vlerësuar nëse rënia në vlerë është zbutur ose nuk ekziston më. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim, dhe ka pasur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë sa vlera e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

Për çdo aktiv bëhet një vlerësim në fund të çdo periudhe raportuese nëse ka tregues që ka humbje nga zhvlerësimi të regjistruara në periudhat paraardhëse të cilat mund të mos ekzistojnë më ose mund të jenë zvogëluar akoma. Nëse ka tregues të tillë, Banka çmon vlerën e rikuperueshme të aktivitetit ose Njesisë Gjeneruese të Parasë.

(p) Garancitë financiare

Garancitë financiare janë kontrata që e detyrojnë Bankën që të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që lind kur një debitor specifik nuk paguan në afat sipas termave të një instrumenti huadhënës. Detyrimet për garancitë financiare fillimisht njihen në vlerën e drejtë dhe vlera fillestare amortizohet mbi jetën e garancisë financiare. Detyrimi për garancinë mbahet me vlerën më të lartë midis vlerës me kosto të amortizuar dhe vlerës aktuale të pagesave të pritshme (kur pagesa nën një garanci është bërë e mundshme). Garancitë financiare përfshihen tek detyrimet e tjera.

(q) Provigjione

Një provizion është njohur nëse, si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të matet me besueshmëri, dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provizioni matet duke skontuar fluksin e pritshëm të parave dhe duke përdorur një normë para tatimit që reflekton vlerën në kohë të parasë sipas kushteve aktuale të tregut, dhe kur është e nevojshme, rreziqet që lidhen me këtë detyrim. Shpenzimi që lidhet me këtë provizion paraqitet në vlerën neto prej rimbursimeve të mundshme në pasqyrën e të ardhurave.

(r) Përfitimet e personelit

(i) Sigurimet shoqërore të detyrueshme

Banka paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoriteti i Sigurimeve Shoqërore është përgjegjës për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributesh të përcaktuara për pensione. Kontributet për planin e pensionit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato ndodhin.

(ii) Leja vjetore e paguar

Banka njih si detyrim shumë të përllogaritur të koston që pritet të paguhet në këmbim të shërbimeve të punëmarrësit për periudhën.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(r) Përfitimet e personelit (vazhdim)

(iii) Sigurimet shëndetësore të punonjësve

Banka gjithashtu paguan kontribute të përcaktuara për sigurimin shëndetësor të punonjësve. Kontributi është i pagueshëm ndaj shoqërisë së sigurimeve në raport me shërbimet e kryera në Bankë nga ana e punonjësve dhe është regjistruar si një shpenzim nën 'shpenzime të personelit'. Kontributet e papaguara janë regjistruar si detyrime.

(s) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë.

(i) Tatimi aktual mbi fitimin

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm vjetor. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi i raportuar në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për shkak të zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshëm ose të zbritshëm në periudhat e ardhshme dhe zërave që nuk taten apo nuk njihen asnjëherë si të zbritshëm.

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin njihen në fitim ose humbje, përveç në masën që lidhet me zërat e njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme në përputhje me legjislacionin tatimor Shqiptar. Të ardhurat e tatueshme llogariten duke rregulluar fitimin para tatimit për shumën e të ardhurave shpenzimeve të caktuara, siç kërkohet nga legjislacioni Shqiptar.

(ii) Tatimi i shtyrë mbi fitimin

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi dhe vlerës kontabël të përdorura për qëllim fiskale. Detyrimet tatimore të shtyra njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme përveç rasteve kur tatimi i shtyrë vjen si rezultat i njohjes fillestare të një aktivi apo detyrimi që nuk ka të bëjë me një kombinim biznesi, dhe kur kryhet transaksioni ai nuk ndikon as fitimin kontabël dhe as fitimin apo humbjen tatimore.

Aktivitet tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme, mbartjen e kreditit tatimor të papërdorur, në atë masë që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë të disponueshme, ndaj të cilave ato mund të shfrytëzohen, përveç rasteve kur aktivi tatimor i shtyrë që lidhet me diferenca të zbritshme të përkohshme vjen si rezultat i njohjes fillestare të një aktivi apo detyrimi që nuk ka të bëjë me një kombinim biznesi, dhe kur kryhet transaksioni ai nuk ndikon as fitimin kontabël dhe as fitimin apo humbjen tatimore.

Vlera kontabël neto e aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në fund të çdo periudhe raportimi dhe zvogëlohet në atë masë që nuk është e mundur që të ketë fitime të tatueshme të mjaftueshme në dispozicion për të lejuar që e gjitha ose një pjesë e aktivitet të mund të rikuperohet. Aktivitet tatimore të shtyra që nuk janë njohur rivlerësohen në fund të çdo periudhe raportuese dhe njihen deri në atë masë që fitimi i mundshëm tatimor do jetë i mjaftueshëm për të mbuluar aktivitet tatimore të shtyra.

Detyrimet dhe aktivitet e shtyra tatimore maten me normat e tatimit të cilat pritet të aplikohen në periudhën kur detyrimi do të shlyhet ose aktivi realizohet, bazuar në normat fiskale dhe ligjet fiskale të cilat janë miratuar ose priten të miratohen në datën e raportimit.

Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë mbi fitimin që njihet direkt në zërat e kapitalit regjistrohen në kapitalin e Bankës, ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe jo në fitim ose humbje.

Aktivitet tatimore të shtyra dhe detyrimet tatimore të shtyra mund të kompensohen nëse një e drejtë e detyrueshme me ligj ekziston për të kompensuar këto aktive dhe detyrime tatimore të shtyra ndaj së njëjtës njësi tatimore apo autoriteti tatimor.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(t) Rezerva

Rezervat që regjistrohen në kapital në pasqyrat financiare të Bankës përfshijnë:

- Rezerva për 'aktive të vlefshme për t'u shitur' e cila përbëhet prej ndryshimit në vlerën e drejtë të investimeve VPS.
- 'Rezerva ligjore', e cila përmban vlerën e rezervës ligjore krijuar sipas rregulloreve të Bankës së Shqipërisë (Shënimi 25).
- 'Rezerva rivlerësimi' e cila përfaqëson shumën që i është shtuar kapitalit të paguar të degës pas transformimit në filial, duke përdorur kursin e këmbimit më 31 dhjetor 2011.

(u) Standarde të reja, ndryshime dhe interpretime ende të paadoptuara

Disa standarde të reja, ndryshime të standardeve ekzistuese dhe interpretime nuk janë efektive për periudhën deri në 31 dhjetor 2017, dhe nuk janë aplikuar paraprakisht në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Ato të cilat mund të jenë të rëndësishme për Bankën janë të renditura më poshtë:

Amendime të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit 7 "Pasqyra e Fluksit Monetar"

Më 29 janar 2016, BSNK publikoi një amendim të SNK 7 sipas të cilit një entitet duhet të japë informacion shpjegues që lejon përdoruesin e pasqyrave financiare të vlerësojë ndryshimet në detyrime për të cilat rrjedha e parasë klasifikohet në pasqyrën e rrjedhës së parasë si rrjedhë paraje nga aktiviteti financiar. Ndryshimet që duhet të shpjegohen, të cilat mund të lindin nga ndryshime të lidhura ose jo me paranë, përfshijnë:

- Rrjedha e parasë nga aktiviteti financiar
- Ndryshime që lindin nga marrja ose humbja e kontrollit të filialeve ose bizneseve të tjera
- Efekti i ndryshimeve të kursit të këmbimit
- Ndryshime në vlerën e drejtë
- Ndryshime të tjera

Shënimet shpjeguese 22 dhe 23 janë ndryshuar për të reflektuar amendimin e mësipërm.

Amendime të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit 12 "Tatim fitimi" ; Njohja e Aktivit Tatimor të Shtyrë për humbjet e përealizuara

Më 19 janar 2016, BSNK publikoi një amendim të SNK 12, i cili shpjegon :

- Humbjet e përealizuara për instrumentet e borxhit të matur me vlerë të drejtë për qëllime kontabiliteti dhe me kosto për qëllime tatimore mund të sjellin diferenca të përkohshme të zbritshme pavarësisht faktit nëse mbajtësi i instrumentit të borxhit pret të rikuperojë vlerën kontabël të aktivitetit me anë të shitjes ose përdorimit.
- Rikuperueshmëria e një aktiviteti tatimor të shtyrë vlerësohet duke marrë parasysh aktivitetet e tjera tatimore të shtyra. Gjithësesi, nëse ligji i taksave lejon kompensimin e llojeve të caktuara të humbjeve kundrejt një lloji të caktuar të të ardhurave, aktiviteti tatimor do të vlerësohet duke marrë parasysh aktivitetet e tjera tatimore të të njëjtit lloj.
- Gjatë vlerësimit të rikuperueshmërisë së aktivitetit tatimor të shtyrë, një entitet krahason diferencat e përkohshme të zbritshme me tatim fitimit të ardhshëm që përjashton zbritjet nga taksat të lindin nga anulimi i këtyre diferencave të përkohshme.
- Vlerësimi i tatimit fitimit të mundshëm të ardhshëm mund të përfshijë rikuperimin e disa nga aktiveve financiare të entitetit për një vlerë më të lartë se vlera e tyre kontabël nëse ka prova të mjaftueshme se ekziston mundësia që entiteti mund të arrijë këtë gjë.

Adoptimi i amendimeve të mësipërme nuk pati ndonjë impakt në pasqyrat financiare të Bankës.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(u) Standarde të reja, ndryshime dhe interpretime ende të paadoptuara (vazhdim)

Përmirësime të SNRF, cikli 2014-2016 (Rregullorja 2018/182/7.2.2018)

Si pjesë e ndryshimeve të përvitshme, BSNK publikoi më 8 dhjetor 2016, amendime të SNRF 12, me anë të të cilit sqaron se entitetet nuk janë të përjashtuara nga të gjitha kërkesat për pasqyra shpjeguese të SNRF 12 përsa i përket interesit në entitete të klasifikuar si të mbajtur për shitje (ose të përfshira në një grup të nxjerrë jashtë përdorimit) ose si operacione jo të vijueshme, por vetëm për shënime shpjeguese të veçanta.

Adoptimi i amendamentit të mësipërm nuk pati ndonjë impakt në pasqyrat financiare të Bankës.

Përmirësime të SNRF 2, “Pagesa të Bazuar në Aksione”; Klasifikimi dhe matja e Transaksioneve të Pagesave të Bazuara në aksione”

Efektive për periudhat që fillojnë më ose mbas 1 janar 2018

Më 20 qershor 2016 BSNK publikoi një amendim të SNRF 2 me anë të të cilit sqaroi:

- Gjatë vlerësimit të vlerës së drejtë të transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione të shlyera me para, kontabilizimi i efekteve të konditave kushtëzuese dhe jo-kushtëzuese do të ndjekin të njëjtën metodë si transaksionet e pagesave të bazuara në aksione të cilat shlyen me aksione.
- Kur ligji i taksave kërkon që entiteti të mbajë një shumë të caktuar të taksës (që përbën një detyrim ligjor të punonjësit), që lidhet me pagesa të bazuara në aksione që do të kalohen autoritetit të taksave, atëherë kjo marrëveshje do të klasifikohet si e shlyer me aksione në tërësi, gjithmonë nëse pagesa e bazuar në aksione do të ishte klasifikuar si e shlyer me aksione nëse nuk do të kishte përfshirë karakteristikën e shlyerjes neto.
- Nëse afatet dhe kushtet e kontratës të një transaksioni të bazuar në aksione, të shlyer me para, modifikohen kjo çon në ndryshimin në një transaksion të bazuar në aksione të shlyer me aksione, transaksioni kontabilizohet si i tillë që nga data e modifikimit.

Banka po vlerëson impaktin e adoptimit të amendimeve të mësipërme në pasqyrat financiare.

Amendime të SNRF 4 “Kontratat e Sigurimit” : Aplikimi i SNRF 9 Instrumentat Financiarë me SNRF 4 Kontratat e Sigurimit

Efektive për periudhat që fillojnë më ose mbas 1 janar 2018

Më 12 shtator 2016, BSNK publikoi një amendim të SNRF 4 me anë të të cilit:

- I mundëson kompanive të sigurimit, aktiviteti i të cilëve është kryesisht i lidhur me sigurimin, të jenë përkohësisht të përjashtuar nga aplikimi i SNRF 9 deri më 1 janar 2021 dhe
- Pas aplikimit të plotë të SNRF 9 dhe deri në aplikimin e SNRF 17, të gjithë entitetet me kontrata kanë opsionin të regjistrojnë ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve të caktuara financiare në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, në vend të fitim-humbjes.

Amendimi i mësipërm nuk aplikohet në pasqyrat financiare të Bankës.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(u) Standarde të reja, ndryshime dhe interpretime ende të paadoptuara (vazhdim)

Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 9 “Instrumentat Financiare”

Efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1.1.2018.

Më 24.7.2014, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit publikoi tekstin përfundimtar të SNRF 9: Instrumentat financiare, i cili zëvendëson udhëzimin ekzistues të SNK 39. SNRF 9 sjell dallime të rëndësishme në klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare, si dhe në kontabilitetin mbrojtës. Një tregues i kërkesave të reja është paraqitur më poshtë:

Klasifikimi dhe matja

Instrumentet financiare duhet të klasifikohen, në momentin e njohjes fillestare, ose me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë. Kriteret që duhet të merren parasysh për klasifikimin fillestar të aktiveve financiare janë si më poshtë:

- i. Modeli i biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e aktiveve financiare dhe
- ii. Karakteristikat kontraktuale të flukseve monetare të aktiveve financiare.

Tre kategori të modelit të biznesit janë të specifikuara:

- Te mbajtura për të mbledhur flukse monetare kontraktuale
- Te mbajtura për të mbledhur dhe shitur
- Të tjera

Një instrument financiar do të matet me kosto të amortizuar nëse plotësohen të dy kushtet e mëposhtme:

- Instrumenti mbahet me anë të një modeli biznesi, objektivi i të cilit është të mbajë aktive financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale
- Afatet dhe kushtet e kontratës, mundësojnë, në data të caktuara, flukse monetare të cilat janë vetëm pagesa principali dhe interesi mbi principalin e mbetur

Nëse një instrument i plotëson kushtet e mëposhtme, por mbahet si me objektivin për ta shitur, ashtu edhe për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, do të klasifikohet si i matur me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

Aktivitetet financiare që nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme maten detyrimisht me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim-humbjes.

Lidhur me detyrimet financiare, ndryshimi kryesor është se ndryshimi në vlerën e drejtë të një detyrimi financiar të caktuar fillimisht me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes do të njihet në fitim ose humbje me përjashtim të efektit të ndryshimit në rrezikun e kredisë të detyrimeve i cili do të njihet drejtpërdrejt në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Zhvlerësimi

Ndryshe nga SNK 39 ekzistues, sipas të cilit një njësi ekonomike njih vetëm humbjet e kredisë të ndodhura, standardi i ri kërkon njohjen e humbjeve të kredisë që priten përgjatë gjithë jetës së tyre në qoftë se rreziku i kredisë së instrumentit financiar është rritur në mënyrë të konsiderueshme që prej njohjes fillestare. Në qoftë se rreziku i kredisë nuk është rritur në mënyrë të konsiderueshme që prej njohjes fillestare, do të njihen humbjet 12-mujore të pritshme të kredisë.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(u) Standarde të reja, ndryshime dhe interpretime ende të paadoptuara (vazhdim)

Standardi ndërkombëtar i raportimit financiar 9 "Instrumentat Financiare" (vazhdim)

Mbrojtja

Rregullorja e re për kontabilitetin mbrojtës janë më të linjëzuara me menaxhimin e rrezikut të entitetit. Ndryshimet kryesore në lidhje me kërkesat aktuale të SNK 39 janë si më poshtë:

- Më shumë instrumente bëhen të pranueshëm për të marrë pjesë në një marrëdhënie mbrojtëse qoftë si një instrument mbrojtës ashtu edhe si një instrument i mbrojtur
- Kërkesat që testi i efikasitetit të mbrojtjes duhet të jenë ndërmjet 80% - 125% është hequr. Testi i efikasitetit të mbrojtjes performohet vetëm në mënyrë progresive dhe në rrethana të caktuara një vlerësim cilësor konsiderohet i përshtatshëm.
- Në rast se një marrëdhënie mbrojtëse ndalon së qënuri efektive, por objektivi i menaxhimit të rrezikut në lidhje me atë marrëdhënie mbrojtëse ngelet i njëjtë, entiteti duhet të ribalancojë marrëdhënien mbrojtëse që të përmbushë kriterin e efikasitetit mbrojtës.

Vlen për tu theksuar se rregullorja e re për kontabilitetin mbrojtës nuk përfshin kërkesa lidhur me mbrojtjen makro, duke qënë se ato nuk janë finalizuar akoma.

Përveç modifikimeve të përmendura, publikimi i SNRF 9 ka rezultuar në një amendim të standarteve të tjera dhe kryesisht të SNRF 7 Instrumentat Financiare. Më shumë informacion për sa i përket implementimit të SNRF 9 është prezantuar në shënimin shpjegues 4 (h).

Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët"

Në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018 SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët", është lëshuar më 28 maj 2014 nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Standardi i ri është rezultat i një projekti të përbashkët nga ana e BSNK-së dhe Bordi i Standardeve të Kontabilitetit Financiar (BSKF) për të zhvilluar kërkesat e përbashkëta për sa i përket parimeve të njohjes së të ardhurave. Standardi i ri do të zbatohet për të gjitha kontratat me klientët, me përjashtim të atyre që janë në kuadër të standardeve të tjera, të tilla si qiraja financiare, kontratave të sigurimit dhe instrumenteve financiare. Sipas standardit të ri, një njësi ekonomike njihet të ardhurat për të përshkruar transferimin e mallrave ose shërbimeve të premtuara për konsumatorët në shumën që pasqyron pritshmërinë e njësisë ekonomike për këmbimin e këtyre mallrave ose shërbimeve. Është paraqitur një model i ri në njohjen e të ardhurave, duke zbatuar pesë hapat e mëposhtme:

- Hapi 1: Identifikimi i kontratës(ave) me një klient
- Hapi 2: Identifikimi i detyrimeve të performancës në kontratë
- Hapi 3: Përcaktimi i çmimit të transaksionit
- Hapi 4: Alokimi i çmimit të transaksionit sipas detyrimeve të performancës në kontratë
- Hapi 5: Njohja e të ardhurave kur (ose si) njësi ekonomike plotëson një detyrim të performancës.

Koncepti i detyrimit të performancës është i ri dhe paraqet një premtim në një kontratë me një klient për të transferuar tek konsumatori :

- një të mirë ose shërbim (apo një grup të mallrave ose shërbimeve) që është i dallueshem; ose
- një seri të mallrave ose shërbimeve të ndryshme që në thelb janë të njëjta dhe që kanë të njëjtën mënyrë të transferimit te konsumatori.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(u) Standarde të reja, ndryshime dhe interpretime ende të paadoptuara (vazhdim)

Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët" (vazhdim)

SNRF 15 e re zëvendëson:

- a) SNK 11 "Kontratat e Ndërtimit",
- b) SNK 18 "Të ardhurat",
- c) KIRFN 13 "Programet e Besnikërisë së Klientëve",
- d) KIRFN 15 "Marrëveshjet për Ndërtimin e Pasurive të Patundshme",
- e) KIRFN 18 "Transferimet e aseteve nga konsumatorët" dhe
- f) KIS-31 "Transaksionet e këmbimit që përfshijnë Shërbime Marketingu".

Vlerësimi i trajtimit kontabël që përdoret aktualisht për të njohur të ardhurat nga këto kontrata është në proces përfundimi; gjithsesi, duke qënë se praktikat aktuale të kontabilitetit të Bankës janë në linjë me kërkesat e standardit të ri, Banka nuk pret që aplikimi i standartit të ri të ketë një impakt domethënës në pasqyrat financiare.

Amendime të Standardit Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët" : Sqarime

Efektive për periudhat duke filluar nga ose pas 1 janar 2018

Më 12 prill 2016 BSNK publikoi një amendim të SNRF 15, me anë të të cilit sqaron:

- Kur një e mirë ose shërbim i premtuar është i identifikueshëm nga premtimet e tjera të kontratës, e cila është pjesë e vlerësimit të entitetit nëse një e mirë ose shërbim i premtuar është një detyrim performance
- Si të aplikohet udhëzimi principal përballë agjentit për të përcaktuar nëse natyra e e premtimit të një entiteti është të sigurojë një të mirë ose shërbim vetë(entiteti është një principal) ose të mundësojë të mira dhe shërbime të siguruara nga një palë tjetër
- Për një licensë të një prone intelektuale, që është një faktor në përcaktimin nëse entiteti njih të ardhurat gjatë një periudhe kohore ose në një pikë të caktuar kohë

Si përfundim, janë shtuar dy mjete praktike për të ndihmuar kalimin në SNRF 15 për kontratat e kompletuara nëpërmjet metodës së tranzicionit të plotë prapavështrues, ashtu si edhe për kontratat e përfunduara në tranzicion.

Impakti ng aplikimi i SNRF 15 në pasqyrat financiare është përmendur më lart.

Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 16 "Qiratë"

Në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019 - më 13 janar 2016, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit publikoi SNRF 16 "Qiratë" i cili zëvendëson:

- SNK 17 "Qiratë"
- KIRFN 4 "Përcaktimi nëse një marrëveshje përmban një qira"
- KIS 15 "Qiratë operative - Stimujt" dhe
- KIS 27 "Vlerësimi i përmbajtjes së transaksioneve që përfshijnë formën ligjore të një qiraje".

Standardi i ri evidenton dukshëm kontabilizimin e qirave për qiramarrësit duke ruajtur në thelb kërkesat ekzistuese të SNK 17 për Qiradhënësit. Në veçanti, në bazë të kërkesave të reja, klasifikimi i qirave si operative ose financiare, është eliminuar. Qiramarrësi është i detyruar të njohë, për të gjitha qiratë me afat prej më shumë se 12 muaj, të drejtat e përdorimit të pasurisë, si dhe detyrimin përkatës për të paguar këstet e qirasë. Trajtimi i mësipërm nuk është i nevojshëm kur aktivi është me vlerë të ulët. Banka është duke vlerësuar ndikimin e adoptimit të SNRF 16 në pasqyrat e saj financiare.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(u) Standarde të reja, ndryshime dhe interpretime ende të paadotura (vazhdim)

Përmirësime të SNK – cikli 2014 – 2016

Efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2018

Si pjesë e projektit të përmirësimit të përvitshëm, BSNK publikoi më 8 dhjetor 2016, amendime jo-urgjente por të nevojshme të SNRF 1 dhe SNK 28.

Amendimet e mësipërme nuk pritet që të kenë ndonjë efekt në pasqyrat financiare të Bankës.

Amendime të Standardit Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 9 “Financial Instruments”: Karakteristikat e Parapagimeve me Kompensim Negativ

Efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2019

Më 12 tetor 2017 BSNK publikoi një amendim të SNRF 9 që lejon disa aktive financiare të parapagueshme me karakteristika të kompensimit negativ, që ndryshe do të ishin matur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim-humbjes, të maten me kosto të amortizuar ose me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Amendimi i SNRF 9 sqaron se një aktiv financiar përmbush kriterin e “Vetëm Pagesa të Principalit dhe Interesit” pavarësisht ngjarjeve ose rrethanave që shkaktojnë përfundimin para kohe të kontratës dhe pavarësisht cila palë paguan kompensim të arsyeshëm për përfundimin para kohe të kontratës.

Banka po vlerëson impaktin që amendimet e mësipërme do të kenë në pasqyrat financiare.

Amendime të Standardit Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 10 “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe të Standardit Ndërkombëtar të Auditimit 28 “Investime në Filiale dhe Sipërmarrje të Përbashkëta”: Shitja ose kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe një filiali ose sipërmarrjeje të përbashkët

Efektive nga : për tu përcaktuar

Më 11 shtator 2014 BSNK publikoi një amendim të SNRF 10 dhe SNK 28 për të qartësuar trajtimin kontabël të një transaksioni shitjeje ose kontributi të aktiveve ndërmjet një investitori dhe një filiali ose sipërmarrjeje të përbashkët të tij. Në veçanti, SNRF 10 u amendua për të sqaruar se në rast se rezultati i një transaksioni me një filial ose sipërmarrje të përbashkët është humbja e kontrollit, investitori duhet të njohë në fitim humbje vetëm pjesën e fitim ose humbjes që është e lidhur me pjesën e palidhur të interesit të investitorit në atë filial ose sipërmarrje të përbashkët. Pjesa e mbetur e fitimit nga transaksioni do të eliminohet kundrejt vlerës kontabël të investimit në atë filial ose sipërmarrje të përbashkët. Gjithashtu, në rast se investitori ruan investimin në pjesëmarrje dhe pjesëmarrja është shndërruar në një filial ose sipërmarrje të përbashkët, njeh pjesën e fitimit ose humbjes që vjen nga rivlerësimi i investimit me vlerë të drejtë në fitim humbje vetëm për pjesën që nuk lidhet me pjesëmarrjen e investitorit. Pjesa e mbetur e fitimit eliminohet kundrejt vlerës kontabël të investimit të mbajtur në filialin e mëparshëm.

Në SNK 28, u sqarua se njohja e pjeseshme e fitimit ose humbjes do të aplikohet vetëm kur përfshin aktive që nuk përbëjnë një biznes. Në të kundërt, duhet të njihet i tërë fitimi ose humbja.

Më 17 dhjetor 2015, BSNK shtyu datën e paracaktuar të aplikimit të amendimeve të përcaktuara fillimisht. Data e re efektive do të përcaktohet nga BSNK në një datë të mëvonshme pasi të jenë marrë parasysh rezultatet e projektit të metodës së kapitalit.

Amendimet e mësipërme nuk pritet që të kenë efekt në pasqyrat financiare të Bankës.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(u) Standarde të reja, ndryshime dhe interpretime ende të paadoptuara (vazhdim)

Amendime të Standardit Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 14 “Llogari të shtyra për arsye rregullatore”

Efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2016

Më 30 janar 2014 BSNK publikoi SNRF 14. Standardi i ri, i cili ka shtrirje të limituar, adreson trajtimin kontabël dhe shënimet shpjeguese të kërkuara për llogaritë e shtyra që trajtohen në bazë të legjislacionit vendas kur entiteti siguron të mira ose shërbime që kanë një tarifë të rregulluar. Shtrirja e këtij standardi është e limituar për ata që e aplikojnë për herë të parë, të cilët i kanë njohur llogaritë e shtyra për arsye rregullatore në pasqyrat e tyre financiare sipas PPPK. SNRF 14 i lejon këto entitete të kapitalizojnë shpenzimet që kompanitë të cilat ofrojnë shërbime me tarifa të parregulluara do t'ju duhej t'i njihnin si shpenzime.

Bashkimi Evropian ka vendosur të mos lëshojë miratimin e këtij standardi dhe të presë për standardin final.

Standardi i mësipërm nuk është i aplikueshëm për pasqyrat financiare të Bankës.

SNRF 17 “Kontratat e Sigurimit”

Efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2021

Më 18 maj 2017, BSNK publikoi SNRF 17 e cila zëvendëson SNRF 4, Në dëllim nga SNRF 4, SNRF 17 paraqet një metodologji të qëndrueshme për matjen e kontratave të sigurimit. Parimet kryesore të SNRF 17 janë:

Një entitet:

- Identifikon si një kontratë sigurimi ato kontrata në të cilat entiteti pranon një rrezik të konsiderueshëm nga një palë tjetër, duke rënë dakord të kompensojë mbajtësin e policës së sigurimit nëse një ngjarje e ardhshme ndikon për keq tek mbajtësi i policës.
- Bën dallimin mes derivativëve të inkorporuar, përbërësit e ndryshëm të investimeve dhe detyrimet e performancës nga kontratat e sigurimit
- Ndan kontratat në grupe që t'i njohë dhe masë
- Njeh dhe mat grupet e kontratave të sigurimit me:

i.vlerën aktuale të flukseve monetare të rregulluar për rrezikun, që përfshin të gjithë informacionin për përmbushjen e flukseve monetare në një mënyrë që është konsistente me informacione të cilat janë të vëzhgueshme në treg, plus(nëse është një detyrim) ose minus (nëse është një aktiv)

ii.një shumë që përfaqëson fitimin e pafiturar në grupin e kontratave

- Njeh fitimin nga një grup kontratash sigurimi gjatë periudhës në të cilën kompania siguron mbulim, dhe kur entiteti lirohet nga rreziku. Nëse një grup kontratash është ose fillon të sjellë humbje, entiteti e njeh në mënyrë të menjëhershme humbjen.
- Prezanton veçmas të ardhurat dhe shpenzimet e sigurimit dhe të ardhurat dhe shpenzimet financiare
- Vendos shënime shpjeguese për të mundësuar përdoruesit e pasqyrave financiare të vlerësojnë efektet që kontratat nën SNRF 17 kanë në pozicionin dhe performancën financiare si edhe në rrjedhjet monetare të kompanisë.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(u) Standarde të reja, ndryshime dhe interpretime ende të paadotuar (vazhdim)

Amendime të Standardit Ndërkombëtar të Auditimit 19 "Përfitime të punonjësve": Amendime të planit, Shkurtime ose Zgjidhje

Efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2019

Më 7 shkurt 2018 BSNK publikoi një amendim të SNK 19 me anë të të cilit specifikon se si kompanitë duhet të përcaktojnë shpenzimet për pensionet kur ndodhin ndryshime në planin e pensionit me përfitim të caktuar. Në rast se ndodh ndonjë ndryshim, shkurtime ose zgjidhje, SNK 19 kërkon që kompania të rimasë detyrimin ose aktivin për pensionin me përfitim të caktuar. Amendimet për SNK 19 kërkojnë specifikisht që supozimet e përditësuara të përdoren nga kompania për të përcaktuar koston aktuale të shërbimit dhe interesin neto për pjesën e mbetur të raportimit pas ndryshimit të planit. Gjithashtu, SNK 19 sqaron efektin e amendimit, shkurtimeve ose zgjidhjes së planit mbi kërkesat lidhur me tavanin e aktiveve.

Banka po vlerëson efektin e aplikimit të amendimeve të mësipërme në pasqyrat financiare.

Ndryshimet në SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta" - interesa afatgjatë në Pjesëmarrje dhe Ndërmarrje të Përbashkëta (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2019),

Me 12 tetor 2017 BSNK publikoi një amendim të SNK 28 me anë të së cilës specifikon se interesat afatgjatë në ndërmarrje të përbashkëta që bëjnë pjesë në investimin neto, për të cilat metoda e kapitalit nuk është aplikueshme, duhet të llogariten duke përdorur SNK 19 duke përfshirë zhvlerësimin. Në aplikimin e SNK 19, entiteti nuk merr në konsideratë ndryshimet e mundshme të vlerës kontabël të interesave afatgjatë që mund të lindin nga aplikimi i amendimit të SNK 28.

Amendimi i përmendur me sipër nuk aplikohet në pasqyrat financiare të Bankës.

Ndryshimet në SNK 40 " Investime në Aktivet Afatgjata Materiale " - Transferimet e investimeve në aktivet afatgjata materiale (efektive më ose pas 1 janarit 2018),

Me 8 dhjetor 2016 BSNK publikoi një amendim të SNK 40 e cila specifikon se një entitet duhet të transferojë një aktiv afatgjatë tek ose nga investimet në aktivet afatgjata materiale nëse është evidentuar një ndryshim në qëllimin e përdorimit të tij. Një ndryshim në vlerë ndodh kur një aktiv afatgjatë përmbush kriteret e njohjes si investim në aktive afatgjata materiale për të cilat ka një evidencë lidhur me ndryshimin e qëllimit të përdorimit të tij. Në vazhdim, rastet e ndryshimit të qëllimit të përdorimit janë zgjeruar me qëllim për të përfshirë aktivet në ndërtim dhe jo vetëm transferimet nga aktivet afatgjata të përfunduara.

Amendimi i mësipërm nuk aplikohet në pasqyrat financiare të Bankës.

Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikli 2015-2017)"

Efektiv në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019

Si pjesë e projektit të përmirësimit vjetor, BSNK publikoi më 12 dhjetor 2017 disa amendime të domosdoshme por jo urgjente për një sërë standardesh.

Amendimi i mësipërm nuk aplikohet në pasqyrat financiare të Bankës.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(u) Standarde të reja, ndryshime dhe interpretime ende të paadoptuara (vazhdim)

Interpretimi i KIRFN 22 “Transaksione në monedhë të huaj”

Efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2018

Më 8 dhjetor 2016 BSNK publikoi KIRFN 22. Interpretimi mbulon transaksionet në monedhë të huaj kur një entitet njih një aktiv ose detyrim financiar që lind nga pagimi ose marrja e një paradhënieje para se entiteti të njohë aktivin, shpenzimin ose të ardhurën. Interpretimi qartëson se data e transaksionit që përdoret për të gjetur kursin e këmbimit për njohjen fillestare të aktivit, të ardhurës ose shpenzimit, është data e johjes fillestare të aktivit ose detyrimit jo monetar. Gjithashtu, nëse ka shumë pagesa ose shuma të arkëtuara, entiteti duhet të përcaktojë një datë transaksioni për çdo pagesë.

Standardi i mësipërm nuk është i aplikueshëm për pasqyrat financiare të Bankës.

Interpretimi i KIRFN 23 “Pasiguria mbi Trajtimin e Tatim Fitimit”

Efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2019

Më 7 qershor, BSNK publikoi KIRFN 23. Interpretimi qartëson aplikimin e kërkesave për matje dhe njohje të SNK 12 përsa i përket pasigurisë së trajtimit të Tatim Fitimit Interpretimi shpjegon:

- Një entitet duhet të vlerësojë nëse duhet të konsiderojë cdo rast kur ka pasiguri për tatim fitimin veçmas ose bashkë me raste të tjera të ngjashme, bazuar në metodën e cila parashikon më mirë zgjidhjen e konfliktit
- Vlerësimet për ekzaminimet nga autoriteti i taksave do të bazohen mbi faktin që autoriteti i taksave do të shqyrtojë çdo shumë që ka të drejtë ta shqyrtojë dhe do të ketë njohuri të plotë mbi çdo informacion të lidhur me atë që shqyrton.
- Për përcaktimin e fitimit të tatueshëm, bazës tatimore, humbjes tatimore të papërdorur, tatimeve kreditore të papërdorura dhe normave të taksës, një entitet duhet të konsiderojë nëse është e mundur që autoriteti i taksave do të pranojë një trajtim të pasigurtë të taksave.
- Një entitet duhet të rivlerësojë nëse faktet dhe rrethanat ndryshojnë si rezultat i informacionit të ri

Banka është duke vlerësuar impaktin nga adoptimi i interpretimeve të mësipërme në pasqyrat financiare.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar

(a) Një vështrim i përgjithshëm

Përdorimi i instrumenteve financiarë e ekspozon Bankën ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- **Rreziku i kredisë** - është rreziku i humbjes financiare të Bankës nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë në kohë apo plotësisht detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga instrumenti. Ky risk vjen nga mundësia që një debitor nuk ka vullnetin të shlyejë detyrimet ose aftësia e tij për të shlyer detyrimin është përkeqësuar duke rezultuar në humbje ekonomike për Bankën. Veç kësaj, humbjet rezultojnë edhe nga pakësimi në vlerën e portofolit për shkak të përkeqësimit aktual ose të perceptuar të cilësisë së kredisë së huamarrësit.
 - **Rreziku i përqendrimit** është një nënkategori e rrezikut të kredisë dhe përfshin si në vijim:
 - Ekspozimet e mëdha në një debitor të vetëm ose grup debitorësh të lidhur
 - Ekspozimet me rëndësi në grupe të palëve të treta, probabiliteti i mospagimit të të cilave është në varesi të faktorëve themelorë të përbashkët si industria, mjedisi makroekonomik, vendndodhja gjeografike dhe lloji i produktit.
 - **Rreziku i kundërpartisë** - është përcaktuar si rreziku që pala tjetër në një transaksion mund të dështojë para shlyerjes përfundimtare të flukseve të transaksioneve. Një humbje do të ndodhë në qoftë se transaksioni apo portofoli i transaksioneve me palën tjetër ka një vlerë pozitive në kohën e mospagimit.
- **Rreziku i likuiditetit** - është rreziku me të cilin përballen të ardhurat ose kapitali, që rrjedh prej aftësisë së Bankës për të përmbushur detyrimet e saj brenda afatit të shlyerjes, ose financimi i një biznesi të ri, pa pësuar humbje në nivele të papranueshme si dhe pa aftësia për të menaxhuar tkurrje të paplanifikuara ose ndryshime në burimet e financimit. Rreziku i likuiditetit rrjedh gjithashtu nga dështimi i Bankës për të njohur ose adresuar ndryshimet në kushtet e tregut që ndikojnë aftësinë për të likuiduar aktivet shpejt dhe me humbje minimale në vlerë.
- **Rreziku i tregut** - është rreziku për një rënie në vlerën ekonomike ose në të ardhurat e raportuara për shkak të lëvizjeve të përgjithshme në treg dhe përfshin llojet kryesore: rrezikun e normës së interesit, rrezikun nga kurset e këmbimit, rrezikun e çmimit të kapitalit dhe të çmimeve të të mirave. Për këtë arsye, rreziku i tregut përfshin llojet e mëposhtme të rrezikut: rrezikun e normës së interesit, rrezikun e këmbimit valutor, rrezikun e indeksit të kapitalit, rrezikun e kapitalit dhe rrezikun e të mirave. Ai i referohet regjistrimit tregtar dhe bankar.
- **Rreziku operacional** - përcaktohet si rreziku i ndodhjes së një ngjarjeje, me apo pa efekt financiar, që vjen prej proceseve të brendshme të dështuara apo të papërshtatshme, sistemeve të teknologjisë së informacionit, njerëzve (qëllimisht ose jo qëllimisht) dhe prej ngjarjeve të jashtme. Rreziku operacional përfshin gjithashtu rrezikun ligjor.

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit të Bankës.

Struktura e administrimit të rrezikut

Këshilli Drejtues ka përgjegjësinë për ndërtimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të rrezikut. Në përmbushjen e kësaj përgjegjësie Këshilli Drejtues ndihmohet nga Komiteti i Rrezikut. Detyrat dhe përgjegjësitë specifike të Komitetit të Rrezikut përcaktohen në "Rregullat dhe Rregulloret" e Komitetit të Rrezikut, në bazë të procedurave të brendshme të miratuara dhe të zbatuara nga Banka në përputhje me dispozitat e ligjit dhe të kuadrit rregullator.

Komiteti i Rrezikut rishikon, ndryshon dhe përditëson politikat e kreditimit, provigjonimit dhe fshirjes nga kontabiliteti të kredive, duke u mbështetur në shqyrtimin paraprak të Komitetit të Rrezikut të Kredive. Politikat përkatëse janë ratifikuar nga Këshilli Drejtues (KD). Përveç kësaj promovon një kulturë të fuqishme dhe pajtueshmëri në drejtimin e Rrezikut.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(a) Një vështrim i përgjithshëm (vazhdim)

Komiteti i Rrezikut është organi kompetent i cili i rekomandon KD rreziqet që duhet të merren dhe strategjitë e menaxhimit të kapitalit, të cilat korrespondojnë me objektivat e biznesit të Bankës dhe kontrollojnë e monitorojnë zbatimin e tyre. Komiteti i Rrezikut vlerëson përshtatshmërinë dhe efektivitetin e politikave të menaxhimit të rrezikut dhe procedurave të Bankës, në këto drejtime:

- Ndërmarrjen, monitorimin dhe menaxhimin e rrezikut për kategori transaksioni, klienti dhe niveli rreziku (vendi, profesioni dhe aktiviteti).
- Përcaktimi i maksimumit të Rrezikut të pranueshëm të aplikueshëm, duke u agreguar në bazë të secilit lloj rreziku dhe duke e ndarë më tej në kufij sipas vendit, sektorit, monedhës dhe njësisë së biznesit.
- Krijimi i kufijve për ndalim të humbjeve apo veprime të tjera rregulluese.

Përveç kësaj, Komiteti i Rrezikut siguron komunikimin midis Audituesit të brendshëm, Audituesve të jashtëm, Autoritetit Mbikëqyrës dhe Këshillit Drejtues për çështje të menaxhimit të rrezikut. Ai mbledhet në mënyrë periodike, jo më pak se katër herë në vit.

Këshilli Drejtues ka autorizuar komitete të ndryshme për qeverisjen e rreziqeve si më poshtë:

- Rreziku i tregut, duke përfshirë normën e interesit dhe rrezikun e likuiditetit: Komiteti i Aktiveve dhe Detyrimeve (ALCo);
- Rreziku i kredisë: Komiteti i Kreditit, Komiteti i Menaxhimit të rrezikut dhe Komiteti i Rrezikut; dhe
- Rreziku operacional: Komiteti i Rrezikut Operacional.

Kuadri për menaxhimin e rrezikut përshkruan përjasjet e ndjekura nga Banka për sa i përket kërkesave për kapitalin rregullator të përcaktuara sipas Basel II/Direktivës për Kërkesa për Kapital dhe kuadrit rregullator të vendit. Banka ka adaptuar një përjasje të plotë për sa i përket menaxhimit të rrezikut. Llojet e rreziqeve nuk menaxhohen në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, përkundrazi, mbi një bazë të unifikuar që merr parasysh mundësinë e mbivendosjes së rreziqeve me njëri-tjetrin. Gjatë proceseve të strategjisë të biznesit, theks i veçantë është vendosur në vëzhgimin e rreptë dhe përcaktimin e kufijve të pranueshëm të rrezikut.

Divizioni i Menaxhimit të Rrezikut është i pavarur nga të gjitha njësitë në ngarkim për aktivitetet Bankare, investuese, kontabilitetit dhe ato të cilët përdorin analiza rreziku të përgatitura nga të tjerë. Divizioni i menaxhimit të rrezikut është përgjegjës për krijimin dhe zbatimin e politikave të menaxhimit rrezikut, duke u mbështetur në udhëzimet e Këshillit Drejtues dhe Menaxhimit të përgjithshëm.

Në mënyrë të veçantë Divizioni i Menaxhimit të Rrezikut vepron si më poshtë:

- Prezanton dhe aplikon metodat dhe modelet e duhura për menaxhimin e rrezikut, duke përfshirë identifikimin e rrezikut, vlerësimin, monitorimin, kontrollin, raportimin dhe provën e qëndrueshmërisë.
- Shqyrton, ndryshon dhe propozon përditësime në politikat e kreditimit, provigjonimit dhe fshirjes së kredive nga kontabiliteti.
- Specializon, në bashkëpunim me njësi të tjera kompetente, limitet e rrezikut, duke identifikuar apo treguar parametra specifike për çdo lloj rreziku dhe i monitoron ato duke krijuar procedurat e duhura.
- Krijon kriteret parajlmëruese për portofolet, në baza të përgjithshme dhe individuale, dhe rekomandon procedurat dhe veprimet e duhura, në bazë të ekspozimit përkatës.
- Provon vlefshmërinë e politikave, proceseve dhe metodologjive të përdorura për aktivet dhe detyrimet financiare, vlerëson dhe kontrollon përshtatshmërinë e çmimeve të përdorura në procesin e vlerësimit.
- Rekomandon teknika për zbutjen e rrezikut apo për ta rregulluar atë duke e çuar në nivele të pranueshme.
- Vlerëson rregullisht përshtatshmërinë e metodave dhe sistemeve të përdorura për menaxhimin e rrezikut dhe rekomandon veprime rregulluese kur gjykohet e nevojshme.
- Krijon mekanizmat e kontrollit për zbatimin e politikave të rrezikut nëpërmjet rishikimeve analitike ose në terren dhe gjithashtu nëpërmjet rishikimit të regjistrimeve të mëparshme të kreditit.
- Bashkëpunon me njësitë kompetente për llogaritjen e kërkesës për kapital dhe gjithashtu për zhvillimin e metodologjive dhe teknikave përkatëse.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(a) Një vështrim i përgjithshëm (vazhdim)

Për të ushtruar detyrat në mënyrë efektive, njësia ka të drejtë hyrje në të gjitha aktivitetet dhe njësitë, si dhe në të gjitha të dhënat e Bankës dhe informacione të tjera të nevojshme për të përmbushur detyrat e saj.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Bankës janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar, përveç rreziqeve të hasura nga Banka, edhe limitet e rrezikut dhe për të vendosur kontrolle të përshtatshme për të monitoruar rrezikun dhe zbatimin e limiteve. Politikat e menaxhimit të rrezikut dhe procedurat rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe produktet e ofruara. Banka, nëpërmjet proceseve të vazhdueshme të trajnimeve ka për qëllim të zhvillojë një ambient të disiplinuar dhe kontrolluar në të cilin punonjësit i kuptojnë detyrat dhe rolet e tyre.

Struktura e Menaxhimit të Rrezikut të Grupit Alpha Bank

Alpha Bank Albania është filial i Alpha Bank A.E dhe ndjek të njëjtën strategji për menaxhimin e rrezikut si Alpha Bank Grup, si një aktivitet i cili kryhet kudo njëlloj në Alpha Bank dhe është në të njëjtën linjë me praktikën ndërkombëtare si dhe me rregullat mbikëqyrëse dhe udhëzimet të cilat evoluojnë vazhdimisht duke zhvilluar një kulturë të fortë rreziku që zbatohet nga i gjithë Grupi. Kultura e rrezikut është e ngulitur në të gjitha njësitë e biznesit nëpërmjet implementimit të Strukturës së Rrezikut të Grupit Alpha Bank dhe iniciativave në pajtueshmëri me Strategjitë e Rrezikut të Grupit.

- Grupi i Alpha Bank angazhohet për arritjen e një kontrolli të fortë të mjedisit, si dhe një aftësi të veçantë për menaxhimin e rrezikut që u mundëson njësitë të biznesit të përmbushin objektivat e tyre të performancës dhe për të arritur përmirësim të vazhdueshëm në fushën e menaxhimit të rrezikut. Grupi Alpha Bank kryen vlerësime të rregullta të rrezikut për llojet e ndryshme të rrezikut dhe veçanërisht si pjesë e procesit të planifikimit strategjik dhe ndonjëherë edhe të projekt planeve.
- Struktura e menaxhimit të rrezikut bazohet në parimet e mëposhtme:
 - Struktura e menaxhimit të rrezikut drejtohet nga niveli i rrezikut të pranueshëm
 - Struktura e menaxhimit të rrezikut është pjesë integrale e strategjisë së biznesit dhe e procesit të vendimmarrjes.
 - Struktura e menaxhimit të rrezikut drejtohet nga përgjegjësia.
 - Struktura e menaxhimit të rrezikut promovon transparencën nëpërmjet linjave të pastra të komunikimit.
 - Personeli i përfshirë në drejtimin e Bankës ka rol aktiv në menaxhimin e rrezikut dhe zotëron aftësitë e nevojshme për ta menaxhuar atë në mënyrë efektive.
 - Personeli i përcaktuar ka njohuri të mira të rolit dhe përgjegjësisë të tyre në kuadër të kornizës së menaxhimit të rrezikut.
 - Të gjithë elementët, identifikimi i rrezikut, vlerësimi, monitorimi, raportimi, kontrolli dhe sistemet janë të dokumentuar mirë dhe informacioni i duhur, me anë të mekanizmave të raportimit u jepet niveleve të menaxhimit dhe njësitë të biznesit.
- Struktura e menaxhimit të rrezikut është dinamike, ajo evoluon vazhdimisht në përgjigje të ndryshimeve të objektivave strategjike dhe kushteve të brendshme (organizacionale dhe të biznesit) dhe të jashtme (tregu).

Paqëndrueshmëria në tregjet financiare globale dhe Shqiptare

Banka operon në kushtet e një zhvillimi financiar global të vazhdueshëm duke u ndikuar njëkohësisht dhe nga krizat ekonomike. Shtrirja e saj e mëtejshme mund të rezultojë në ndikime negative në pozicionin financiar të Bankës. Drejtimi i Bankës kryen monitorime ditore të pozicionit të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe zhvillimeve në tregjet financiare ndërkombëtare, duke aplikuar praktikën me të mira Bankare. Drejtimi i Bankës në bazë të analizës së përfitueshmërisë, likuiditetit dhe kostos së fondeve, merr masat e duhura në lidhje me kreditimin, tregjet (normat e interesit) dhe rrezikun e likuiditetit, duke limituar në këtë mënyrë ndikimet negative të mundshme që vijnë nga kriza ekonomike, financiare, globale. Në këtë mënyrë Banka i përgjigjet zhvillimeve në mjedisin e tregut, duke mbajtur një nivel kapitali dhe një pozicion likuiditeti të qëndrueshëm.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Bankës nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga instrumenti në kohë apo plotësisht. Ky rrezik vjen nga mundësia që një debitor nuk ka dëshirën të shlyejë detyrimet ose aftësia e tij për të shlyer detyrimin është përkeqësuar duke rezultuar në humbje ekonomike për Bankën. Veç kësaj, humbjet rezultojnë edhe nga pakësimi në vlerën e portofolit për shkak të përkeqësimit aktual ose të perceptuar të cilësisë së kredisë së huamarrësit.

Rreziku i kredisë konsiderohet rreziku më i rëndësishëm për Bankën.

Banka njihet nevojën për të identifikuar, matur, monitoruar dhe kontrolluar rrezikun e kredisë të qenësishëm në aktivitetet e saj të huadhënies me pakicë dhe shumicë, si edhe për të përcaktuar që Banka mban kapital të përshtatshëm për t'u mbrojtur nga rreziku dhe ky rrezik kompensohet në mënyrë të përshtatshme. Banka synon që të mbajë ekspozimet e rrezikut të kredisë brenda niveleve të pranueshme. Banka ka autorizuar dhe themeluar komitetet përkatëse për të mbikëqyrur rrezikun e kredisë. Komiteti i rrezikut është përgjegjës për mbikëqyrjen e kuadrit për menaxhimin e rrezikut të kredisë. Komiteti i themeluar i Kredisë dhe Divizionet e Kredisë janë përgjegjës për mbikëqyrjen e aktiviteteve të lidhura me rrezikun e kredisë. Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut dhe Divizioni i Menaxhimit të Rrezikut janë përgjegjës për propozimin e politikave dhe procedurave të kredisë. Komiteti i Auditimit dhe Divizioni i Pavarur i Auditit të Brendshëm janë përgjegjës për t'u siguruar që praktikatat e rrezikut të kredisë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për aktivitetin e ndërmarrjes së rrezikut të kredisë. Divizioni i Menaxhimit të Rrezikut siguron përputhshmërinë dhe monitoron zbatimin e politikave të rrezikut në përputhje me strategjinë e grupit dhe Bankës dhe me kërkesat e rregulloreve lokale. Komiteti i Auditimit të Bankës është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me politikatat e administrimit të rrezikut të Bankës dhe për të vlerësuar mjaftueshmërinë e strukturës së administrimit të rrezikut në lidhje me rreziqet e hasura nga Banka. Komiteti i kontrollit ndihmohet në kryerjen e detyrave nga ana e Divizionit të Auditimit të Brendshëm. Auditimi i brendshëm ndërmerr rishikime të rregullta të kontrolleve dhe procedurave të menaxhimit të rrezikut dhe raporton rezultatet në Komitetin e Auditimit.

Banka, në mënyrë që të menaxhojë në mënyrë efektive rrezikun e kredisë ka zhvilluar metodologji specifike dhe sisteme për të identifikuar dhe vlerësuar rrezikun e kredisë. Këto sisteme dhe metodologji zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme në përputhje me zhvillimet makroekonomike, ligjore dhe rregullatore si edhe bazuar në zhvillimet strukturore dhe sektoriale të ekonomisë.

Mjete kryesore për identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut të kredisë nga huadhënia me shumicë dhe pakicë janë klasifikimi i rrezikut të kredisë, modelet e vlerësimit me pikë dhe sistemet e vlerësimit me shkallë. Sistemet e vlerësimit me shkallë, me pikë dhe të klasifikimit janë subjekt i kontrolleve të vazhdueshme të cilësisë për të siguruar në çdo kohë efektivitetin e tyre. Gjatë vitit 2016, Banka ka vlerësuar në mënyrë sasiore dhe cilësore këto modele dhe i ka përmirësuar ato në përputhje me ndryshimet në mjedisin ekonomik dhe financiar. Gjithashtu, Banka ka validuar në mënyrë sasiore dhe cilësore këto modele dhe i ka përditësuar sipas ndryshimeve në ambientin ekonomik dhe financiar.

Rreziku Mjedisor dhe Social

Në kuadrin e Menaxhimit të Rrezikut të Kredisë dhe Politikave të Kredisë është integruar vlerësimi i përputhshmërisë me parimet e një financimi me përgjegjësi mjedisore dhe sociale ndaj personave juridikë. Qëllimi kryesor është menaxhimi i rrezikut potencial që del nga operacionet e kredimarrësit që mund të lidhen me një dëmtim të mjedisit ose të shoqërisë, apo me ndonjë kërcënim të drejtpërdrejtë të një dëmtimi të tillë, duke pasur si rezultat një ndikim negativ në operacionet e biznesit dhe rezultatet financiare të Bankës.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Në aspektin e menaxhimit të rrezikut të kredisë, Divizioni i Menaxhimit të Rrezikut është përgjegjës për:

- monitorimin e rrezikut të kreditit për të siguruar përputhshmërinë me strategjinë e rrezikut të kredisë dhe politikën, si dhe efektivitetin e masave kundër dhe veprimet e menaxhimit;
- identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të kredisë ekzistues dhe të mundshëm të natyrshëm në produkte/aktivitete;
- vlerësimin e niveleve të zhvlerësimit dhe dispozitat rregullatore për portofolin e kredive;
- raportimin tek Komiteti i Rrezikut për problemet e identifikuara apo të ardhshme që lidhen me ndryshimet në profilin e tanishëm apo të prishëm të rrezikut.

Gjithashtu Banka kryen dy herë në vit prova të stresit në mënyrë që të vlerësojë dobësinë e saj ndaj ngjarjeve të mundshme të ardhshme siç janë ndryshimet në mjedisin ekonomik apo financiar të cilat mund të kenë ndikime të pafavorshme në ekspozimet e kredisë dhe aftësinë e Bankës për t'i përballuar këto ndryshime. Rezultatet e këtyre provave mund të përdoren për të optimizuar më tej monitorimin e portofolit të rrezikuar. Banka vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka evidencë të zhvlerësimit në përputhje me parimet e përgjithshme dhe metodologjinë e përcaktuar në SNK 39 dhe udhëzimin përkatës të implementimit si edhe Parimet e Politikës së Provigjionimit të Grupit.

Ekspozimi maksimal bruto

	Shënime	Kategoria	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Tepricat e llogarive me Bankën Qëndrore	12	Standarde	15,985,190	10,980,128
Kredi për institucione financiare	13	Standarde	10,741,771	8,802,474
Kredi dhe paradhënie klientëve	16	Shih më poshtë	33,309,770	34,922,403
Aktive financiare VPS	15	Standarde	15,175,768	17,322,957
Aktive financiare MDM	14	Standarde	204,764	863,340
			75,417,263	72,891,302
Angazhime për kredi të patërhequra	27	Standarde	1,858,018	1,878,291
Letërkredi	27	Standarde	-	266,385
Garanci dhënë në favor të klientëve	27	Standarde	716,895	368,437
			2,574,913	2,513,113
Ekspozimi total, para zhvlerësimit			77,992,176	75,404,415

Kategoria standarde përfaqëson aktive që nuk janë me vonesë e as nuk janë zhvlerësuar.

Tabela më poshtë tregon ekspozimin neto të huave dhe paradhëniesve dhënë klientëve deri me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 të ndara sipas portofolit të zhvlerësimit individual dhe atij kolektiv:

Shuma bruto	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
As e vonuar e as e zhvlerësuar	20,833,792	19,457,290
Me vonesë por jo e zhvlerësuar	7,497,673	9,219,414
E zhvlerësuar kolektivisht	2,954,187	2,139,637
E zhvlerësuar individualisht	2,075,060	4,163,537
Tarifat e huave të shtyra	(50,943)	(57,475)
	33,309,769	34,922,403
Të provigjionuara individualisht	(582,286)	(1,435,311)
Të provigjionuara në mënyrë kolektive	(824,540)	(923,381)
	(1,406,826)	(2,358,692)
Vlera kontabël neto	31,902,943	32,563,711

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Me vonesë por jo të zhvlerësuara individualisht

Më 31 dhjetor 2017

Periudha kohore	Individë	Korporata	Hua gjithësej
Me vonesë deri në 30 ditë	2,554,272	4,061,806	6,616,078
Me vonesë nga 31-60 ditë	553,732	658,624	1,212,356
Me vonesë nga 61-90 ditë	515,131	406,746	921,877
Me vonesë nga 91-180 ditë	101,982	176,307	278,289
Me vonesë më shumë se 180 ditë	1,003,004	380,570	1,383,574
Gjithësej	4,728,122	5,684,053	10,412,175
Vlera e drejtë e kolateralit	11,802,352	23,644,450	35,446,802

Më 31 dhjetor 2016

Periudha kohore	Individë	Korporata	Hua gjithësej
Me vonesë deri në 30 ditë	4,530,393	2,137,313	6,667,706
Me vonesë nga 31-60 ditë	1,054,906	459,494	1,514,400
Me vonesë nga 61-90 ditë	263,799	622,615	886,414
Me vonesë nga 91-180 ditë	264,157	135,266	399,423
Me vonesë më shumë se 180 ditë	644,257	1,184,430	1,828,687
Gjithësej	6,757,512	4,539,117	11,296,629
Vlera e drejtë e kolateralit	12,085,734	52,911,029	64,996,763

Me vonesë por jo të zhvlerësuara

Shuma bruto:	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Ditët me vonesë		
Nga 1 deri në 30	5,131,979	6,448,502
Nga 31 deri në 60	1,063,652	1,455,833
Nga 61 deri në 90	769,337	642,561
Më shumë se 90	532,705	672,518

Kredi me vonesë

Një aktiv financiar është me vonesë nëse borxhi i palës tjetër është me vonesë më shumë se një (1) ditë.

Kredi jo performuese

Një kredi konsiderohet jo-performuese nëse plotësohet një prej kushteve të mëposhtme:

- Ekspozimi është i vonuar prej më shumë se 90 ditë;
- Një ekspozim ndaj të cilit janë ndërmarrë nga Banka veprime ligjore;
- Kredimarrësi është vlerësuar si i pamundur për të paguar detyrimet e tij të kreditit në mënyrë të plotë, pa ekzekutimin e kolateralit;
- Ekspozimi është klasifikuar si i zhvlerësuar.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Kredi performuese

Një kredi konsiderohet si performuese nëse plotësohet një prej kushteve të mëposhtme:

- Ekspozimi është i vonuar prej më pak se 90 ditë;
- Një ekspozim ndaj të cilit nuk janë ndërmarrë nga Banka veprime ligjore;
- Situata e debitorit është përmirësuar aq sa shlyerja e plotë e ekspozimit, në përputhje me kushtet fillestare ose të modifikuara kur është e zbatueshme, ka mundësi të realizohet.
- Ekspozimi nuk është i klasifikuar si i zhvlerësuar.

Kredi në pamundësi për t'u paguar

Për portofolin bankar me shumicë: Klientët të vlerësuar si në pamundësi për të paguar janë klientët që i janë njoftuar Divizionit të kredive jo performuese me shumicë pa kaluar në ekspozime me vonesë.

Për portofolin bankar me pakicë, ekspozimet e mëposhtme konsiderohen si në pamundësi për t'u paguar:

- Rastet e mashtrimeve;
- Klientë të vdekur;
- Klientë të papunë në mungesë të ndonjë burimi të të ardhurave;
- Klientët me probleme shëndetësore të rënda;
- Biznese shumë të vogla, të cilat kanë ndaluar operacionet e tyre (jo aktive);
- Personi juridik ka shpallur falimentin.

Kredi të zhvlerësuar

Kreditë e zhvlerësuar janë ato kredi dhe parapagime ndaj klientëve për të cilat Banka beson se ekziston mundësia për të mos qenë në gjendje të mbledhë principalin dhe interesin e pagueshëm sipas kushteve të kontratës së kredisë. Banka zbaton metodologjinë e zhvlerësimit sipas strukturës së Grupit Alpha Bank për SNRF. Banka proçedon me përcaktimin e zhvlerësimit atëherë kur ndodhin ngjarje specifike me natyrë sasiore ose cilësore.

Rastet e kredive më poshtë përcaktohen si të zhvlerësuar:

- a. Kredi për të cilat shuma e zhvlerësimit llogaritet mbi bazë vlerësimi individual
- b. Ekspozimet në vonesë më shumë se 90 ditë, ose në bazë të statusit ligjor ushtrimor, për të cilat një shumë e zhvlerësuar është alokuar sipas vlerësimit kolektiv për zhvlerësim;
- c. Ekspozimet e vlerësuar si jo të mundshme për tu paguar.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Një analizë e detajuar e të ardhurave nga interesi nga kredi të klientëve të zhvlerësuar dhe jo të zhvlerësuar për vitet 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

31 dhjetor 2017	Të ardhura nga interesi për huatë jo të zhvlerësuara	Të ardhura nga interesi për huatë e zhvlerësuara	Totali i të ardhurave nga interesi
Huadhënie për individë	727,222	54,831	782,053
Huadhënie ndaj korporatave	609,195	118,123	727,318
Huadhënie në sektorin publik	10,949	-	10,949
Totali i të ardhurave nga interesi	1,347,366	172,954	1,520,320

31 dhjetor 2016	Të ardhura nga interesi për huatë jo të zhvlerësuara	Të ardhura nga interesi për huatë e zhvlerësuara	Totali i të ardhurave nga interesi
Huadhënie për individë	720,871	84,699	805,570
Huadhënie ndaj korporatave	706,130	274,797	980,927
Huadhënie në sektorin publik	10,159	-	10,159
Totali i të ardhurave nga interesi	1,437,160	359,496	1,796,656

31 dhjetor 2017	Portofol i mbi-kolateralizuar		Portofol i nën-kolateralizuar	
	Vlera e mbartur e portofolit	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera e mbartur e portofolit	Vlera e drejtë e kolateralit
Individë	10,021,583	34,747,155	2,200,204	465,596
Biznese	14,659,845	90,444,249	5,021,311	462,910
Total	24,681,428	125,191,404	7,221,515	928,505

31 dhjetor 2016	Portofol i mbi-kolateralizuar		Portofol i nën-kolateralizuar	
	Vlera e mbartur e portofolit	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera e mbartur e portofolit	Vlera e drejtë e kolateralit
Individë	9,423,953	35,579,137	2,515,339	488,283
Biznese	15,106,012	126,514,214	5,518,407	699,826
Total	24,529,965	162,093,352	8,033,746	1,188,109

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Fondi për zhvlerësim

Banka vendos një fond për humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuara ose të klasifikuara si të mbajtura deri në maturim që përfaqësojnë parashikimin e saj për humbjet e ndodhura në kreditë dhe portofolin e mbajtur deri në maturim. Elementët kryesorë të këtij fondi janë humbjet specifike që lidhen me ekspozimet individualisht të rëndësishme dhe humbjet kolektive që lidhen me kreditë e biznesit të sektorit të tregtisë me pakicë dhe kreditë hipotekore dhe konsumatore.

Kreditë e ristrukturuara

Këto janë rastet e rinegociimit të termave fillestarë të një marrëveshje kredie për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij kontraktuale. Totali i kredive të ristrukturuara më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Kredi të ristrukturuara		
As me vonesë, as të zhvlerësuara	1,673,469	1,794,144
Me vonesë por jo të zhvlerësuara	1,472,315	1,929,039
Të zhvlerësuara	3,052,737	1,605,352
Vlera bruto	6,198,521	5,328,535
Kredi të zhvlerësuara individualisht	(340,435)	(88,458)
Kredi të zhvlerësuara kolektivisht	(166,168)	(167,958)
Vlera kontabël	5,691,920	5,072,119

Portofoli bankar i korporatave

Procesi për përcaktimin e kredive të klasifikuara për zhvlerësim dhe vlerësimin e provigjionit të tyre përbëhet nga hapat e mëposhtëm:

1. Identifikimi i kredive të cilat do të vlerësohen në mënyrë individuale.
2. Llogaritja e zhvlerësimit në baza individuale për kredi të identifikuar në hapin e mëparshëm.
3. Njohja e kredive që do të vlerësohen në mënyrë kolektive, duke përfshirë edhe rastet kur fondi i zhvlerësimit sipas vlerësimit individual ishte zero.
4. Llogaritja e provigjionit kolektiv për kreditë e identifikuar në hapin e mëparshëm (3).

Për qëllime të provigjionit, në bazë të vlerësimit kolektiv, kreditë janë të ndara në bazë të karakteristikave të ngjashme të rrezikut të kredisë. Këto karakteristika janë zgjedhur në bazë të flukseve monetare të ardhshme të kategorive përkatëse të kredive të cilat përshkruajnë aftësinë e konsumatorëve për të shlyer borxhet e tyre në bazë të marrëveshjeve kontraktuale. Niveli i humbjes është llogaritur në bazë të karakteristikave të rrezikut të kredisë, të segmentit dhe portofolit në të cilën huaja ose konsumatori është kategorizuar. Niveli i humbjes përcaktohet me metoda statistikore. Vlerësimi individual për zhvlerësim kryhet nga njësitë e biznesit respektive, rishikohet nga Divizioni i Kredisë dhe drejtuesit e Departamenteve dhe bashkë me zhvlerësimin individual, aprovet nga Komiteti Ekzekutiv.

Ngjarjet treguese për ekspozimet e vlerësuara individualisht

- Konsumatorët me vlerësim të brendshëm të rrezikut të kredisë D, D0, D1 ose D2 ose E ose në vonesë më shumë se 90 ditë;
- Konsumatorët me vlerësim CC- ose C;
- Kredimarrës që veprojnë në industri me përkeqësim të rëndësishëm të performancës së tyre (duke marrë parasysh pesë sektorët me rrezikun më të lartë sipas klasifikimit të Analistit të Rrezikut);
- Debitori shfaq vështirësi të konsiderueshme në plotësimin e kushteve të kredisë në treg;
- Treguesit e përkeqësimit duke përfshirë por jo të kufizuar vetëm në: urdhërpagesat, çeqe të kthyer nga banka, ankande, falimentime, pagesat e vonuara ndaj shtetit, ndaj fondeve të sigurimeve shoqërore ose ndaj të punësuarëve, etj;
- Kredimarrësit më shumë të zhvlerësuar në testet e mëparshme të zhvlerësimit për të cilët nuk është përmbushur asnjë nga kriteret e mësipërme;

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Ngjarjet treguese për ekspozimet e vlerësuara individualisht (vazhdim)

- Ndodhja e ngjarjeve të papitura ekstreme të tilla si mashtrimi, fatkeqësitë natyrore;
- Shkelja e kontratës ose termave dhe kushteve të kredisë;
- Ndryshimet negative në strukturën e aksionarëve apo drejtimit të kompanisë apo çështje me probleme serioze të drejtimit;
- Ndryshime të rëndësishme negative në flukset e mjeteve monetare potencialisht për shkak të përfundimit të bashkëpunimit me një konsumator kyç/ të madh, reduktimit të ndjeshëm në kërkesën e një produkti apo shërbimi kryesor, përfundimit të bashkëpunimit me një ose disa furnizues kyç/ të mëdhenj.
- Përkeqësim të ndjeshëm në treguesit kryesore financiare të debitorit (dmth një rënie në fondet e veta për shkak të humbjeve të konsiderueshme operative, një përkeqësim në raportin e mbulimit të borxhit, etj), si dhe një përkeqësim në vlerën e flukseve monetare të pritshme të ardhshme.

Vlerësimi kolektiv

Klientët të cilët kanë qenë të vlerësuar në mënyrë individuale, por nuk janë të zhvlerësuar (me një fond zhvlerësimi zero) dhe gjithashtu pjesa tjetër e portofolit bankar me shumicë që kishte rezultuar në fillim pa ndonjë ngjarje specifike, janë vlerësuar rrjedhimisht për zhvlerësim në bazë kolektive, pasi janë grupuar në bazë të karakteristikave të përbashkëta të rrezikut të kredisë.

Portofoli bankar me pakicë (per individë)

Për portofolin bankar me pakicë, kreditë vlerësohen në baza kolektive pasi janë klasifikuar në disa grupe në bazë të karakteristikave të përbashkëta, të tilla si:

- Ditevonesat e kredisë
- Tipi i produktit
- Monedha
- Statusi i ristrukturimit dhe ligjor.

Ngjarjet treguese për ekspozimet e vlerësuara kolektivisht

Ngjarjet e veçanta për vlerësimin kolektiv për portofolin bankar me pakicë janë si më poshtë:

- Llogaritë në vonesë më shumë se 30 ditë
- Kreditë e ristrukturuara
- Çështjet ligjore
- Kreditë pjesërisht të çregjistruara.

Kreditë e fshira

Kreditë e fshira përcaktohen si zvogëlimi kontabël i një borxhi, që nuk do të thotë heqje dorë nga e drejta ligjore përkundrejt debitorit, ndaj borxhi mund të rikuperohet. Propozimet për çregjistrim (pjesor apo tërësor) mund të parashtrihen në komitetin përkatës me kusht që te jenë ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

- Marrëveshjet përkatëse me klientët janë përfunduar
- Urdhërpagesat janë lëshuar përkundrejt palëve në detyrim
- Proçedura për regjistrimin e barrave të detyrueshme ka filluar
- Të paktën një prej pasurive të patundshme është dërguar në ankand, që pretendimet e privileguara (përmes listës finale të kreditorëve prioritarë) dhe humbjet e mundshme të Bankës të finalizohen.
- Është llogaritur provigjion i njëjtë për zhvlerësim të paktën në tremujorin që i paraprin tremujorit të propozimit për çregjistrim.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Kreditë e fshira (vazhdim)

<i>Kredi të fshira</i>	Hipotekore	Konsumatore	Karta		Totali
			kredie	Korporata	
Më 1 janar 2016	305,850	34,376	50,592	1,842,540	2,233,358
Kredi të fshira	9,000	65,924	31,518	1,083,303	1,189,745
Rikuperimet	(5,675)	(5,234)	(3,461)	(1,223)	(15,593)
Më 31 dhjetor 2016	309,175	95,066	78,649	2,924,620	3,407,510
Kredi të fshira	32,531	59,167	20,473	1,705,356	1,817,527
Rikuperimet	(4,343)	(2,750)	(9,932)	(18,735)	(35,760)
Më 31 dhjetor 2017	337,363	151,483	89,190	4,611,241	5,189,277

Banka monitoron vazhdimisht portofolin e kredive të çregjistruara. Banka ka rikuperuar 35,760 mijë Lek (2016: 15,593 mijë Lek) gjatë vitit 2017.

Kreditë e fshira përkufizohen si një zvogëlim i borxhit, si rezultat i një vendimi ose marrëveshje ligjërish të detyruesë (vendim gjyqi, marrëveshje kontraktuale etj.), e cila nuk është më e kërkueshme dhe rrjedhimisht, konsiderohet në mënyrë përfundimtare si e parikuperueshme, çka do të thotë se Banka në mënyrë përfundimtare dhe të pakthyeshme heq dorë nga e drejta për të kërkuar borxhin e fshirë, përveçse nëse (në rast të rënies dakord) konstatohet se termat e vendosur prej vendimit apo marrëveshjes së sipërpërmendur janë shkelur. Nga shuma totale e kredive të çregjistruara gjatë vitit 2017 prej 1,817,527 mijë Lek, shuma prej 52,709 mijë Lek përfaqëson kredi të fshira pjesërisht.

Kolaterali

Banka mban kolaterale kundrejt huave dhe paradhëniesve dhënë klientëve në formën e hipotekave mbi pasuritë e paluajtshme, të drejta të tjera të regjistruara mbi aktive, si dhe garanci. Përlllogaritja e vlerës së drejtë bazohet në vlerën e kolateralit në momentin e huadhënies, dhe përditësohet në mënyrë të vazhdueshme sipas llojit të kolateralit. Përgjithësisht nuk mbahen kolaterale për hua dhënë Bankave, me përjashtim të rastit kur letrat me vlerë janë të mbajtura si pjesë e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes dhe të aktivitetit të huamarrjes së letrave me vlerë. Përgjithësisht nuk mbahen kolaterale kundrejt letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim. Një vlerësim i vlerës së drejtë të kolateraleve dhe titujve të tjerë garantues të mbajtur përkundrejt kredive dhe paradhëniesve ndaj klientëve paraqitet më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Huadhënie ndaj korporatave	15,240,999	16,840,165
Prona	13,036,848	16,799,272
Kolateral financiar	57,121	40,893
Kolateral tjetër	2,147,030	-
Huadhënie me pakicë	10,494,622	10,427,571
Prona	10,238,555	10,223,572
Kolateral financiar	181,801	203,999
Kolateral tjetër	74,236	-
Gjithësej	25,735,621	27,267,736

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Përqendrimi sipas vendndodhjes

Përqendrimi sipas vendndodhjes për huatë dhe paradhëniet matet bazuar në vendndodhjen e subjektit që mban aktivin, i cili ka një korrelacion të lartë me vendndodhjen e huamarrësit. Përqendrimi sipas vendndodhjes për letrat me vlerë të tregtueshme dhe të investimit matet bazuar në vendndodhjen e lëshuesit të letrës me vlerë.

	31 dhjetor 2017			31 dhjetor 2016		
	Shqipëri	Shtete të tjera	Totali	Shqipëri	Shtete të tjera	Totali
Mjete monetare dhe tepricat me Bankën e Qëndrore	17,265,466	-	17,265,466	10,980,128	-	10,980,128
Hua dhe Paradhënie për institucionet financiare	-	10,741,771	10,741,771	2,062,942	6,739,532	8,802,474
Hua dhe Paradhënie për Klientët	28,678,720	3,224,223	31,902,943	30,183,169	2,380,542	32,563,711
Instrumente financiare të vlefshme për shitje	13,435,183	1,740,585	15,175,768	10,873,142	6,449,815	17,322,957
Instrumente financiare të mbajtura deri në maturim	204,764	-	204,764	863,340	-	863,340
	59,584,133	15,706,579	75,290,712	54,962,721	15,569,889	70,532,610

Kategoria 'Shtete të tjera' përfaqëson palë të vendosura në shtete Europiane. Shiko shënimin 15 për më tepër detaje rreth VPS me shtete të tjera.

Aktivitet financiare të vlefshme për shitje dhe ato të mbajtura deri në maturim në Shqipëri, përfaqësojnë bono dhe obligacione thesari të lëshuara nga Qeveria Shqiptare.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Analiza e vlerësimit kreditor

Analiza e vlerësimit për tepricat me Bankën e Shqipërisë, Kreditë dhe paradhëniet për Bankat, dhe Letrat me Vlerë për 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 është paraqitur më poshtë:

Klasifikimi	31 dhjetor 2017					31 dhjetor 2016				
	Banka Qëndrore	Detyrime nga Bankat	Të vlefshme për shitje	Mbajtur de në maturim	Totali	Banka Qëndrore	Detyrime nga Bankat	Të vlefshme per shitje	Mbajtur deri në maturim	Totali
AAA	-	-	528,622	-	528,622	-	-	542,881	-	542,881
AA+	-	-	1,211,961	-	1,211,961	-	-	1,237,992	-	1,237,992
AA	-	-	-	-	-	-	-	1,236,754	-	1,236,754
A+	-	-	-	-	-	-	-	1,250,102	-	1,250,102
A-	-	3,225,010	-	-	3,225,010	-	-	134,953	-	134,953
BBB+	-	49,116	-	-	49,116	-	566,220	219,156	-	785,376
BBB	-	3,879,022	-	-	3,879,022	-	2,955,984	-	-	2,955,984
B+	15,985,190	-	13,435,185	204,764	29,625,138	10,980,128	-	10,911,488	863,340	22,754,956
B	-	-	-	-	-	-	-	667,906	-	667,906
CCC	-	3,588,623	-	-	3,588,623	-	3,217,329	-	-	3,217,329
Jo e klasifikuar	-	-	-	-	-	-	2,062,941	1,121,725	-	3,184,666
	15,985,190	10,741,771	15,175,768	204,764	42,107,492	10,980,128	8,802,474	17,322,957	863,340	37,968,899

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Përqëndrimi sipas industrisë

Hua dhe Paradhënie për Klientët	31 dhjetor 2017	% ndaj totalit	31 dhjetor 2016	% ndaj totalit
Kredi hipotekare	9,020,164	28%	947,522	3%
Prodhim	5,729,509	18%	6,160,593	19%
Tregtia me shumicë dhe pakicë	5,353,210	17%	596,014	2%
Karta konsumatore dhe kreditore	3,697,094	12%	3,021,978	12%
Shërbime	2,696,013	8%	5,845,402	19%
Sektori publik	2,129,105	7%	702,589	3%
Kredi biznesi për individët	1,557,289	5%	-	0%
Ndërtim	983,689	3%	354,373	1%
Sektore të tjera	759,871	2%	1,948,478	1%
Transport	587,618	2%	2,693,337	13%
Pasuri të patundshme	553,173	2%	9,285,861	28%
Hotel/Turizëm	293,977	1%	3,327,554	8%
Tarifat e shtyra të huasë	(50,943)	0%	96,177	0%
Transport mallrash	-	0%	(57,475)	(0%)
Fondi për humbje nga zhvlerësimi	(1,406,826)	-4%	(2,358,692)	(9%)
	31,902,943	100%	32,563,711	100%

(c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku me të cilin përballen të ardhurat ose kapitali, që rrjedh prej aftësisë së Bankës për të përmbushur detyrimet e saj brenda afatit të shlyerjes, ose financimi i një biznesi të ri, pa pësuar humbje në nivele të papranueshme si dhe pa aftësi për të menaxhuar tkurrje të paplanifikuara ose ndryshime në burimet e financimit. Rreziku i likuiditetit rrjedh gjithashtu nga dështimi i Bankës për të njohur ose adresuar ndryshimet në kushtet e tregut që ndikojnë aftësinë për të likuiduar aktivet në një periudhë afatshkurtër dhe me humbje minimale në vlerë.

Këshilli Drejtues me ndihmën e Komitetit të Rrezikut ia ka caktuar menaxhimin e likuiditetit dhe menaxhimin e rrezikut të likuiditetit Komitetit të Aktiveve dhe Detyrimeve (ALCo).

ALCo miraton politikën e rrezikut të likuiditetit, teknikat e matjes, kufijtë dhe treguesit e brendshëm të rekomanduar dhe i shqyrton ato në baza vjetore - ose më shpesh kur kërkohet - për të siguruar që ata të mbeten në përputhje me rrezikun e pranueshëm, aktivitetet dhe objektivat e biznesit të Bankës.

Matjet e rrezikut të likuiditetit

Matësi kryesor i rrezikut të likuiditetit është hendeku i likuiditetit, i cili paraqet skedulën e maturimit për aktivet, detyrimet dhe zërat jashtë bilancit nga grupi kohor sipas afatit të tyre.

Likuiditeti dhe hendeku i rrezikut të normës së interesit përkatëse për 2017 dhe 2016 marrin në konsideratë kushtet ekonomike të vendit, karakteristikat e çdo produkti dhe sjelljen e klientëve dhe gjithashtu strukturën aktuale të konkurrentëve, në kontekstin e një menaxhimi më efikas dhe efektiv të likuiditetit dhe rrezikut të normës së interesit në librat bankare.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

c. Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Matjet e rrezikut të likuiditetit (vazhdim)

Divizioni i Menaxhimit të Rrezikut aplikon skenarët e provës së qëndrueshmërisë për rrezikun e likuiditetit. Skenarët e provës së qëndrueshmërisë bazohen në skenarë që, nëse materializohen, mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në pozicionin e likuiditetit të bankës. Parimi i përdorur është që të përcaktohen nevojat për financim që lindin nga këto situata dhe të sigurohet që janë përcaktuar veprimet e duhura për t'u ndërmarrë. Provat e qëndrueshmërisë bëhen në mënyrë periodike për të mbuluar kërkesat nga rregullatorët dhe nevojat e brendshme.

Prova e qëndrueshmërisë për Likuiditetin

Tre tipe skenarësh merren në konsideratë:

- Skenari i stresit sistemik (ose i tregut),
- Skenari i stresit idiosinkretik/ idiosyncratic (në lidhje me institucionin),
- Skenari i stresit global.

ALCo është përgjegjës për aprovimin dhe rishikimin e skenarëve të provave të qëndrueshmërisë dhe treguesve të brendshëm të rrezikut të likuiditetit, në baza vjetore.

Menaxhimi i krizave të likuiditetit

Në rastet e identifikimit të ndonjë krizë të mundshme, nëpërmjet kontrolleve të përditshme, mbi likuiditetin apo në parashikimin e rrjedhjes së ardhshme të parave, anëtarët e ALCo-s lajmërohen në lidhje me rrethanat. Anëtarët e ALCo-s duhet të njoftohen menjëherë për ndonjë shenjë krize të hershme të likuiditetit, duke u shoqëruar me informacion nga njësitë përkatëse për ndonjë zhvillim specifik në zonën e tyre, i cili mund të ndikojë në pozicionin e likuiditetit të bankës. ALCo vlerëson kushtet e jashtme dhe gjendjen e përgjithshme të likuiditetit të Bankës.

Situata monitorohet nga afër për sa kohë që gjykohet se një krizë është e mundshme. Takime të shpeshta të menaxhimit mund të bëhen në lidhje me krizën, në mënyrë që të monitorohen kushtet e tregut dhe të përcaktohen hapat e duhur që do ndërmerren në rastin e një krize likuiditeti. Në rastin e një krize likuiditeti duhet të zbatohet "Plani i Financimit të Emergjencave".

Përveç "Planit të Financimit të Emergjencave", Alpha Bank Albania ka krijuar një Plan Rikuperimi që ka si synim të sigurojë mbijetesën e institucionit në periudha që çënojnë qëndrueshmërinë e tij.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Synimi i Bankës në menaxhimin e likuiditetit është që të sigurojë, aq sa është e mundur, që të ketë gjithmonë likuiditet të mjaftueshëm për të paguar detyrimet, si në rrethana normale, ashtu edhe në rrethana të jashtëzakonshme, pa pësuar humbje të papërballueshme dhe pa rrezikuar dem reputacional. Tabela e mëposhtme tregon flukset monetare të skontuara të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës në bazë të maturitetit kontraktual më të hershëm ose flukseve monetare të pritshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016, pasi impakti i skontimit është i papërfillshëm për shkak të maturitetit të shkurtër të këtyre instrumentave.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Tabela e mëposhtme paraqet aktivet dhe detyrimet e Bankës sipas maturitetit kontraktual të mbetur, duke përfshirë zërat jofinanciarë:

31 dhjetor 2017	Deri në 1muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vite	Mbi 5 vite	Totali
Mjete monetare dhe tepricat me Bankën Qëndrore	11,865,601	858,513	3,167,716	1,373,636	-	17,265,466
Kredi dhe paradhënie për institucionet financiare	10,741,771	-	-	-	-	10,741,771
Instrumente financiare të mbajtura për shitje	1,132,737	500,000	2,953,490	7,298,455	3,291,086	15,175,768
Instrumente financiare të mbajtura deri në maturitet	4,764	-	-	200,000	-	204,764
Kredi dhe paradhënie për klientët	1,274,202	1,290,410	5,700,792	14,272,401	9,365,138	31,902,943
Aktive materiale dhe jomateriale	2,700	5,400	24,301	129,607	486,025	648,033
Aktive të tjera dhe tatim i parapaguar	33,215	66,429	298,931	398,574	-	797,149
Limit C i papërdorur	156,077	185,221	833,494	683,226	-	1,858,018
Letër kredi/ Letër garanci	59,900	268,486	293,980	18,994	75,535	716,895
Totali Aktiveve	25,270,967	2,905,973	13,272,704	24,374,893	13,217,784	79,042,321
Detyrime ndaj bankave	2,017,352	344,389	-	-	-	2,361,741
Detyrime ndaj klientëve	14,587,725	8,022,606	28,748,969	10,719,125	-	62,078,425
Borxh i varur	3,160	-	-	2,127,200	-	2,130,360
Detyrime të tjera	588,373	-	-	-	-	588,373
Limit C i papërdorur	156,705	188,123	846,554	686,909	-	1,878,291
Letër kredi/ Letër garanci	330,336	10,000	194,232	-	100,254	634,822
Totali i detyrimeve	17,683,651	8,565,118	29,789,755	13,533,234	100,254	69,672,012
Hendeku marzhinal	7,587,316	(5,659,145)	(16,517,051)	10,841,659	13,117,530	9,370,309
Hendeku kumulativ	7,587,316	1,928,171	(14,588,880)	(3,747,221)	9,370,309	

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Flukset e pritshme të Bankës për disa aktive dhe detyrime financiare variojnë ndjeshëm prej flukseve kontraktuale. Dallimet kryesore lidhen me depozitat pa afat të klientëve të cilat pritet të jenë të qëndrueshme ose të rriten dhe aktiveve financiare të vlefshme për shitje të cilat mund të shiten për t'ju përgjigjur nevojave për likuiditet.

31 dhjetor 2016	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vite	Mbi 5 vite	Totali
Mjete monetare dhe tepricat me Bankën Qëndrore	7,032,532	822,339	3,092,016	1,197,497	-	12,144,384
Kredi dhe paradhënie për institucionet financiare	8,802,474	-	-	-	-	8,802,474
Instrumente financiare të mbajtura për shitje	1,179,523	700,000	4,157,293	7,357,794	3,928,347	17,322,957
Instrumente financiare të mbajtura deri në maturitet	13,340	-	650,000	200,000	-	863,340
Kredi dhe paradhënie për klientët	2,200,102	1,819,585	5,195,772	15,318,196	8,030,056	32,563,711
Aktive materiale dhe jomateriale	2,748	5,496	24,732	131,904	494,639	659,519
Aktive të tjera dhe tatimi i parapaguar	60,314	120,628	542,825	723,767	-	1,447,534
Totali Aktiveve	19,291,033	3,468,048	13,662,638	24,929,158	12,453,042	73,803,919
Detyrime ndaj bankave	1,984,101	-	-	-	-	1,984,101
Detyrime ndaj klientëve	12,805,163	7,816,439	28,656,911	9,559,099	-	58,837,612
Borxh i varur	3,243	-	-	811,380	1,352,300	2,166,923
Detyrime të tjera	508,680	-	-	-	-	508,680
Totali i detyrimeve	15,301,187	7,816,439	28,656,911	10,370,479	1,352,300	63,497,316
Hendeku marzhinal	3,989,846	(4,348,391)	(14,994,273)	14,558,679	11,100,742	10,306,603
Hendeku kumulativ	3,989,846	(358,545)	(15,352,818)	(749,139)	10,306,603	

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku për një rënie në vlerën ekonomike ose në të ardhurat e raportuara për shkak të lëvizjeve të përgjithshme në treg dhe përfshin llojet kryesore: rrezikun e normës së interesit, rrezikun nga kurset e këmbimit, rrezikun e çmimit të kapitalit dhe të çmimeve të të mirave.

Humbjet gjithashtu mund të ndodhin si nga portofoli tregtar, ashtu edhe nga menaxhimi i aktiveve dhe detyrimeve.

Banka identifikon, mat, monitoron dhe kontrollon rrezikun e tregut nëpërmjet strukturës së politikave të menaxhimit të rrezikut, procedurave dhe direktivave të punës në fuqi.

Në përputhje me objektivin e hartimit të politikave, janë vendosur limitet e ekspozimit të rrezikut të menaxhimit financiar dhe kufizimet maksimale të humbjes (humbje të ndaluar). Në veçanti, kufijtë e mëposhtëm janë përcaktuar për rreziqet e mëposhtme:

- Rrezikun e këmbimit valutor
- Rreziku i normës së interesit në pozicionet e obligacioneve
- Rreziku i kredisë në lidhje me transaksionet ndërbankare.

Pozicionet e mbajtura monitorohen në baza ditore dhe shqyrtohen për kufirin përkatës të përqindjes dhe për çdo tejkalimi limiti.

(e) Rreziku i monedhës

Pozicioni i hapur në valutë i Bankës vjen kryesisht nga aktivet dhe detyrimet në regjistrin bankar, por gjithashtu nga klientët që lidhen me transaksione në monedhë të huaj. Ajo është subjekt i menaxhimit aktiv në baza të vazhdueshme dhe nën limitet dhe rregulloret e brendshme të përcaktuara më parë.

Banka identifikon, mat, monitoron dhe kontrollon rrezikun e monedhës nëpërmjet politikave të përcaktuara të menaxhimit të rrezikut, procedurave dhe drejtimit të punëve. Politika e Menaxhimit të rrezikut të tregut na jep një kornizë të parimeve për një menaxhim efektiv të rrezikut të tregut, duke përfshirë dhe rrezikun e monedhës.

Duke qenë se monedha me të cilën paraqiten pasqyrat financiare të bankës është Lek, pasqyrat financiare të bankës ndikohen nga lëvizjet në kursin e këmbimit midis lekut dhe monedhave të tjera.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(e) Rreziku i monedhës (vazhdim)

Analiza e pozicionit monetar më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016, sipas monedhave, shprehet si më poshtë:

31 dhjetor 2017	LEK	EUR	USD	Të tjera	Totali
<i>Të gjitha vlerat janë në Lek '000</i>					
Aktivet financiare:					
Mjete monetare dhe tepricat me Bankën Qëndrore	1,944,643	14,990,822	257,743	72,258	17,265,466
Hua dhe paradhënie për institucionet financiare	-	8,779,615	1,444,507	517,649	10,741,771
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	204,764	-	-	-	204,764
Aktive financiare të mbajtura për shitje	12,649,831	2,525,937	-	-	15,175,768
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve	10,686,330	20,007,353	1,209,260	-	31,902,943
Totali	25,485,570	46,303,726	2,911,510	589,907	75,290,712
Detyrimet financiare					
Detyrime ndaj bankave	2,351,344	-	10,397	-	2,361,741
Detyrime ndaj klientëve	24,508,356	35,119,249	1,869,896	580,924	62,078,425
Borxh i varur	-	2,130,360	-	-	2,130,360
Totali	26,859,701	35,121,379	1,880,292	580,922	64,442,295
Hendeku i kursit të këmbimit	(1,374,131)	11,182,347	1,031,218	8,985	10,848,419

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

e. Rreziku i monedhës (vazhdim)

31 dhjetor 2016	LEK	EUR	USD	Të tjera	Total
Të gjitha vlerat janë në Lek '000					
Aktivët financiarë:					
Mjete monetare dhe tepricat me Bankën Qëndrore	2,295,031	9,559,006	237,306	53,041	12,144,384
Hua dhe paradhënie për institucionet financiare	-	7,574,607	849,982	377,885	8,802,474
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	863,340	-	-	-	863,340
Aktive financiare të mbajtura për shitje	10,873,142	6,449,815	-	-	17,322,957
Hua dhe paradhënie për klientët	11,004,888	19,702,401	1,856,422	-	32,563,711
Totali	25,036,401	43,285,829	2,943,710	430,926	71,696,866
Detyrimet financiare					
Detyrime ndaj bankave	1,341,499	588,210	54,392	-	1,984,101
Detyrime ndaj klientëve	24,235,035	32,409,377	1,762,833	430,367	58,837,612
Borxh i varur	-	2,166,923	-	-	2,166,923
Totali	25,576,534	35,164,510	1,817,225	430,367	62,988,636
Hendeku i kursit të këmbimit	(540,133)	8,121,319	1,126,485	559	8,708,230

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(e) Rreziku i monedhës (vazhdim)

Pozicioni neto valutor më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqet ndjeshmërinë sipas analizës së mëposhtme:

Monedha	Skenari i ndryshimit të kursit të këmbimit kundrejt Lek (%)	Skenari i stresit Ndikimi 2017	Skenari i stresit Ndikimi 2016
EUR	Vlerësimi i EUR 5%	559,117	406,066
	Zhvlerësimi i EUR 5%	(559,117)	(406,066)
USD	Vlerësimi i USD 5%	51,561	56,324
	Zhvlerësimi i USD 5%	(51,561)	(56,324)
Të tjera	Vlerësimi 5%	449	28
	Zhvlerësimi 5%	(449)	(28)

Në mënyrë që të masë rrezikun e monedhës, banka aplikon metodën VNR – Vlerat në risk (Values at Risk). Metoda e përdorur për të llogaritur VNR është një simulim që bazohet në vlerat historike. Banka përdor një periudhë mbajtjeje nga një deri në dhjetë ditë, e cila varet nga koha që kërkon për t'u kthyer në pozicion likuid. Metoda VAR plotësohet me provën e qëndrueshmërisë dhe skenarin analitik, në mënyrë që të vlerësojë humbjen që mund të vijë nga lëvizje hipotetike apo nga lëvizje ekstreme e parametrave të tregut (testi i stresit).

(f) Rreziku financiar në regjistrin bankar

Rreziqet financiare të portofolit bankar rrjedhin nga struktura e aktiveve dhe detyrimeve dhe kryesisht nga ato të portofolit të kredive dhe depozitave. Rreziqet financiare të portofolit bankar konsistojnë në rrezikun e normës së interesit dhe rrezikun e likuiditetit. Banka ka rrezik nga norma e interesit nga aktiviteti i saj financiar, kryesisht në formën e ekspozimit ndaj ndryshimeve negative në normat e interesit të tregut. Aktivitetet dhe detyrimet ndahen në grupet kohore sipas datave të tyre të rivlerësimit për instrumente të normës së interesit variabël ose sipas datës së maturimit, për instrumentat me interes fikse.

Rreziku i normës së interesit përcaktohet si rreziku i të ardhurave dhe vlerave ekonomike që vijnë nga lëvizje të kundërta të normave të interesit. Ekzistojnë katër burime të rrezikut të normave të interesit të cilat mund të kenë ndikim në fitimet e Bankës:

Rreziku i riçimitit: lind nga diferencat në kohë të rivlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve, të bilancit kontabël të bankës.

Grafiku i normave të rrezikut: lind kur ndryshime të papritura të grafikut të normave të interesit, kanë efekte negative në të ardhurat e bankës.

Rreziku bazë: lind nga korrelacioni jo – perfekt midis normave të paguara dhe të fituara të interesit për instrumente financiare të ndryshëm, por që kanë karakteristika rivlerësimi të njëjta.

Rreziku i opsioneve: lind nga opsionet e Bankës mbi asetet, detyrimet apo portofolin e investimeve.

Divizioni i Menaxhimit të Rrezikut, pasi merr parasysh edhe opinionin e Divizionit të Financë – Kontabilitetit dhe Departamentit të Thesarit, zhvillon dhe rekomandon politikat e duhura për rrezikun e normës së interesit, teknikat matëse, limitet dhe tregues të brendshëm së bashku me nivelet e tyre të alarmit dhe procedurat paralajmëruese, në përputhje me:

- Tolerancën e Bankës për rrezik dhe objektivat e biznesit
- Kompleksitetin e aktiviteteve të Bankës
- Përbërjen e Pasqyrave Financiare të Bankës.

ALCo rishikon dhe miraton politikat e rrezikut të normave të interesit të rekomanduara, teknikat e matjes, limitet dhe treguesit e brendshëm dhe i rishikon ato në bazë vjetore, ose më shpesh, në mënyrë që të sigurojë përputhshmëri midis kërkesës për rrezik të bankës dhe objektiveve të biznesit. Politikat e rrezikut të normave të interesit ratifikohen në fund nga Këshilli Drejtues i ABA.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(f) Rreziku financiar në regjistrin bankar (vazhdim)

Matja e rrezikut të normës së interesit

Departamenti i Menaxhimit të rrezikut është përgjegjës për matjen e rrezikut të normës së interesit. Matja kryesore është matja e variancës që ekziston për çdo monedhë, e cila përfaqëson skedulën e rivlerësimit të aktiveve, detyrimeve dhe ekspozimet e tjera të bilancit sipas afatit të maturimit (për instrumentat me norma fikse) apo datës tjetër të rivlerësimit (për instrumente me norma të ndryshueshme).

Në mënyrë specifike:

Divizioni i Menaxhimit të Rrezikut ka përgjegjësinë e rregullimit të sistemeve për qëllime të menaxhimit të rrezikut të normës së interesit. Divizioni i Menaxhimit të Rrezikut siguron:

- Vlerësimin e të gjithë faktorëve materialë të rrezikut që lidhen me aktivet dhe detyrimet e Bankës.
- Modelet dhe supozimet e përdorura në matje të jenë të kuptueshme dhe të dokumentuara
- Të gjithë pozicionet materiale dhe flukset e parasë të jenë të mbuluara
- Të ketë informacion rreth normave të interesit apo flukseve monetare që janë në dispozicion
- Të dhënat për pozicionet aktuale të jenë gjithëpërfshirëse, të sakta, në kohë reale dhe çdo rregullim manual të jetë i dokumentuar. Dokumentimi të jetë në dispozicion për shqyrtim.
- Grafiku i llogarive të jetë i detajuar sipas niveleve, në përputhje me natyrën, kompleksitetin dhe ndjeshmërinë e produktit/pozicionit ndaj rrezikut të normës së interesit.

Divizioni i Menaxhimit të rrezikut në bashkëpunim me njësitë e tjera, zhvillon dhe rekomandon skenarët e përshtatshme në lidhje me rrezikun e normave të interesit. Testet e provave të rrezikut të normave të interesit zhvillohen në baza mujore. Skenari i analizës konsiston në matjen e ndikimit në fitim dhe vlerë ekonomike, të balancave aktuale, duke stimuluar ngjarje të ndryshme (për shembull ndryshime të normave të interesit). ALCo është përgjegjës për miratimin dhe rishikimin në baza vjetore, të skenarëve të provave të qëndrueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre.

Monitorimi i rrezikut të normës së interesit

Rreziku i normës së interesit vjen për shkak të korrelacionit jo të përsosur mes maturitetit (për normat fikse të interesit) ose datës së ri-çmimit (për normat variabël të interesit) të aktiveve dhe detyrimeve që mbartin interes, lëvizja e pafavorshme e pjerrësisë dhe formës së kurbës së kthimit (lëvizja jo paralele e kthimit të normës së interesit për aktivet dhe detyrimet që mbartin interes). Aktivitetet menaxhuese të aktiveve dhe detyrimeve janë kryer në kontekstin e analizës së ndjeshmërisë ndaj ndryshimeve në normën e interesit. Banka zakonisht jep kredi me normë interesi variable sipas politikave të Bankës dhe gjithashtu me normë të indeksuar (e cila bazohet në normat referencë si bono thesari, EURIBOR, LIBOR, etj.).

Nga ana e depozitave, Banka ofron kryesisht produkte me normë interesi fikse. Banka është e ekspozuar ndaj një sërë rreziqesh të cilat lidhen me luhatjet në normat e interesit në treg për pozicionin e saj financiar dhe flukset e parave.

Komiteti i aktiveve dhe detyrimeve është organi që monitoron zbatimin e këtyre limiteve dhe ndihmohet nga seksioni i Thesarit për monitorimin e aktivitetit ditor.

Një përmbledhje e hendekut të pozicionit të normave të interesit në portofolet jotregtuese paraqitet më poshtë:

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(f) Rreziku financiar në regjistrin bankar (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit – regjistri bankar

31 dhjetor 2017	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 12 muaj	Mbi 1 vit	Pa interes	Totali
Mjete monetare dhe tepricat me Bankën Qëndrore	11,945,981	856,519	3,149,529	1,313,437	-	17,265,466
Hua dhe paradhënie për institucionet financiare	10,741,771	-	-	-	-	10,741,771
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	4,764	100,000	-	100,000	-	204,764
Aktive financiare të mbajtura per shitje	1,232,737	500,000	4,150,040	9,292,991	-	15,175,768
Hua dhe paradhënie për klientët	9,652,209	5,939,591	8,161,000	8,150,143	-	31,902,943
Aktive të tjera	-	-	-	-	1,445,182	1,445,182
Totali i Aktiveve	33,577,462	7,396,110	15,460,569	18,856,571	1,445,182	76,735,894
Detyrime ndaj bankave	2,361,741	-	-	-	-	2,361,741
Detyrime ndaj klientëve	15,882,792	7,905,188	28,220,588	10,069,857	-	62,078,425
Borxh i varur	3,160	2,127,200	-	-	-	2,130,360
Detyrime të tjera	-	-	-	-	588,373	588,373
Totali i Detyrimeve	18,247,693	10,032,388	28,220,588	10,069,857	588,373	67,158,899
Hendeku marzhinal	15,329,769	(2,636,278)	(12,760,019)	8,786,714	856,809	9,576,995 -
Hendeku kumulativ	15,329,769	12,693,491	(66,528)	8,720,186	9,576,995	

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(f) Rreziku financiar në rregjistrin bankar (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit – regjistri bankar (vazhdim)

31 dhjetor 2016	Deri ne 1 muaj	1 deri ne 3 muaj	3 deri ne 12 muaj	Mbi 1 vit	Pa interes	Totali
Mjete monetare dhe tepricat me Bankën Qëndrore	2,182,897	-	-	-	9,961,487	12,144,384
Kredi dhe paradhënie për institucionet financiare	8,802,474	-	-	-	-	8,802,474
Instrumente financiare të mbajtura deri në maturim	13,340	-	750,000	100,000	-	863,340
Instrumente financiare të mbajtura për shitje	1,637,883	1,903,547	5,416,003	8,365,524	-	17,322,957
Kredi dhe paradhënie për klientët	7,637,591	9,332,342	5,500,086	10,093,692	-	32,563,711
Aktive te tjera	-	-	-	-	2,107,053	2,107,053
Totali i Aktiveve	20,274,185	11,235,889	11,666,089	18,559,216	12,068,540	73,803,919
Detyrime ndaj bankave	1,984,101	-	-	-	-	1,984,101
Detyrime ndaj klientëve	13,521,594	7,857,799	28,239,585	9,218,634	-	58,837,612
Borxh i varur	3,243	2,163,680	-	-	-	2,166,923
Detyrime të tjera	-	-	-	-	508,680	508,680
Totali i Detyrimeve	15,508,938	10,021,479	28,239,585	9,218,634	508,680	63,497,316
Hendeku marzhinal	4,765,247	1,214,410	(16,573,496)	9,340,582	11,559,860	10,306,603
Hendeku kumulativ	4,765,247	5,979,657	(10,593,839)	(1,253,257)	10,306,603	

Administrimi i rrezikut ndaj normës së interesit kundrejt limiteve të hendekut prej normave të interesit plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e aktiveve dhe pasiveve financiare të Bankës në skenare standarde dhe jostandarde për normat e interesit.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(f) Rreziku financiar në regjistrin bankar (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit – regjistri bankar (vazhdim)

Kjo analizë presupozon se të gjithë variablat, sidomos kurset e këmbimit, qëndrojnë të pandryshueshme. Një rritje prej 100 pikësh në normat e interesit në ditën e raportimit do të ulte fitimin ose humbjen me 43,179 mijë Lek më 31 dhjetor 2017 (2016: ulje prej 32,219 mijë Lek). Një ulje prej 100 pikësh në normat e interesit në ditën e raportimit do të ulte fitimin ose humbjen me 10,107 mijë Lek më 31 dhjetor 2017 (2016: 25,450 mijë Lek).

Monedha	Skenarët e ndryshimit të normës të interesit	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
		Ndjeshmëria për fitimin ose humbjen	Ndjeshmëria për fitimin ose humbjen
LEK	+ / (-) 100b.p	(-) 63,668 / (+) 14,453	(-) 35,074 / (+) 625
EUR	+ / (-) 100b.p	(+) 5,983 / (-) 14,482	(-) 9,944 / (-) 12,142
USD	+ / (-) 100b.p	(+) 12,151 / (-) 9,040	(+) 11,176 / (-) 12,593
Të tjera (GBP/CHF)	+ / (-) 100b.p	(+) 2,355 / (-) 1,037	(+) 1,623 / (-) 1,340

Normat mesatare të interesit të ponderuar për kategoritë e ndryshme të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës deri më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 janë si më poshtë:

31 dhjetor	Norma mesatare e ponderuar e interesit (LEK)		Norma mesatare e ponderuar e interesit (USD)		Norma mesatare e ponderuar e interesit (EUR)	
	2017	2016	2017	2016	2017	2016
Aktivitet financiar:						
Mjete monetare dhe tepricat me Bankën Qëndrore	0.69%	0.92%	-	-	(0.34%)	(0.21%)
Kredi dhe paradhënie për institucionet financiare	-	-	0.35%	0.42%	0.61%	0.48%
Investime në letra me vlerë	5.04%	5.86%	-	-	2.13%	3.20%
Kredi konsumatore	5.35%	5.44%	5.2%	5.17%	3.92%	4.07%
Detyrime financiare:						
Detyrime ndaj bankave	1.58%	0.88%	-	-	-	-
Detyrime ndaj klientëve	0.55%	1.10%	0.09%	0.19%	0.07%	0.19%
Detyrime të tjera	-	-	-	-	1.70%	1.82%

Reziku nga kurset e këmbimit

Normat e aplikueshme të këmbimit (Lek kundrejt monedhës së huaj) për monedhen kryesore në 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
USD	111.10	128.17
EUR	132.95	135.23
GBP	149.95	157.56
CHF	113.94	126.05

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(g) Rreziku operacional

Rreziku operacional përcaktohet si rreziku i ndodhjes së një ngjarjeje, me apo pa efekt financiar, që vjen prej proceseve të brendshme të dështuara apo të papërshtatshme, sistemeve të teknologjisë së informacionit, njerëzve (qëllimisht ose jo qëllimisht) dhe prej ngjarjeve të jashtme.

Rreziku operacional përfshin gjithashtu rrezikun ligjor i cili lidhet me veprime ligjore me të meta, pasiguri në lidhje me përcaktimin e ligjit çka mund të çojë në interpretime të papërshtatshme dhe ineffiçenca të mundshme të kuadrit ligjor.

Objektivi i Bankës është të menaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të Bankës me një kosto efektive dhe duke shmangur procedurat e kontrollit të cilat kërkojnë inisiativa dhe krijueshmëri.

Banka ka adaptuar një strukturë organizacionale të përshtatshme, me role dhe përgjegjësi të punonjësve të secilës njësi të përcaktuara qartë, në mënyrë që të menaxhojë rrezikun operacional.

Në mënyrë që të sigurohet zbatimi i saktë i kornizës së Menaxhimit të rrezikut operacional, janë krijuar komitete dhe role specifike:

Komiteti i rrezikut Operacional ka përgjegjësinë për të mbikëqyrur aktivitetet e menaxhimit të rrezikut operacional dhe të sigurohet që rreziqet operationale janë identifikuar dhe menaxhuar në mënyrë të saktë. Përveç Komitetit të Menaxhimit të Rrezikut, Banka ka krijuar komitete të një niveli më të ulët që janë të përfshirë në procesin e rishikimit dhe vendimmarrjes për ngjarje të rëndësishme të rrezikut operacional. Këta komitete veprojnë brenda limiteve specifike dhe për ngjarje rreziku të caktuara.

Divizioni i Menaxhimit të Rrezikut siguron që të zbatohet kuadri i rrezikut operacional dhe që të jetë në përputhje me kuadrin rregullator lokal.

Njësitë organizative në të gjithë bankën, identifikojnë, vlerësojnë, monitorojnë dhe mbledhin rrezikun e tyre operacional në përputhje me kuadrin e menaxhimit të rrezikut. Çdo njësi organizative ka caktuar koordinatoret të rrezikut operacional. Ky rol i është besuar oficerëve të bankës dhe njësitë të biznesit me eksperiencë dhe njohuri në operacionet e njësitë, në mënyrë që të rrisë kujdesin, të mbështesë komunikimin dhe të promovojë veprime korrigjuese brenda njësisë.

Përgjegjësia kryesore për zhvillimin dhe zbatimin e kontrolleve për adresimin e rrezikut operacional i është caktuar Drejtimit të Lartë në çdo njësi biznesi. Kjo përgjegjësi mbështetet nga zhvillimi i standardeve të Bankës për menaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- Kërkesat për ndarje të detyrave në mënyrë të përshtatshme, përfshirë dhe autorizimin e pavarur të transaksioneve
- Kërkesat për rakordimin dhe monitorimin e transaksioneve
- Përshtatja me kërkesat rregullatore dhe ligjore
- Dokumentimi i kontrolleve dhe procedurave
- Kërkesat për vlerësimin periodik të rreziqeve operationale të hasura, dhe mjaftueshmëria e kontrolleve dhe procedurave për përballjen e rreziqeve të identifikuara.
- Kërkesat për raportimin e humbjeve operationale dhe propozimi i veprimit të menjëhershëm
- Zhvillimi i planeve emergjente
- Trajnimi dhe zhvillimi profesional
- Standardet etike dhe të biznesit
- Zbulimi i rrezikut, duke përfshirë dhe sigurinë për efikasitetin.

Menaxhimi i rrezikut operacional bëhet në përputhje me një kornizë specifike të grupit, me politika, procedura dhe udhëzime, të cilat rishikohen dhe përmirësohen vazhdimisht. Ajo fokusohet veçanërisht në fushat e mëposhtme:

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(g) Rreziku operacional (vazhdim)

Metoda “Mbledhja e të dhënave për ngjarjet e rrezikut operacional” përfshin menaxhimin e padive të paraqitura kundër Bankës, me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut operacional. Banka mbledh ngjarje nga rreziku operacional që kategorizohen sipas kategorisë, linjës së biznesit, shkakut të ngjarjes dhe llojit të efektit. Ngjarjet e rrezikut operacional regjistrohen në bazën e të dhënave. Procesi i mbledhjes së ngjarjes trajtohet në nivel qendror nga njësia e Rrezikut operacional dhe Divizioni i Menaxhimit të rrezikut, i cili konsolidon dhe analizon të gjithë informacionin në dispozicion. Përveç kësaj, Banka ka krijuar komitete për rrezikun operacional, të cilëve u është deleguar autoriteti i limituar për të rishikuar dhe menaxhuar ngjarjet e rrezikut operacional.

Kontrolli i Vetë - vlerësimit i Rrezikut Operacional (ORCSA)

Si një mjet për vlerësimin e ekspozimit të rrezikut operacional, Banka përdor proceset e rrezikut operacional dhe kontrollet e procesit të vetë vlerësimit, si edhe tregues kyç të rrezikut.

Banka ka përfunduar një projekt vetëvlerësimi rreziku dhe kontrolli (RCSA) në 2016. Ky ishte viti i tretë radhazi që është kryer RCSA dhe ka përfshirë të gjithë njësitë e biznesit të cilat synojnë që Banka të ketë një reagim proaktiv ndaj menaxhimit të rrezikut.

Transferimi i Procesit të Vlerësimit të Riskut

Në përputhje të plotë me përmbajtjen e politikës në fuqi të Grupit për transferimin, gjatë vitit 2017 është inicuar Procesi i Transferimit të Vlerësimit të Riskut.

Procesi i vlerësimit merret me rreziqet të cilat janë të dyja të lidhura me:

- Aktivitetet e transferuara
- Ofruesit ekzistues / potencialë

Procesi i Vlerësimit të Riskut zhvillohet në baza periodike (të paktën vjetore).

Njësia e Rrezikut ka një rol mbikëqyrës, duke siguruar përfundimin në kohë të procesit nga njëra anë dhe duke siguruar mbështetjen e nevojshme për njësitë e biznesit nga ana tjetër.

Monitorimi dhe Raportimi i Rrezikut Operacional

Divizioni i Menaxhimit të Rrezikut i siguron Komitetit të Rrezikut Operacional dhe grupeve të njësive kompetente një pamje të qartë dhe raportet përkatëse për nivelin e rrezikut operacional ndaj të cilit është ekspozuar Banka. Komiteti i Rrezikut operacional rishikon dhe analizon informacionin lidhur me ngjarjet e rrezikut operacional, rezultatet e ORCSA, KRI, treguesit kyç të performancës së IT, duke siguruar nivelin e duhur të mbështetjes, për planet e veprimit të ndërtuara për të parandaluar përsëritjen e humbjeve nga rreziku operacional apo për të identifikuar rrezikun operacional dhe për të përmirësuar cilësinë e menaxhimit të rrezikut.

Zbutja e Rrezikut Operacional

Mbrojtja kryesore e Bankës nga ekspozimi në rrezikun operacional arrihet nëpërmjet zbatimit të politikave, procedurave si dhe sistemit të kontrollit të brendshëm. Përveç kësaj, planet e veprimit të përcaktuar në procesin ORCSA sigurojnë mbrojtje shtesë ndaj humbjeve të ardhshme nga rreziku operacional. Banka ka blerë polica të veçanta sigurimi të cilat mbulojnë fusha të ndryshme të rrezikut operacional (për shembull dëmtimi i aktiveve fikse) dhe si pjesë e Grupit të Alpha Bank është e mbuluar nga Group Bankers Blanket Bond. Paralelisht me regjistrimin dhe monitorimin e humbjeve nga ngjarjet e rrezikut operacional, Alpha Bank monitoron dhe raporton në baza mujore treguesit kyç të rrezikut operacional që lidhen me ndërveprimin me klientët/palë të treta, proceset, sistemet, sigurinë e informacionit etj.

Së fundmi, Banka fokusohet gjithashtu edhe në përmirësimin e menaxhimit të rrezikut të mashtrimit duke zbatuar Politikën e Rrezikut të Mashtrimit dhe Manualin e procedurave.

Menaxhimi i Rrezikut të Mashtrimit

Gjatë 2017, Banka është fokusuar në menaxhimin e Rrezikut të Mashtrimit duke implementuar Politikën e Menaxhimit të Rrezikut të Mashtrimit. Qëllimi i kësaj politike është të përshkruajë hapat që duhet të ngjiten

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(g) Rreziku operacional (vazhdim)

Menaxhimi i Rrezikut të Mashtrimit (vazhdim)

gjatë procesit të zbulimit të mashtrimit, hetimit të mashtrimit dhe masat ndëshkuese si pjesë e Politikës për Menaxhimin e Rrezikut të Mashtrimit. Ajo përshkruan strukturën e menaxhimit të rrezikut me synim mbrojtjen e Bankës, duke siguruar ekzistencën e strukturave të përshtatshme operationale dhe procedurave për parandalimin, zbulimin, hetimin dhe lajmërimin e rasteve të mashtrimit.

Menaxhimi i Rrezikut të Mashtrimit përfshin faktorë parandalues që ndikojnë në shfaqjen e mashtrimit (mundësi, incentiva, arsyetime të aktiviteteve të paligjshme) dhe faktorë që ndihmojnë në reduktimin ose eliminimin e impaktit si impakti financiar, impakti reputacional dhe ndonjë impakt për vazhdimësinë e biznesit. Menaxhimi i rrezikut të Mashtrimit përfshin:

- Parandalimin
- Zbulimin
- Hetimin dhe Masa ndëshkuese
- Lajmërimin dhe përhapjen e informacionit

(h) Menaxhimi i kapitalit

Kapitali rregullator dhe norma e mjaftueshmërisë së kapitalit

Për qëllime të menaxhimit të kapitalit, Banka është subjekt i rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për mjaftueshmërinë e kapitalit” në përputhje me ligjin “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”. Në implementimin e kërkesave aktuale për kapital, Banka Qendrore kërkon nga Bankat e nivelit të dytë që të mbajnë një raport të përcaktuar të kapitalit gjithsej kundrejt aktiveve gjithsej të ponderuara me rrezikun dhe zërat jashtë bilancit, raport ky që duhet të jetë minimumi 12%. Minimumi i mjaftueshmërisë së modifikuar të kapitalit është 6%. Raporti i kërkuar nga Banka Qendrore për Alpha Bank Albania ishte 14%.

Rregullorja mbi kapitalin rregullator është bazuar në kriteret e Basel II. Banka është në përputhje me raportin minimal të mjaftueshmërisë së kapitalit në 31 dhjetor 2017 dhe 2016.

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Totali i kapitalit bazë	6,773,840	5,901,933
Borxh i varur	1,724,278	2,166,923
Totali i kapitalit baze dhe atij shtesë	8,498,118	8,068,856
Aktive të ponderuara me risk	38,198,543	41,862,138
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	22.25%	19.27%

Raportet e përmendura më sipër janë të bazuara në pasqyrat financiare të përgatitura për qëllime rregullatore të cilat janë të ndryshme nga SNRF. Këto pasqyra nuk janë ende finalizuar, por Banka nuk pret ndryshime të rëndësishme në këto pasqyra financiare, kur të finalizohen.

(i) Implementimi i SNRF 9

Standardi i ri i kontabilitetit SNRF 9 do të zëvendësojë SNK 39 duke filluar nga 1 janar 2018. Kjo do të sjellë ndryshime të rëndësishme në mënyrën në të cilën klasifikohen dhe maten instrumentat financiare. Për aplikimin e standardit të ri, Banka ka krijuar një Program Implementimi i cili është organizuar në dy drejtime kryesore të cilat janë klasifikimi dhe matja dhe zhvlerësimi. Komitetet e Bordit Drejtues (Komiteti I

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(i) Implementimi i SNRF 9 (vazhdim)

Auditit dhe Komiteti i Menaxhimit të riskut kanë ndërmarrë një rol aktiv duke përfshirë përfshirjen në procesin e vendimarrjes mbi supozimet kyç dhe vendimet në lidhje me Programin e Implementimit.

Për përfundimin e programit të implementimit, janë zhvilluar politika të reja për klasifikimin, matjen dhe zhvlerësimin e instrumentave financiare, të cilat janë aprovuar nga Komitetet e Bordi Drejtues. Për të mbështetur këto politika të reja, janë implementuar metoda dhe procedura të reja. Vendimet kryesore të marra janë përshkruar në paragrafët në vijim: **Klasifikimi dhe Matja**

Në përputhje me standardin e ri, kategoritë e klasifikimit SNK 39 të aktiveve financiare (vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, të vlefshme për shitje, të mbajtura deri në maturim dhe kosto të amortizuara) do të zëvendësohen me:

- Aktive Financiare të matura me kosto të amortizuara;
- Instrumente të borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse, me fitime dhe humbje të riciklueshme në fitim ose humbje në çregjistrim;
- Instrumente të kapitalit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse, me fitime dhe humbje jo të riciklueshme në fitim ose humbje në çregjistrim;
- Aktive financiare të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes

Bazuar në klasifikimin e mësipërm, portofoli ekzistues është klasifikuar si më poshtë:

- Kreditë dhe paradhëniet për klientët dhe të arkëtueshme nga bankat e tjera do të përfshihen në modelin e biznesit që lejon klasifikimin e instrumenteve me kosto të amortizuara (mbaj për të mbledhur), për aq kohë sa nga vlerësimi i dispozitave kontraktuale arrihet në përfundimin që flukset monetare plotësojnë kushtet e principalit dhe interesit, siç përcakton standardi i ri (Test VPPI)
- Për obligacionet dhe investimet me të ardhurave fikse në përgjithësi, Banka ka identifikuar modelet e mëposhtme të biznesit:
 - Modeli i biznesit që ka si qëllim të mbledhë flukse monetare kontraktuale dhe të shesë aktive financiare (mbaj për të mbledhur dhe shitur)
 - Portofoli I tregtueshëm

Gjatë tranzicionit drejt standardit të ri, obligacionet janë klasifikuar në modelin e biznesit objektiv i të cilit është të mbledhë flukse monetare kontraktuale dhe të shesë aktive financiare dhe, për pasojë, për aq kohë sa flukset monetare që rrjedhin nga to janë vetëm pagesa principali dhe interesi mbi principalin e mbetur, klasifikohen me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Obligacionet, flukset monetare të të cilëve nuk janë vetëm pagesa principali dhe interesi, janë klasifikuar në portofolin e instrumentave të borxhit të matur nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes. Ndryshimet në vlerën e drejtë, ashtu si çdo humbje ose fitim njihen direkt në kapital, pa kaluar më parë në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

- Banka nuk ka zgjedhur të specifikojë, në rregjistrimin fillestar, instrumentat e borxhit si të matura me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes
- Detyrimet financiare maten me kosto të amortizuara, kështu që nuk ndikohen nga implementimi i SNRF 9 dhe nuk lind nevoja për të matur ndryshimet në vlerën e drejtë që vijnë nga rreziku i kredisë

Banka do të rivlerësojë modelet e biznesit në çdo datë raportimi. Rivlerësimi i modelit të biznesit është ndërtuar në mënyrë të tillë që të verifikojë në qoftë se ka patur ndonjë ndryshim në inpute që përcaktojnë klasifikimin e instrumentave financiare. Në këtë kontekst, shitjet e realizuar, shitjet e realizuara dhe ato të pritshme do të monitorohen dhe dokumentohen. Për vlerësime të mëtejshme, duhet të mblidhet informacion për frekuencën, vlerën dhe arsyen e shitjes. Shitjet e kryera për shkak të përkeqësimit të rrezikut të kredisë nuk ndikojnë në klasifikimin e modelit të biznesit mbaj për të mbledhur. Modelet e biznesit përcaktohen nga Asset Liability Committee (ALCo), i cili vendos për identifikimin e ndonjë modeli të ri biznesi për portofolin e kredive dhe instrumentave financiarë.

Për sa i përket vlerësimit të flukseve monetare kontraktuale nga kreditë e individëve, vlerësimi do të bëhet në nivel produkti, për shkak të standardizimit të këtyre kredive. Nga ana tjetër, për kreditë për korporatat, vlerësimi do të bëhet në nivel individual si pjesë e procesit të aprovimit.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(i) Implementimi i SNRF 9 (vazhdim)

Për sa i përket produkteve të thesarit, vlerësimi i flukseve kontraktuale monetare do të kryhet nga Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, në bashkëpunim me Departamentin e Thesarit. Aprovimi i kredive dhe investimeve në instrumenta borxhi, flukset monetare të cilëve nuk janë vetëm pagesa principali dhe interesi mbi principalin e mbetur, kërkon miratimin e Komitetit të Menaxhimit të Aktiveve dhe Detyrimeve .

Zhvlerësimi

Aplikimi i SNRF 9 modifikon metodën e llogaritjes së humjeve nga zhvlerësimi i instrumentave financiarë. SNRF 9 sjell një model të ri për llogaritjen e humjeve të pritshme të kredisë, që zëvendëson modelin e humjeve të pësuar të SNK 39. Rregullat e reja eliminojnë kriterin e SNK 39 sipas të cilit humbjet nga rreziku i kredisë regjistrohen vetëm pasi ka ndodhur një ngjarje e lidhur me kredinë (credit event).

Sipas SNRF 9, banka duhet të regjistrojë një llogari për humbjet e pritshme të kredisë për kreditë dhe instrumenta të tjerë financiarë që nuk janë klasifikuar duke përdorur vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes, si edhe për ekspozime jashtë bilancit (Letër Kredie, Letër Garancie dhe Angazhime huaje të papërdorura).

Llogaria për humbjet do të bazohet në humbjet e pritshme të kredisë, duke marrë parasysh probabilitetin e mosshlyerjes për 12 muajt e ardhshëm, përveç rasteve kur ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë nga data e regjistrimit fillestar.

Përveç kësaj, nëse një aktiv financiar i përket kategorisë së një instrumenti kredie të zhvlerësuar, i cili mund të jetë blerë ose origjinar, duhet të regjistrohet një llogari për humbjet e barabartë me humbjet e pritshme të kredisë për të gjithë jetëgjatësinë.

i. Kredi dhe paradhënie për klientët

a. Ndryshim në përcaktimin e mosshlyerjes

Përcaktimi i mosshlyerjes sipas SNRF 9 do të bëhet në përputhje me përcaktimin që përdoret për vlerësimin e menaxhimit të brendshëm të rrezikut të kredisë, që do të thotë se të gjithë ekspozimet të klasifikuara si jo-performuese do të konsiderohen të zhvlerësuar dhe do të klasifikohen si instrumenta që përkasin në Fazën 3 ose si të zhvlerësuar nga kredia në datën e regjistrimit fillestar.

Përcaktimi i saktë i kredive jo-performuese përdoret për të zhvilluar modele për vlerësimin e parametrave të rrezikut të kredisë (Probabiliteti i mosshlyerjes, Humbja nga mosshlyerja, Ekspozimi në mosshlyerje)

b. Klasifikimi i kredive sipas Fazave bazuar në rrezikun e kredisë

Metoda e re reflekton ndryshimet në rrezikun e kredisë që nga data e regjistrimit fillestar. Përshtatja e kësaj metode synon që të: a. Njohjen dhe vlerësimin në kohë të humbjeve të kredisë para se të ndodhin b) klasifikimin e ekspozimeve në varësi ekzistencës ose jo të një përkeqësimi në rrezikun e kredisë.

Kredi të zhvlerësuar në regjistrimin fillestar përfshijnë:

- Ekspozime që në datën e regjistrimit plotësojnë kriteret për t'u klasifikuar si kredi jo-performuese
- Ekspozime për të cilat ka pasur një ndryshim në normat e parapagimit, ose vështirësi financiare, të cilat rezultojnë në çregjistrim dhe regjistrim të një aktivi të ri të zhvlerësuar. Në qoftë se ekspozimi para regjistrimit ka qënë i klasifikuar si i zhvlerësuar, edhe kredia e re do të klasifikohet si e zhvlerësuar. Gjithësesi, për ekspozimet ndaj korporatave, në rastin e njohjes së një kredie të re si pasojë e ndryshimit të huamarrësit, pozicioni financiar i të cilit është më i mirë se i atij të mëparshëm, atëherë ekspozimi nuk do të klasifikohet si i zhvlerësuar.

Vlen për tu theksuar se ekspozimi i klasifikuar si i zhvlerësuar mbetet i tillë për të gjithë jetëgjatësinë. Për ekspozimet e mbetura që nuk klasifikohen si të zhvlerësuar, shpërndarja nëpër Faza është si më poshtë:

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(i) Implementimi i SNRF 9 (vazhdim)

Zhvlerësimi (vazhdim)

i. Kredi dhe paradhënie për klientët (vazhdim)

b. Klasifikimi i kredive sipas Fazave bazuar në rrezikun e kredisë

Faza 1: Në regjistrimin fillestar të një kredie, krijohet një llogari për humbjet bazuar në humbjet e pritshme të kredisë për 12 muajt e ardhshëm. Faza 1 përfshin ekspozime të cilat nuk kanë pasur ndonjë përkeqësim në rrezikun e kredisë që nga regjistrimi fillestar. Faza e parë përfshin gjithashtu ekspozime, rreziku i kredisë të së cilave është përmirësuar dhe janë riklasifikuar nga Faza 2 ose 3 në Fazën 1.

Faza 2: Nëse një kredi ka pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga regjistrimi fillestar dhe nuk është klasifikuar si jo-performuese, Banka do të vlerësojë humbjet e pritshme të kredisë gjatë gjithë jetëgjatësisë së ekspozimit. Faza e dytë gjithashtu përfshin kredi, rreziku i kredisë të së cilëve është përmirësuar dhe ekspozimi është riklasifikuar nga Faza 3 në Fazën 2.

Faza 3: Përfshin ekspozime të zhvlerësuar. Në këtë fazë, humbjet e pritshme të kredisë regjistrohen për të gjithë jetëgjatësinë.

c. Rritje e konsiderueshme në rrezikun e kredisë

Në përcaktimin e rritjes së konsiderueshme të rrezikut të kredisë së një ekspozimi që nga data e njohjes fillestare, dhe në regjistrimin e humbjeve të pritshme të kredisë për të gjithë jetëgjatësinë, në vend të humbjeve të pritshme të kredisë për 12 muajt e ardhshëm, Banka vlerëson, në çdo datë raportimi, probabilitetin e mosshlyerjes krahasuar me probabilitetin e mosshlyerjes në datën e regjistrimit fillestar për të gjithë ekspozimet performuese, përfshirë ato pa ditë-vonesa.

Vlerësimi i një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë bazohet në:

- Tregues sasiore: i referohet informacionit sasiore të përdorur dhe në mënyrë specifike, krahasimit të probabilitetit të mosshlyerjes mes datës së raportimit dhe datës së regjistrimit fillestar.
- Tregues cilësorë: i referohet informacionit cilësor të përdorur i cili nuk është domosdoshmërisht i reflektuar në probabilitetin e mosshlyerjes, siç është klasifikimi si një ekspozim performues nga i cili Banka ka hequr dorë (sipas klasifikimit të Autoritetit Bankar Europian). Faktorë cilësorë shtesë, si për portofolet e kredive ndaj korporatave, ashtu edhe për portofolet e kredive ndaj individëve, reflektohen nëpërmjet treguesve paralajmërues dhe bazuar në vlerësimin e arritur, një ekspozim mund cilësohet sikur ka pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë. Veçanërisht për portofolin e kredive ndaj korporatave, tregues të tjerë shtesë mund të përftoheshin nëpërmjet klasifikimit (evolucioni financiar, të dhëna për sektorin).
- Tregues parandalues: përveç treguesve të mësipërm, numri i ditë-vonesave(30) përdoret si parandalim

d. Llogaritja e humbjeve të pritshme të kredisë

Banka llogarit humbjet nga zhvlerësimi në bazë kolektive ose individuale, duke marrë parasysh rëndësinë e ekspozimit ose limitin e huamarrësit. Përveç kësaj, ekspozimet të cilat nuk kanë karakteristika të rrezikut të kredisë të ngjashme ose për të cilat nuk ka mjaftueshëm të dhëna historike, vlerësohen në bazë individuale. Banka do të llogarisë humbjet e pritshme të kredisë bazuar në probabilitetin e ponderuar të 3 skenarëve për të vlerësuar flukset monetare të pritshme, të cilat do të aktualizohen duke përdorur normën e interesit efektiv.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(i) Implementimi i SNRF 9 (vazhdim)

Zhvlerësimi (vazhdim)

i. Kredi dhe paradhënie për klientët (vazhdim)

d. Llogaritja e humbjeve të pritshme të kredisë

Metoda e llogaritjes së humbjeve të pritshme të kredisë bazohet në parametrat e mëposhtëm të rrezikut:

- Probabiliteti i mosshlyerjes : Është një vlerësim i probabilitetit që huamarrësi të mos paguajë gjatë një periudhe të caktuar kohore. Mospagimi ndodh në një pikë të caktuar në periudhën kohore të marrë parasysh, duke supozuar që ekspozimi nuk është çregjistruar më parë dhe ndodhet akoma në portofolin e kredive. Për llogaritjen e probabilitetit të mosshlyerjes, modelet e vlerësimit të rrezikut të kredisë marrin parasysh një sërë parametrash, të cilët mund të grupohen si më poshtë:
 - Analizë financiare: Kapaciteti financiar i huamarrësit (Tregues likuiditeti, raporti I borxhit me të ardhurat etj.)
 - Analize e konkurrentëve: pozicionimi krahasues i huamarrësit në tregun në të cilin operon, kryesisht lidhur me konkurrentët (e aplikueshme për kreditë korporata)
 - Analize historike e sjelljes së huamarrësit ndaj bankës dhe palëve të treta
 - Karakteristika cilësore të huamarrësit (drejtimi i përgjegjshëm, qartësi në rast ndryshimi të drejtimit, ambiente të përshtatshme etj.)

Vlerësimet e kreditit do të përbëjnë inputin kryesor në llogaritjen e probabilitetit të mosshlyerjes. Banka do të përdorë modele statistikore për të analizuar informacionin e mbledhur dhe për të bërë vlerësime për probabilitetin e mosshlyerjes dhe se si ky probabilitet do të evoluojë në kohë me ndryshimet makroekonomike (ndryshimet në normën e rritjes së PBB, norma e papunësisë, çmimet e pasurive të paluajtshme)

Ekspozimi në mospagim: Është një vlerësim i humbjes që do të pësohet në qoftë se mospagimi ndodh në një periudhë të caktuar. Ekspozimi në mospagim bazohet në diferencën midis flukseve monetare kontraktuale dhe atyre që priten të përftohen, duke përfshirë edhe shitjet e kolateralit. Shprehet zakonisht si raport i ekspozimit në mosshlyerje. Banka i ndan portofolet e kredive ndaj individëve dhe korporatave në portofole më të vegjël, duke u nisur nga karakteristikat bazë që lidhen me vlerësimin e flukseve të ardhshme monetare.

Të dhënat e përdorura janë të dhëna historike dhe përfshijnë një gamë të gjerë karakteristikash. Sipas SNRF 9, të dhëna më të fundit dhe skenarë të mundshëm të ardhshëm mund të përdoren gjithashtu në llogaritjen e humbjes nga mosshlyerja për çdo grup instrumentesh financiarë.

Në përcaktimin e humbjeve të pritshme nga kredia, banka do të marrë parasysh tre skenarë: një skenar bazë, një skenar në rastin më të mirë dhe një skenar në rastin më të keq dhe probabilitetin kumulativ që këta skenarë kanë që të ndodhin.

Secili nga këta skenarë lidhet me probabilitetin përkatës të mosshlyerjes dhe/ose humbjen nga mosshlyerja përkatëse.

e. Angazhime të patërhequra

Angazhimet e papërdorura të kredive dhe letër kredive maten në përputhje me SNK 39 me vlerën më të lartë ndërmjet shumës së provigjionit (përcaktuar sipas IAS 37) kur dalja e fluksit monetar konsiderohej e mundshme dhe kur mund të bëhej një vlerësim i besueshëm, dhe shumës fillestare në datën e regjistrimit minus amortizimin e akumuluar. Sipas SNRF 9, këto kontrata përfshihen në kategorinë ku duhet regjistruar humbja e pritshme e kredisë.

Gjatë vlerësimit të humbjeve të pritshme nga kredia për jetëgjatësinë e angazhimit të papërdorur të kredisë, Banka do të vlerësojë pjesën e kredisë që pritet të përdoret gjatë jetëgjatësisë.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(i) Implementimi i SNRF 9 (vazhdim)

Zhvlerësimi (vazhdim)

i. Kredi dhe paradhënie për klientët (vazhdim)

e. Angazhime të patërhequra

Kartat e kreditit dhe ekspozimet qarkulluese kanë karakteristika të kredisë, por edhe të një angazhimi kredie të përdorur për të cilin humbjet e pritshme të kredisë do të llogariten bashkë me kredinë. Megjithatë, për angazhime të përdorura të kredisë dhe letër kreditë/letër garancitë, humbjet e pritshme të kredisë do të regjistrohen si provigjione.

g. Informacion mbi kushtet e ardhshme

Departamenti i kërkimit ekonomik ndërton parashikime për evoluimin e mundshëm të variablave makroekonomikë që ndikojnë nivelin e humbjeve të pritshme të portofolit të kredisë sipas një skenari bazë dhe sipas disa skenarëve alternativë dhe gjithashtu prodhon probabilitetet kumulative që lidhen me këto skenarë. Variablat makroekonomikë që ndikojnë nivelin e humbjeve të pritshme të kredisë janë Prodhimi i Brendshëm Bruto, norma e papunësisë dhe çmimet e pasurive të paluajtshme.

Ndërtimi i skenarit bazë, mbështetur nga përshkrime ekonomike, përfaqëson pikënisjen dhe përbën skenarin më të mundshëm sipas kushteve ekonomike të periudhës në të cilën bëhet analiza dhe sipas parashikimeve të Bankës se ku është drejtuar ekonomia.

Probabilitetet kumulative të skenarëve makroekonomikë për ekonominë Greke tregojnë nëse ekonomia performon më mirë ose më keq se parashikimet e skenarit bazë dhe të skenarëve alternativë.

h. Organi përgjegjës

Komiteti i Rrezikut të Kredisë është përgjegjës për aprovimin e humbjeve të pritshme të kredisë, si edhe për aprovimin e modeleve të zhvilluar nga Banka për llogaritjen e humbjeve të pritshme të kredisë për portofolin e kredive.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(i) Implementimi i SNRF 9 (vazhdim)

i. Zhvlerësimi i instrumentave të thesarit

Për instrumentat e borxhit të thesarit që maten me kosto të amortizuar ose me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse sipas SNRF 9, humbja nga zhvlerësimi do të bazohet në humbjet e pritshme të kredisë të lidhura me probabilitetin e mosshlyerjes brenda 12 muajve të ardhshëm. Në qoftë se ka pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga data e regjistrimit fillestar, humbja nga zhvlerësimi do të jetë e barabartë me humbjen e pritshme të kredisë gjatë gjithë jetëgjatësisë.

Rritje e konsiderueshme në rrezikun e kredisë

Banka përcakton si instrumenta me rrezik të ulët të gjithë instrumentat të klasifikuar si “Kategori Investimi”, të cilët do të përfshihen në Fazën 1, me kusht që të mbesin në këtë kategori. Banka do të aplikojë metodologji të veçanta për të përcaktuar nëse ka pasur rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga data e regjistrimit fillestar për të gjithë instrumentat të klasifikuar si “Kategori Jo-Investimi”.

Klasifikimi nëpër faza për qëllimin e llogaritjes së humbjes së pritshme bazohet në vlerësimet e kompanive të vlerësimit të kreditit. Përcaktimi i rritjes së konsiderueshme në rrezikun e kredisë për të gjithë instrumentet e klasifikuar në “Kategori Jo-Investimi” bazohet në dy kushtet e mëposhtme:

- Përkeqësim në vlerësimin e kreditit të emetuesit/ palës tjetër në datën tjetër, krahasuar me vlerësimin në datën e regjistrimit fillestar
- Rritje e probabilitetit të mosshlyerjes të emetuesit/ palës tjetër për periudhën 12 mujore, krahasuar me probabilitetin e mosshlyerjes në datën e regjistrimit fillestar

Gjithashtu, Banka do të monitorojë ndryshimin në marzhin e kredisë që nga data e regjistrimit.

Një ndryshim në marzhin e kredisë në datën e raportimit që tejkalon një limit të caktuar krahasuar me marzhin e kredisë në datën e regjistrimit është një tregues për ri-klasifikimin e instrumenteve në një fazë tjetër. Bazuar në rezultatin e rishikimit, instrumenti ngelet në Fazën 1 ose transferohet në Fazën 2, pavarësisht nëse janë plotësuar kriteret e Fazës 2.

Llogaritja e humbjes së pritshme nga kredia

Për llogaritjen e humbjes së pritshme nga kreditë, do të konsiderohen parametrat e mëposhtëm:

- Probabiliteti i mosshlyerjes: probabiliteti i mosshlyerjes gjatë 12 muajve të ardhshëm do të përdoret për të llogaritur humbjet e pritshme të kredisë gjatë 12 muajve, dhe probabiliteti i mosshlyerjes gjatë jetëgjatësisë do të përdoret për të llogaritur humbjet e pritshme gjatë jetëgjatësisë
- Ekspozimi në mosshlyerje: në rastin e instrumentave, Banka vlerëson koston e ardhshme të amortizuar për të llogaritur ekspozimin në mospagim. Në çdo periudhë, ekspozimi në mospagim është humbja maksimale që mund të pësohet.
- Humbja nga mosshlyerja është një përqindje e ekspozimit total që Banka vlerëson se është i parikuperueshëm në momentin e mosshlyerjes. Banka dallon mes emetuesve qeveritarë dhe jo-qeveritarë për sa i përket vlerësimit të humbjes nga mosshlyerja. Në rast se banka i ka dhënë kredi emetuesit të instrumentit financiar, humbja nga mosshlyerja duhet të jetë në të njëjtën linjë me vlerësimin e bërë për portofolin e kredive (duke marrë parasysh ndonjë kolateral që kredia mund të ketë, në dallim nga instrumentat e borxhit të pasiguruara).

Instrumentet e borxhit do të regjistrohen si të blera ose të origjinuara të zhvlerësuara nga kreditë në rastet e mëposhtme:

- Instrumenti i borxhit (ose emetuesi) ka një vlerësim krediti që i korrespondon mosshlyerjes në kohën e blerjes
- Obligacionet e korporatave që rrjedhin nga ristrukturimet e borxhit do të klasifikohen si të zhvlerësuara në regjistrimin e parë, bazuar në udhëzimet e aplikueshme për portofolin e kredive

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(i) Implementimi i SNRF 9 (vazhdim)

Kur një instrument borxhi blihet me një zbritje të thellë dhe nuk përket në asnjë nga kategoritë e mësipërme, Banka ekzaminon transaksionin në detaje (çmimin, normën e rikuperimit, pozicionin financiar të emetuesit në kohën e blerjes, etj.) për të përcaktuar nëse duhet të regjistrohet si një instrument i zhvlerësuar nga kredia i blerë ose i origjinar. Klasifikimi në këtë kategori kërkon dokumentim dhe aprovim nga komiteti përkatës i bankës.

Instrumenta financiarë të kapitalit ose parasë konsiderohen të zhvlerësuar kur vlerësimi i tyre i kreditit është “në mosshlyerje” (default). Në këtë rast, në qoftë se emetuesit i është dhënë edhe një kredi, atëherë klasifikimi i instrumentit të borxhit duhet të jetë i linjësuar me klasifikimin e ekspozimit të kredisë.

Kontabiliteti mbrojtës

Për sa i përket kontabilitetit mbrojtës, banka ka zgjedhur të aplikojë dispozitat e SNK 39 si një politikë e lejuar nga SNK 39.

Tranzicioni

Banka nuk do të ri-publikojë informacionin krahasues për 2017 për instrumentat financiarë që mbulohen nga SNRF 9 dhe diferencat që lindin nga aplikimi i SNRF 9 (1 janar 2018) do të regjistrohen direkt në Kapital më 1 janar 2018.

Vlerësimi i efektit

Banka ka kryer një vlerësim paraprak të efektit të mundshëm të aplikimit të SNRF 9, bazuar në instrumentet financiare më 1 janar 2018. Bazuar në vlerësimet aktuale, aplikimi i SNRF pritet që të rezultojë në një ulje prej 1.3% të kapitalit më 31 dhjetor 2017. Vlerësimi i efektit lidhet kryesisht me implementimin e rregulloreve të humbjeve të pritshme. Banka do të vazhdojë të monitorojë, përmirësojë dhe validojë elementet e modelit të zhvlerësimit dhe kontrollet e proceseve përkatëse për raportimin në 2018.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

5. Përcaktim i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë bazohet mbi instrumentat financiarë ekzistues në pasqyrën e pozicionit financiar, pa u përpjekur për të vlerësuar vlerën e ardhshme të aktivitetit dhe vlerën e aktiveve dhe detyrimeve të cilat nuk janë instrumenta financiare.

Aktive financiare të vlefshme për shitje – Letrat me vlerë klasifikohen si Nivel 1 nëse të dhënat për çmimet e tyre janë të kuotuar në tregje aktive, për instrumenta identike me to. Kur vlera e drejtë llogaritet në bazë të çmimit të ofruar në treg nga tregtarët - agjentët apo duke përdorur flukset e aktualizuara të bazuara në një kurbë normash të përshtatshme për periudhën deri në maturimin e tyre, klasifikohen si Nivel 2. Nivel 3 i klasifikimit u referohet instrumentave, vlera e drejtë e të cilave vlerësohet duke përdorur të dhëna kryesore të pavëzhgueshme. Në këto raste vlera e drejtë llogaritet nga një agjent llogaritës dhe miratohet nga Grupi.

Hua dhe paradhënie dhënë institucioneve financiare - Hua dhe paradhënie dhënë institucioneve financiare përfshijnë depozita ndërbankare dhe aktive të tjera në arkëtim e sipër. Meqenëse depozitat janë afat-shkurtra dhe me interesa variabël vlera e tyre e drejtë mendohet se është e përafërt me vlerën kontabël.

Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim – janë aktive që mbartin interes. Meqenëse nuk ekziston një treg aktiv për këto letra me vlerë, vlera e drejtë e tyre është llogaritur duke përdorur modelin e aktualizimit të flukseve të ardhshme të parasë bazuar në normat aktuale të kthimit për periudhën e mbetur deri në maturim dhe ato klasifikohen në Nivelin 2.

Hua dhe paradhënie dhënë klientëve – Huatë dhe paradhëniet mbahen neto duke u zbritur humbjet për zhvlerësim. Portofoli i kredive të Bankës ka një vlerë të drejtë të përlllogaritur afërsisht sa vlera kontabël si pasojë e natyrës afat-shkurtër ose normave të interesit (të cilat janë norma të ndryshueshme: Bono Thesari, EURIBOR, LIBOR plus një marzh interesi), të cilat i përafrohen normave të tregut. Shumica e portofolit të kredive është subjekt i rëqimit brenda vitit, duke ndryshuar interesin bazë.

Depozitat nga Bankat - Vlera e drejtë e depozitave pa afat, të cilat përfshijnë depozita pa interes, është shuma që do të paguhej në moment.

Depozitat e klientëve - Meqenëse nuk ekziston një treg aktiv për këto instrumenta, vlera e drejtë është përlllogaritur duke përdorur modelin e skontimit të flukseve të ardhshme të parasë bazuar në kurbën aktuale të normave të kthimit të përshtatshme për maturitetin e mbetur.

Tabelat e mëposhtme paraqesin një analizë të aktiveve dhe detyrimeve të analizuara sipas kohës kur ato pritet të rikuperohen ose shlyhen. Huatë dhe depozitat janë klasifikuar në Nivelin 3 të Hierarkisë së Vlerës së Drejtë:

	<u>Niveli 1</u>	<u>Niveli 2</u>	<u>Niveli 3</u>	<u>Totali</u>
31 dhjetor 2017				
Aktivitet Financiare				
Aktivitet financiare të vlefshme për shitje	<u>1,740,585</u>	<u>13,435,183</u>	<u>-</u>	<u>15,175,768</u>
Totali	<u>1,740,585</u>	<u>13.435,183</u>	<u>-</u>	<u>15,175,768</u>
31 dhjetor 2016				
Aktivitet Financiare				
Aktivitet financiare të vlefshme për shitje	<u>6,057,360</u>	<u>11,130,644</u>	<u>134,953</u>	<u>17,322,957</u>
Totali	<u>6,057,360</u>	<u>11,130,644</u>	<u>134,953</u>	<u>17,322,957</u>

Nuk ka patur blerje ose shitje në nivelin 3 të aktiveve financiare VPS. Ndryshimi në vlerën kontabël është si rezultat i ndryshimit në vlerën e drejtë.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

5. Përcakim i vlerës së drejtë (vazhdim)

Tabela e mëposhtme tregon vlerën kontabël dhe vlerën e drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë.

31 dhjetor 2017	Mbajtur deri në maturim	Hua dhe të arkëtueshme	Të tjera me kosto të amortizuar	Totali i vlerës kontabël	Vlera e drejtë e Nivelit 3
Aktivitet financiarë					
Mjete monetare dhe tepricat me Bankën Qëndrore	-	17,265,466	-	17,265,466	17,265,466
Hua dhe paradhënie për institucionet financiare	-	10,741,771	-	10,741,771	10,741,771
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	204,764	-	-	204,764	217,860
Hua dhe paradhënie për klientët	-	31,902,943	-	31,902,943	33,463,169
Aktive të tjera			1,445,182	1,445,182	1,445,182
Totali	204,764	59,910,180	1,445,182	61,560,126	63,133,448
Detyrime financiare					
Detyrime ndaj bankave	-	-	2,361,741	2,361,741	2,361,741
Detyrime ndaj klientëve	-	-	62,078,425	62,078,425	62,107,485
Borxh në varesi	-	-	2,130,360	2,130,360	2,126,523
Detyrime të tjera			588,373	588,373	588,373
Totali	-	-	67,158,899	67,158,899	67,184,122

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

5. Përcakim i vlerës së drejtë (vazhdim)

31 dhjetor 2016	Mbajtur deri në maturim	Hua dhe të arkëtueshme	Të tjera me kosto të amortizuar	Totali i vlerës kontabël	Vlera e drejtë e Nivelit 3
Aktivët financiarë					
Mjete monetare dhe tepricat me Bankën Qëndrore	-	12,144,384	-	12,144,384	12,144,384
Hua dhe paradhënie për institucionet financiare	-	8,802,474	-	8,802,474	8,802,474
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	863,340	-	-	863,340	880,751
Hua dhe paradhënie për klientët	-	32,563,711	-	32,563,711	34,655,785
Aktive të tjera	-	-	2,107,052	2,107,052	2,107,052
Totali	863,340	53,510,569	2,107,052	56,480,961	58,590,446
Detyrime financiare					
Detyrime ndaj bankave	-	-	1,984,101	1,984,101	1,984,101
Detyrime ndaj klientëve	-	-	58,837,612	58,837,612	58,891,867
Borxh në varësi	-	-	2,166,923	2,166,923	2,162,310
Detyrime të tjera	-	-	508,681	508,681	508,681
Totali	-	-	63,497,317	63,497,317	63,546,959

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

6. Të ardhurat neto nga interesat

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura interesi nga:		
Hua dhe paradhënie për institucionet financiare	82,218	55,060
Hua dhe paradhënie për klientët	1,520,320	1,796,656
Të mbajtura deri në maturim dhe marrëveshjet e riblerjes	37,762	66,314
Tepricat me Bankën Qëndrore	19,196	22,543
Aktive financiare të vlefshme për shitje	754,572	843,315
Të ardhura të tjera interesi	8,022	14,722
	2,422,090	2,798,610
Shpenzime interesi per:		
Detyrime ndaj bankave	(82,183)	(37,281)
Detyrime ndaj klientëve	(160,433)	(331,067)
Borxh në varësi	(36,407)	(39,458)
Detyrime të tjera	(99,786)	(89,105)
	(378,809)	(496,911)
Të ardhura neto nga interesi	2,043,281	2,301,699

Ju lutem shikoni Shënimin 4 (b) për shumën e të ardhurave nga interesi nga kreditë e zhvlerësuar. Të ardhurat nga interesi nga kreditë për klientët përfshijnë një shumë prej 94,312 mijë Lek, e cila përfaqëson efektin e ndryshimit të normës së aktualizimit.

7. Të ardhurat neto nga tarifat e komisioneve

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Tarifë shërbimi	171,772	160,416
Telex-Swift	7,945	6,901
Transferte parash	21,993	20,379
Operacionet e thesarit dhe transaksionet ndërbankare	1,841	874
Mirëmbatja e llogarisë	81,506	50,439
Kartë debiti dhe krediti	69,448	59,493
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	354,505	298,502
Operacionet e thesarit dhe transaksionet ndërbankare	(2,272)	(3,195)
Tarifë shërbimi	(3,606)	(3,067)
Kartë debiti dhe krediti	(52,656)	(48,005)
Totali i shpenzimeve nga tarifat dhe komisionet	(58,534)	(54,267)
Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet	295,971	244,235

8. Humbje minus fitime nga transaksionet financiare

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Humbje nga shitja e aktiveve VPS	(44,542)	-
Efekti I këmbimit nga kursi I këmbimit	(281,168)	(75,742)
Totali	(325,710)	(75,742)

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

9. Shpenzime personeli

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime page	632,171	610,611
Kontribute për sigurimet shoqërore	71,575	69,444
Trajnime dhe dietat	10,603	7,710
Shpenzimet e banimit të stafit	6,573	4,705
Të tjera	51,705	33,107
Totali	772,627	725,577

Më 31 dhjetor 2017, Banka kishte 424 punonjës (31 dhjetor 2016: 416 punonjës).

10. Shpenzime operative

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Qiraja e pajisjeve kompjuterike	225,897	139,560
Shpenzime qiraje	215,555	226,958
Fondi i sigurimit të depozitave	210,378	190,434
Tatime të tjera	143,436	117,957
Shpenzime administrative të tjera	121,909	59,923
Shpenzime reklamimi dhe promovimi	114,529	162,515
Shpenzimet e teknologjisë informatike	48,089	44,532
Shpenzime profesionale	41,612	19,901
Shërbimet e sigurimit për ndërtesat dhe transportin e parave	41,604	44,509
Elektricitet	34,714	37,740
Telekomunikacioni dhe posta	33,145	34,665
Kostot e ristrukturimit	21,880	67,000
Shërbimet e mirëmbajtjes së ndërtesës dhe paisjeve	19,417	13,438
Sigurimi	14,632	12,631
Shërbimet e pastrimit	12,915	13,693
Shkrimi dhe materiale të tjera të disponueshme	12,538	20,007
Tarifat e informacionit financiar	11,585	15,278
Shërbimet nga kompanitë e koleksioneve	3,415	3,892
	1,327,250	1,224,633

Tatime të tjera përfshijnë shumën prej Lek 126,542 mijë (2016: Lek 105,801 mijë) e cila përfaqëson TVSH-në mbi shpenzimet.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

11. Tatim fitimi

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Tatim fitimi aktual	4,947	12,875
Tatim fitimi i shtyrë	(67,072)	661
Shpenzimi total I tatimit mbi të ardhurat/shpenzimet	(62,125)	13,536

Norma e tatimit mbi fitimin në Shqipëri është 15% (2015: 15%) e fitimit të tatueshëm. Më poshtë jepet rakordimi i tatimit mbi fitimin, llogaritur me normën nominale të aplikuar me shpenzimin e tatim fitimit.

	Norma e taksës	31 dhjetor 2017	Norma e taksës	31 dhjetor 2016
Humbja para tatimit		(884,959)		(1,383,546)
Tatimi sipas normës nominale të tatimit	15.00%	(132,743)	15.00%	(207,532)
Shpenzime jo të zbritshme	(6.57%)	58,157	(15.93%)	220,407
Humbje tatimore të pashfrytëzuara	(0.85%)	7,515	-	-
Humbje të mbartura	-	-	0.05%	661
Përshatjet tatimore të viteve të kaluara	(0.56%)	4,946	-	-
Shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat	7.02%	(62,125)	(0.98%)	13,536

Në bazë të ligjit të kontabilitetit, duke filluar nga 1 janari 2008 Banka duhet të raportojë në përputhje me SNRF. Përveç kësaj, Ligji 8438, i ndryshuar, ofron disa ndryshime të caktuara (efektive nga 1 janar 2014). Në bazë të këtyre ndryshimeve, fondet për zhvlerësim të ngarkuara nga Banka në përputhje me SNRF do të konsiderohen si shpenzime të zbritshme tatimore, me kusht që ato të jenë të çertifikuara nga auditorët e jashtëm.

Aktivitet tatimore të shtyra janë paraqitur neto prej pasiveve të shtyra pasi shumat janë detyrime ndaj të njëjtit autoritet tatimor dhe pritet të mbyllën në baza neto. Tatimi i shtyrë është llogaritur bazuar në normën tatimore në fuqi prej 15%.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

11. Tatim fitimi (vazhdim)

Lëvizjet në llogarinë e tatimit të shtyrë janë si më poshtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Më 31 dhjetor 2016</u>
Detyrimet / (aktivet) në fillim të vitit	46,052	10,636
Shpenzimet/(përfitimet) e tatim fitimit të shtyrë	(67,072)	661
Tatimi i shtyrë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse	16,452	34,755
Aktivitet/Detyrimet në fund të vitit	(4,568)	46,052

Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, aktivet dhe detyrimet tatimore të shtyra i ngarkohen zërave të mëposhtëm:

	<u>Më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Më 31 dhjetor 2016</u>
Aktivitet tatimore të shtyra		
Humbjet tatimore të mbartura	67,072	-
Detyrimet tatimore të shtyra		
Rivlerësimi i aktiveve financiare (shënimi 24)	(62,504)	(46,052)
Aktivi neto i tatimit të shtyrë	4,568	(46,052)

12. Arka dhe Banka Qendrore

	<u>Më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Më 31 dhjetor 2016</u>
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	1,280,276	1,164,256
Në Lek	500,919	388,242
Në monedhë të huaj	779,357	776,014
Banka Qendrore	15,985,190	10,980,128
Llogari rrjedhëse	10,123,241	5,488,694
Rezerva e detyrueshme	5,861,949	5,491,434
Totali	17,265,466	12,144,384

Në përputhje me kërkesat e Bankës Qendrore në lidhje me rezervën e detyrueshme, Banka duhet të mbajë një minimum prej 10% të depozitave të klientëve në Bankën Qendrore si llogari rezervë. Rezerva nuk është e vlefshme për operacionet ditore të Bankës.

Rezerva e detyrueshme në Lek me Bankën Qendrore ka gjeneruar një interes prej 70% të normës së marrëveshjeve të riblerjes, e cila më 31 dhjetor 2017 ishte 0.875% në vit (2016: 0.875% në vit). Duke filluar nga shtatori 2016, Banka Qendrore ka ngarkuar interes prej 0.4% në vit për rezervën e detyrueshme në euro. Për llogaritë rrjedhëse me Bankën Qendrore është ngarkuar gjithashtu interes prej 0.65%.

13. Hua dhe paradhënie institucioneve financiare

	<u>Më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Më 31 dhjetor 2016</u>
Llogari rrjedhëse me bankën	3,299,006	578,084
Jo-rezidente	3,299,006	578,084
Tregu i parasë	7,442,765	8,224,390
Rezidente	-	2,062,992
Jo- rezidente	7,441,966	6,161,063
Interesi i përlllogaritur	799	335
Totali	10,741,771	8,802,474

Llogaritë rrjedhëse me Bankat jo rezidente përfshijnë teprica me Alpha Bank A.E., Athinë dhe Deutsche Bank AG. Vendosi me Bankat jorezidente përfshijnë 7,441,966 mijë Lek (2016: nga 6,161,063 mijë Lek) me bankat jo-rezidente.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

13. Hua dhe paradhënie institucioneve financiare (vazhdim)

Vendosjet më 31 dhjetor 2017 gjeneruan interesa prej:

- Lek: N/A (2016: N/A)
- USD: 1.4% p.a (2016: 0.35% p.a)
- EUR : (0.58%) to 2% p.a (2016: (0.4%) to 2% p.a)
- GBP : 0.4% p.a (2016: 0.2 % p.a).

14. Aktivet financiare mbajtur deri në maturim

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Bonot e thesarit qeveritare :		
Qeveria Shqiptare	204,764	863,340
Totali	204,764	863,340

Bono Thesari

Banka nuk ka investuar në Bono Thesari të klasifikuara si aktive të mbajtura deri në maturim me 31 dhjetor 2017.

Obligacionet Qeveritare

Interesi për obligacionet e Qeverisë Shqiptare arkëtohet çdo 6 muaj me një normë kuponi nga 5.42% në 10.4% në vit (2016: 3.37% deri në 10.4% në vit) për Lek-un. Maturitetet e mbetura të obligacioneve qeveritare janë si më poshtë:

	2017			2016		
	Çmimi i blerjes	Interesi i llogaritur	Vlera e mbartur	Çmimi i blerjes	Interesi i llogaritur	Vlera e mbartur
24 muaj	200,000	4,764	204,764	650,000	8,794	658,794
36 muaj	-	-	-	200,000	4,546	204,546
60 muaj	-	-	-	-	-	-
	200,000	4,764	204,764	850,000	13,340	863,340

Nuk ka patur tregues të cilët mund të sjellin ndonjë zhvlerësim në aktivet financiare të mbajtura deri në maturim.

15. Aktivet financiare të vlefshme për shitje

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Emetime të listuara/ jo të listuara		
Të listuara:	2,550,768	6,411,469
- Bonot qeveritare	2,550,768	3,017,628
- Bonot e korporatave	-	3,393,841
Jo të listuara		
- Bonot e Qeverisë Shqiptare	12,625,000	10,911,488
Totali	15,175,768	17,322,957

Banka rishikon letrat me vlerë të klasifikuara si të vlefshme për shitje në çdo datë të lëshimit të pasqyrave financiare për të parë nëse ka ndonjë të dhënë objektive për zhvlerësimin e tyre. Drejtimi gjykon se ngjarjet e ndodhura pas njohjes fillestare të letrave me vlerë nuk përbëjnë një evidencë objektive për zhvlerësim. Vlera e drejtë para tatimit, e portofolit të letrave me vlerë të vlefshme për shitje është paraqitur më poshtë:

	2017	2016
Teprica çelëse më 1 Janar	307,013	75,310
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të vlefshme për shitje	109,678	231,703
Totali	416,691	307,013

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

15. Aktive financiare të vlefshme për shitje (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2017, ndryshimi i vlerës së drejtë të portofolit të aktiveve financiare të vlefshme për shitje është pozitiv. Me përjashtim të disa letrave me vlerë të korporatave, të cilat rezultuan me një ndryshim negativ të vlerës së drejtë, të gjitha letrat e tjera me vlerë kanë një ndryshim pozitiv në vlerën e tyre të drejtë. Bazuar në vlerësimin e Bankës, për këto letra me vlerë nuk u llogarit asnjë zhvlerësim deri me 31 dhjetor 2017.

Normat efektive të interesit për obligacionet e thesarit të vlefshme për shitje për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2017, u luhatën mes 0.25% deri në 9.25% në vit (2016: 0.25% dhe 9.25% në vit). Detaje sipas tipit të tyre paraqiten më poshtë:

31 dhjetor 2017	Vlera nominale	Zbritja e shtyrë	Interesi i llogaritur	Kosto e amortizimit	Rivlerësimi i diferencave	Vlera e drejtë
24 muaj	5,676,375	581	48,396	5,725,352	138,586	5,863,938
36 muaj	1,546,550	8430	6,585	1,561,565	44,987	1,606,552
60 muaj	3,735,000	5,156	56,015	3,796,171	61,771	3,857,942
Mbi 60 muaj	3,291,086	307,316	77,587	3,675,989	171,347	3,847,336
Total	14,249,011	321,483	188,583	14,759,075	416,691	15,175,768

31 dhjetor 2016	Vlera nominale	Zbritja e shtyrë	Interesi i llogaritur	Kosto e amortizimit	Rivlerësimi i diferencave	Vlera e drejtë
24 muaj	8,707,293	15,933	65,383	8,788,609	127,579	8,916,188
36 muaj	1,228,097	982	6,867	1,235,946	95,807	1,331,753
60 muaj	2,479,697	23,899	16,855	2,520,451	43,319	2,563,770
Mbi 60 muaj	3,928,347	422,069	120,522	4,470,938	40,308	4,511,246
Total	16,343,434	462,883	209,627	17,015,944	307,013	17,322,957

Tabela më poshtë tregon lëvizjet e letrave me vlerë të vlefshme për shitje deri më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016, duke përfshirë shtesat, maturimin dhe shitjen e tyre gjatë këtyre viteve:

	Lëvizjet në aktivet e vlefshme për shitje	
	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Teprica çelëse më 1 janar	17,322,957	15,363,458
Shitjet	(8,615,323)	-
Blerjet	11,538,488	4,297,098
Maturimi	(5,180,032)	(2,569,302)
Ndryshimet e vlerës së drejtë rikuperohen në fitim ose humbje	-	-
Luhatjet e vlerës së drejtë	109,678	231,703
Teprica mbyllëse më 31 dhjetor	15,175,768	17,322,957

Gjatë 2017, Banka shiti Bono Thesari të qeverisë Greke në shumën e Lek 6,690,115 mijë (2016: nuk ka patur asnjë shitje)

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

16. Hua dhe paradhënie dhënë klientëve

	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
Kredi bruto	32,758,352	33,906,481
Tarifat e shtyra të huasë	(50,943)	(57,475)
Interesi i përllogaritur	602,360	1,073,397
	33,309,769	34,922,403
Minus zbritje për zhvlerësim	(1,406,826)	(2,358,692)
Totali	31,902,943	32,563,711

Lëvizjet e fondit për humbje prej zhvlerësimit paraqiten në tabelën më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Totali në fillim të vitit	2,358,692	2,946,198
Kredi të fshira	(1,817,527)	(1,189,746)
Humbjet nga zhvlerësimi	777,370	1,891,780
Kreditë e shitura (shënimi 28)	-	(1,306,893)
Diferencat nga këmbimi në monedha të huaja	(6,021)	(5,743)
Kthim i zbritjeve	94,312	23,096
Totali në fund të vitit	1,406,826	2,358,692

Të gjitha kreditë e zhvlerësuara janë regjistruar me vlerat e tyre të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi të ngarkuara në fitim ose humbje janë paraqitur neto nga rekuperimet e kredive të fshira:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Humbje nga zhvlerësimi	777,371	1,891,780
Kthimi nga kreditë e fshira	(35,760)	(15,593)
	741,611	1,876,187

Lëvizjet në rezervat për humbjet nga zhvlerësimi sipas klasave të huave dhe paradhënies janë të detajuara si më poshtë:

	Kredi korporate	Kredi tregtare	Totali
Totali më 1 janar 2016	2,153,786	792,412	2,946,198
Humbjet nga zhvlerësimi	3,123,647	506,141	3,629,788
Ndryshimet	(1,397,719)	(340,289)	(1,738,008)
Kreditë e shitura (shënimi 28)	(1,306,893)	-	(1,306,893)
Të fshira	(1,019,839)	(169,906)	(1,189,745)
Diferencat nga këmbimi në monedhë të huaj	(3,286)	(2,458)	(5,744)
Kthim i zbritjeve	11,694	11,402	23,096
Totali më 31 dhjetor 2016	1,561,390	797,302	2,358,692
Humbjet nga zhvlerësimi	2,081,540	248,115	2,329,655
Ndryshimet	(1,263,681)	(288,604)	(1,552,285)
Të fshira	(1,690,900)	(126,627)	(1,817,527)
Diferencat nga këmbimi në monedha të huaja	(3,371)	(-2,650)	(6,021)
Ndryshimi në vlerën e drejtë të llogarisë së kompensimit	34,533	59,779	94,312
Totali më 31 dhjetor 2017	719,511	687,315	1,406,826
31 dhjetor 2016			
Të provigjonuara individualisht	1,368,507	66,804	1,435,311
Të provigjonuara në mënyre kolektive	192,883	730,498	923,381
	1,561,390	797,302	2,358,692
31 dhjetor 2017			
Të provigjonuara individualisht	5,777	576,509	582,286
Të provigjonuara në mënyrë kolektive	599,742	224,798	824,540
TOTALI	605,519	801,307	1,406,826

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

17. Aktivet afatgjata materiale

	Pajisjet	Kompjutera dhe mobiljet	Automjetet dhe aktivet e tjera	Përmirësime	Totali
Kosto					
Në 1 janar 2016	220,337	832,778	97,019	1,300,026	2,450,160
Shtimet	4,977	18,041	8,187	16,914	48,119
Fshirje	(2,539)	(21,222)	-	(152,285)	(176,046)
Heqjet	(3,001)	(3,039)	(10,478)	-	(16,518)
Në 31 dhjetor 2016	219,774	826,558	94,728	1,164,654	2,305,714
Shtimet	3,590	23,427	11,075	33,158	71,250
Fshirje	(12,131)	(57,590)	-	(45,765)	(115,486)
Heqjet	(2,215)	(918)	(11,331)	-	(14,464)
Në 31 dhjetor 2017	209,018	791,477	94,472	1,152,047	2,247,014
Amortizimi I akumuluar					
Në 1 janar 2016	(212,122)	(791,154)	(69,853)	(627,341)	(1,700,470)
Ndryshimi i vitit	(3,058)	(15,735)	(7,769)	(66,868)	(93,430)
Fshirje	2,464	21,138	-	85,443	109,045
Heqjet	3,001	3,039	10,114	-	16,154
Në 31 dhjetor 2016	(209,715)	(782,712)	(67,508)	(608,766)	(1,668,701)
Ndryshimi i vitit	(3,582)	(16,169)	(9,133)	(61,138)	(90,022)
Fshirje	12,077	57,504	-	24,024	93,605
Heqjet	2,214	920	10,793	-	13,927
Në 31 dhjetor 2017	(199,006)	(740,457)	(65,848)	(645,880)	(1,651,191)
Vlera mbartëse					
Ne 1 janar 2016	8,215	41,624	27,166	672,685	749,690
Në 31 dhjetor 2016	10,059	43,846	27,220	555,888	637,013
Në 31 dhjetor 2017	10,012	51,020	28,624	506,167	595,823

Banka nuk ka ndonjë aktiv të lënë peng si kolateral më 31 dhjetor 2017 (2016: asnjë).

Mjetet e transportit dhe aktivet e tjera përfshijnë mjete transporti të marra me qira financiare, të cilat sjellin detyrime qiraje (shënimi 23). Më 31 dhjetor 2017, vlera kontabël neto e mjeteve të transportit të marra me qira ishte 24,787 mijë Lek (2016: 22,798 mijë Lek). Vlera e aktiveve materiale të rikuperuara është e përafërt me vlerën kontabël të mbartur.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

18. Aktivet afatgjata jomateriale

	Programe kompjuterike	Total
Kosto		
Në 1 janar 2016	383,563	383,563
Shtimet	16,153	16,153
Në 31 dhjetor 2016	399,716	399,716
Shtimet	40,171	40,171
Në 31 dhjetor 2017	439,887	439,887
Amortizimi i akumuluar		
Në 1 janar 2016	(365,108)	(365,108)
Ngarkesa për vitin	(12,102)	(12,102)
Në 31 dhjetor 2016	(377,210)	(377,210)
Ngarkesa për vitin	(10,467)	(10,467)
Në 31 dhjetor 2017	(387,677)	(387,677)
Vlera mbartëse		
Në 1 janar 2016	18,455	18,455
Në 31 dhjetor 2016	22,506	22,506
Në 31 dhjetor 2017	52,210	52,210

19. Aktive të tjera dhe aktive të riposeduara

Aktivët e tjera janë treguar më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shpenzime të parapaguara	38,128	33,204
Debitorë të tjerë	212,986	192,581
Të arkëtueshme të tjera	-	580,566
Totali	251,114	806,351

Aktivët afatgjata të riposeduara përfaqësojnë pasuritë e patundshme të fituara me anë të ekzekutimit të kolateraleve nga kreditë. Banka ka vlerësuar aktivët me vlerën më të vogël midis vlerës së mbetur kontabël dhe vlerës së drejte. Në rastet kur vlera e drejte është më e ulët se vlera e mbetur kontabël do të njihet një humbje nga zhvlerësimi i aseteve të cilat do të kontabilizohet në shpenzimet e tjera operative. Vlera e drejtë e këtyre aktiveve është klasifikuar për qëllim të hierarkisë të vlerës së drejtë në Nivelin 3, meqënëse Banka ka përdorur disa të dhëna nga kërkimet e saj, supozime dhe të dhëna lidhur me pronat me karakteristika të ngjashme dhe ka përfshirë kështu në model një segment të gjerë të dhënash që nuk janë të vëzhgueshme në treg.

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Pronat rezidenciale	70,665	49,723
Pronat tregtare	175,499	222,047
Prona të tjera	171,795	133,289
Totali	417,959	405,059

Totali i shtesave të vitit në aktive të riposeduara në vitin 2017 ishte 148,438 mijë Lek (2015: 79,795 mijë Lek). Gjatë vitit 2017 Banka ka njohur rënie në vlerë prej 2,281 mijë Lek nga rivlerësimi i këtyre aktiveve (2016: 11,819 mijë Lek). Shitja e kolateraleve në riposedim arrin shumën 132,243 mijë Lek (2016: 1,568 mijë Lek), me një fitim neto prej 5,274 mijë Lek (2016: 32 mijë Lek) të përfshirë në të ardhura të tjera operative

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

19. Aktive të tjera dhe aktive të riposeduara (vazhdim)

Lëvizjet në aktivet e riposeduara janë treguar më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Në 1 janar	405,059	339,684
Shtime	148,438	79,795
Shitjet	(132,243)	(1,568)
Fshirje	(2,281)	(11,819)
Diferenca të tjera	(1,014)	(1,033)
Më 31 dhjetor	417,959	405,059

20. Detyrime ndaj bankave

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Llogaritë rrjedhëse	16,647	62,830
Repo e anasjelltë	1,814,753	1,190,567
Marrje hua	530,000	730,566
Interesi i përlllogaritur	341	138
Totali	2,361,741	1,984,101

Gjatë 2017, Banka ka lënë peng gjashtë Obligacione të Qeverisë Shqiptare me një vlerë nominale prej Lek 2,850,000 mijë për kryerjen e transaksionit repo e anasjelltë me Bankën Qëndrore (2016: 1,500,00 mijë). Obligacionet kanë një vlerë kontabël neto prej 2,894,628 mijë dhe vlerë të drejtë 2,982,419 mijë më 31 dhjetor 2017 (2016: vlera kontabël neto ishte Lek 1,517,565 dhe vlera e drejtë Lek 1,560,093). Vlera totale e obligacioneve të lëna peng është e barabartë me balancën e repos.

21. Detyrimet ndaj klientëve

	2017			2016		
	Monedhë vendase	Monedhë e huaj	Total	Monedhë vendase	Monedhë e huaj	Total
Llogaritë rrjedhëse						
Individuale	3,577,731	7,619,057	11,196,788	2,900,772	4,983,784	7,884,556
Ndërmarrjet private	1,697,345	3,276,440	4,973,785	1,375,059	2,352,525	3,727,584
Ndërmarrjet publike	124,320	283,756	408,076	162,509	414,426	576,935
	5,399,396	11,179,253	16,578,649	4,438,340	7,750,735	12,189,075
Llogaritë e kursimit						
Individuale	2,396,222	7,052,938	9,449,160	2,238,943	5,855,601	8,094,544
	2,396,222	7,052,938	9,449,160	2,238,943	5,855,601	8,094,544
Termet e depozitës						
Individuale	16,182,109	18,796,519	34,978,628	17,244,893	20,341,855	37,586,748
Ndërmarrjet private	440,706	531,959	972,665	182,105	626,553	808,658
	16,622,815	19,328,478	35,951,293	17,426,998	20,968,408	38,395,406
Interesi i përlllogaritur	89,926	9,397	99,323	130,752	27,835	158,587
Total	24,508,359	37,570,066	62,078,425	24,235,033	34,602,579	58,837,612

Llogaritë rrjedhëse dhe të kursimit gjenerojnë interes që varion nga norma 0% në 0.45% në vit për Lek (2016: nga 0% në 0.45% në vit) dhe nga 0% deri në 0.2% në vit për monedhat e huaja në 31 dhjetor 2017 (2016: 0% në 0.2% në vit), duke përjashtuar normat e interesit preferenciale.

Depozitat me afat gjenerojnë interes që varion nga norma 0.1% deri në 0.9% në vit për Lek (2016: nga 0.1% deri në 0.9% në vit) dhe nga 0.01% deri në 0.2% në vit për monedhat e huaja (2016: nga 0.02% në 0.22% në vit), duke përjashtuar normat preferenciale të interesit.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

22. Borxhi i varur

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Borxh i varur	2,127,200	2,163,680
Interesi i përlogaritur	3,160	3,243
Total	2,130,360	2,166,923

Borxhi i varur për shumën 2,130,360 mijë Lek (16 milionë Euro) ju dha Bankës nga Alpha Bank A.E. nëpërmjet një marrëveshjeje të datës 12 maj 2011.

Principali është i pagueshëm në datën e maturimit të borxhit, në 31 maj 2021 (shuma 6 milionë Euro) dhe 31 maj 2022 (shuma 10 milionë Euro), ndërsa interesi shlyhet në baza tremujore. Borxhi mbart një interes të pagueshëm prej Euribor 3mujor + 2% (2015: Euribor 3 mujor + 2%).

Ndryshimet në borxhin e varur vijnë nga aktivitetet financuese dhe përfshijnë ndryshime të flukseve monetare dhe jo-monetare, si më poshtë:

	1 janar 2017	Flukse monetare	Flukse jo-monetare		31 dhjetor 2017
			Interesi	Diferenca nga kursi i këmbimit	
Borxh i varur	2,166,923	(36,405)	36,407	(36,565)	2,130,360

23. Detyrime të tjera

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Furnitorët dhe shpenzimet e llogaritura	228,582	220,495
Provigjonet për debitorët e tjerë	86,493	24,748
Llogaritë e pezulluara	59,272	49,728
Transaksione si agjent (buxheti i shtetit)	54,712	51,851
Pagesa në tranzit	46,322	22,808
Tatimi përveç tatimit mbi fitimin	34,686	29,200
TVSH e pagueshme	29,668	24,241
Detyrimet e qirasë financiare	20,247	20,588
Sigurime shoqërore të pagueshme	3,007	2,942
Çeqe për tu paguar	260	315
Të tjera	25,124	15,712
Totali	588,373	462,628

Shuma prej Lek 86, 493 kryesisht përfaqëson provigjione për komisionet e mirëmbajtjes së llogarisë.

Ndryshimet në detyrimet e qirasë financiare vijnë nga aktivitetet financuese dhe përfshijnë ndryshime të flukseve monetare dhe jo-monetare, si më poshtë:

	1 janar 2017	Flukse monetare	Flukse jo-monetare		31 dhjetor 2017
			Qira të reja	Diferenca nga kursi i këmbimit	
Qira financiare	20,588	(12,644)	12,613	(310)	20,247

Flukset e mësipërme janë të përfshira në flukset monetare neto nga aktivitetet financuese në pasqyrën e flukseve monetare.

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK '000)

24. Kapitali aksionar dhe rezerva të tjera

Kapitali i autorizuar, i emtuar dhe i paguar i Bankës përbëhet 100% nga aksionet e Alpha Bank A.E., Athinë. Nuk ka pasur ndryshime në kapitalin aksionar gjatë vitit 2017. Gjatë viteve 2017 dhe 2016, kapitali aksionar i Bankës përfshin kontribute në USD dhe EUR si më poshtë:

Monedha	Në monedhën origjinale	Në Lek '000	Norma e këmbimit
USD	10,080,000	1,084,003	107.54
EUR	61,152,499	8,495,917	138.93
EUR	10,000,000	1,380,200	138.02
Totali		10,960,120	

Gjatë transformimit nga degë në filial në vitin 2012, Banka përdori si kurse historike të këmbimit për kapitalin në EUR dhe USD ato të datës 31 dhjetor 2011, aprovuar prej Bankës së Shqipërisë. Si rezultat i përdorimit të këtyre kurseve u krijua një rezervë rivlerësimi negative prej 243,192 mijë Lek, e cila është klasifikuar në zërin 'Rezerva të tjera'. Rezervat e tjera përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Rezerva e vlerës së drejtë (aktive financiare VPS)	416,691	307,013
Efekt i tatimor në rezervën e vlerës së drejtë (shih shënimin 11)	(62,504)	(46,052)
Rezerva e konvertimit (shih shënimin 15)	(243,191)	(243,191)
Totali	110,996	17,770

25. Rezerva ligjore

Rezerva ligjore është krijuar në bazë të rregullores së Bankës Qendrore mbi "Minimumin e kapitalit fillestar të Bankës për aktivitetet e lejuara të bankave dhe degëve të bankave të huaja të licensuara," nr.51, datë 22 prill 1999. Bankat dhe degët e Bankave të huaja duhet të krijojnë rezervat nga 1.25% deri në 2% të totalit të aktiveve të ponderuara për rrezikun duke zbritur një të pestën e fitimit para tatimit dhe para pagimit të dividendëve.

26.

Rezerva ligjore, bazuar në Ligjin Tregtar, kërkon krijimin e rezervës duke përdorur 5% të të ardhurave neto të Bankës, pas zbritjes së humbjeve të viteve të kaluara. Kjo rezervë nuk është e detyrueshme nëse rezervat kanë arritur sa një e dhjeta e kapitalit të Bankës.

26. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Mjetet monetare në arkë	1,280,276	1,164,256
Llogaritë rrjedhëse me Bankën Qëndrore	10,123,241	5,488,694
Llogaritë rrjedhëse me bankat e tjera	3,299,006	578,084
Vendosjet afatshkurtra me bankat e tjera	7,442,765	8,224,390
Totali	22,145,288	15,455,424

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

27. Angazhime dhe detyrime të mundshme

Angazhimet dhe detyrimet e mundshme përfshijnë garancitë e përfuara dhe dhënë klientëve si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Detyrimet e mundshme		
Garancitë në favor të klientëve	716,895	368,437
Letër kredie	-	266,385
Angazhimet për kredi të patërhequra	1,858,018	1,878,291

Letër kreditë e detyrojnë Bankën të bëjë pagesa në emër të detyrimeve të kushtëzuara të klientëve, në rast se klienti dështon të përmbushë kushtet e kontratës.

Angazhimet për kreditim përfaqësojnë angazhimet kontraktuale për të dhënë kredi dhe për të rinovuar kreditë ekzistuese. Përgjithësisht, angazhimet kanë data fikse maturimi, ose klauzola të tjera përfundimi. Duke qenë se angazhimet mund të përfundojnë para tërheqjes së të gjithë shumës, vlerat totale jo domosdoshmërisht përfaqësojnë kërkesat për para.

Pretendime dhe çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit normal të Bankës, kjo e fundit haset me çështje dhe pretendime gjyqësore. Drejtimi i Bankës ka mendimin se nuk ka humbje të mundshme materiale të pësuara në lidhje me pretendimet dhe çështjet gjyqësore deri më 31 dhjetor 2017 (31 dhjetor 2016: njëlloj).

Angazhime për Qiratë

Minimumi i qirave operative të pagueshme, të ardhshme të Bankës është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Jo më vonë se 1 vit	220,065	226,652
Më vonë se 1 vit dhe jo më vonë se 5 vite	845,356	859,262
Më vonë se 5 vite	1,073,490	1,899,669
Totali	2,138,911	2,985,583

Angazhimet e paanullueshme të qirasë më 31 dhjetor 2017 janë 57,100 mijë Lek (2016: 58,287 mijë Lek).

ALPHA BANK ALBANIA SHA

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në LEK'000)

28. Transaksionet me palët e lidhura

Gjatë aktivitetit të saj Banka hyn në transaksione të ndryshme me palët e saj të lidhura. Palët e lidhura me të cilat Banka ka kryer transaksione biznesi janë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Grupi Alpha Bank– aktivet		
Kredi dhe paradhënie institucioneve financiare	3,588,623	3,217,329
Të tjera të arkëtueshme	-	580,556
Nga të cilat kompani të grupit	-	580,556
Grupi Alpha Bank – detyrimet		
Borxhe të varura	2,130,360	2,166,923
Detyrime për bankat	16,647	8,438
Detyrime të tjera	116,679	690,893
Nga të cilat kompani të grupit	103,191	103,331
Drejtorët e bankës		
Kredi për drejtorët e bankës	866	35,381
Depozita dhe llogari të arkëtueshme	24,730	77,045
Kolaterali i marrë	1,400	34,126
Të ardhura nga interesi që vijnë nga		
Kredi dhe paradhënie institucioneve financiare	68,937	48,053
Kredi dhe paradhënie për drejtorët e bankave	26	850
Shpenzime nga interesi që vijnë nga		
Detyrime për bankat	36,413	39,459
Depozita konsumatore – Drejtorët e bankës	13	171
Shpenzime të tjera		
Shpenzime të tjera	216,048	124,752
Nga të cilat kompani të grupit	193,279	112,070
Shpërblime për Drejtorët e Bankës	41,643	61,349
Shpërblime për anëtarët jo ekzekutivë	4,280	3,291

Gjatë vitit 2017, Banka nuk i ka shitur asnjë hua Mëmës. Në dhjetor 2016, Banka i ka shitur Alpha Bank AE një pjesë të portofolit të kredisë me një vlerë kontabël prej 580,566 mijë Lek dhe me një çmim të barabartë me vlerën kontabël.

29. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje pas datës së raportimit që kërkojnë korrigjim apo shënime shtesë në pasqyrat financiare.